57. Për më tepër, Gjykata vlerëson se fushëveprimi i konceptit të parashikueshmërisë varet nga konteksti në të cilin përdoren masat kufizuese në fjalë. Kështu, përdorimi i tyre në një kontekst zgjedhur merr rëndësi të veçantë, duke pasur parasysh rëndësinë e integritetit të procesit të votimit në ruajtjen e besimit të zgjedhësve të institucionet demokratike (*Magyar Kétfarkú Kutya Párt k. Hungarisë* [DhM], § 99).

58. Në lidhje me nenet 9, 10 dhe 11 të Konventës, Gjykata ka theksuar se thjesht fakti që një dispozitë ligjore mund të ketë disa interpretime nuk do të thotë se nuk përmbush kërkesën e parashikueshmërisë (*Perinçek k. Zvicrës* [DhM], § 135; *Vogt k. Gjermani*, 48 § me jobë, në lidhje me nenin 10). Në këtë kontekst, gjithmonë ka një element pasigurie lidhur me kuptimin e legjislacionit që parashikon vepra penale të reja, derisa ky legjislacion të interpretohet dhe të zbatohet nga gjykatat penale (*Jobe k. Mbretërisë së Bashkuar* (vend.)).

59. Në vlerësimin e parashikueshmërisë së ligjit, Gjykata merr përsipër të verifikojë edhe cilësinë e legjislacionit në fjalë, lidhur me qartësinë dhe saktësinë e tij. Nën këtë optikë, Gjykata ka theksuar se togfjalëshi “e parashikuar me ligj” kërkon që masa e kontestuar duhet jo vetëm të ketë bazë në të drejtën e brendshme, por edhe t’i referohet aksesueshmërisë dhe cilësisë së ligjit në fjalë. Gjykata çmon se një ligj që publikohet në fletoren zyrtare kombëtare konsiderohet i aksesueshëm.

60. Gjykata disponoi se dënimi i një kërkuesi, kryetar i një kongresi politik, sepse nuk ndërhyri që të mos lejonte delegatët në kongres të flisnin në gjuhën kurde, edhe pse ishte paralajmëruar nga një mbikëqyrës shtetëror, nuk ishte “i parashikuar me ligj”. Gjykata disponoi se dispozitat e brendshme që rregullonte partitë politike nuk ishte mjaftueshëm e qartë për kërkuesin që të parashikonte pasojën e përballjes me një procedim penal (*Semir Güzel k. Turqisë*, §§ 35 dhe 39-41).

61. Në çështjen *Pinto Pinheiro Marques k. Portugalisë*, Gjykata vlerësoi se nuk kishte bazë ligjore të mjaftueshme për ndërhyrjen, duke vërejtur se një dispozitë ligjore që penalizonte një tjetër lloj komenti ishte zbatuar për deklaratat e bëra prej kërkuesit (§§ 37-39).

62. Në të njëjtën mënyrë, Gjykata konstatoi shkelje të kërkesës se ndërhyrja duhet të jetë e ligjshme, pasi vuri në dukje kundërshtitë ndërmjet dy teksteve ligjore dhe mungesën e një zgjidhjeje të qartë (*Goussev dhe Marenk k. Finlandës*, § 54) ose ekzistencën e mospërputhjeve në praktikën gjyqësore (*RTBF k. Belgjikës*, § 115).

63. Në një tjetër çështje, Gjykata theksoi se dispozitat e ligjit penal (për gjuhën e urrejtjes, në këtë rast) duhet të përcaktojnë qartë dhe saktë objektin e shkeljeve penale përkatëse, me qëllim që të shmanget situata ku diskrecioni i Shtetit në procedimin penal të tyre bëhet tepër i gjerë dhe potencialisht abuzues përmes zbatimit selektiv (*Savva Terentyev k. Rusisë*, § 85; shih edhe *Altuğ Taner Akçam k. Turqisë*, §§ 93-94).

64. Në çështjen *Redaksia e Pravoye Delo dhe Shtekel k. Ukrainës*, Gjykata disponoi se, nisur nga mungesa e garancive adekuata në të drejtën e brendshme për gazetarët që përdorin informacionin e marrë nga interneti, kërkuesit e kishin të pamundur të parashikonin mjaftueshëm pasojat që mund të sjellë botimi i kontestuar. Kjo i dha mundësi Gjykatës të konkludonte se nuk përmbushet kërkesa e ligjshmërisë e përcaktuar në pikën e dytë të nenit 10 të Konventës (§ 66).

65. Në një çështje ku e drejta e brendshme nuk përmbante dispozita që ndalojnë fotografimin e fletës së votimit dhe ngarkimin e tyre në mënyrë anonime në një aplikacion celulari me qëllim që të qarkulloheshin gjatë një referendumi, Gjykata vuri në dukje pasigurinë e theksuar lidhur me efektet potenciale të dispozitave ligjore të kontestuara që zbatoheshin prej autoriteteve vendase, si edhe çmoi se dispozita të tilla ishin të paparashikueshme (*Magyar Kétfarkú Kutya Párt k. Hungarisë* [DhM]).

66. Gjykata disponoi edhe se nuk e kufizon vlerësimin vetëm te cilësia e ligjit të cilën e ka shpallur më herët si të paqartë dhe të paparashikueshëm, por se është me vend që të vlerësojë edhe nevojën për ligje të tilla që janë në mospajtim e me konceptet e barazisë, pluralizmit dhe tolerancës të qenësishme në një shoqëri demokratike (*Bayev dhe Të tjerë k. Ruisë*, § 83).

2. Testi i "Legjitimitit të qëllimit që ndjek ndërhyrja"

67. Qëllimet legjitime të ndërhyrjes në të drejtën e lirisë së shprehjes përcaktohen në mënyrë shteruese në pikën e dytë të nenit 10 të Konventës. Në këtë fazë të shqyrtimit, Gjykata mund të konstatojë se ndërhyrja nuk shërben për të çuar përpara qëllimin legjitim që ndiqet (*Bayev dhe të tjerët k. Ruisë*, § 83), ose zgjedh të mbajë vetëm një nga qëllimet legjitime që evokon Shteti, ndërkohë që rrëzon qëllimet e tjera (*Morice k. Francës* [DhM], § 170; *Perinçek k. Zvicrës* [DhM], §§ 146-154; *Stoll k. Zvicrës* [DhM], § 54; *Open Door dhe Dublin Well Woman k. Irlandës*, § 63).

3. Testi i "Nevojës së ndërhyrjes në një shoqëri demokratike"

68. Parimet e përgjithshme për të vlerësuar nevojën e ndërhyrjes në të drejtën e lirisë së shprehjes të theksuara disa herë nga Gjykata që në vendimin *Handyside k. Mbretërisë së Bashkuar*, u përmbledhën në *Stoll k. Zvicrës* [DhM] (§ 101) dhe u deklaruan sërish në *Morice k. Francës* [DhM] (§ 124) dhe *Pentikäinen k. Finlandës* [DhM] (§ 87).

69. Pra, Gjykata ka zhvilluar në jurisprudencën e vet konceptin autonom nëse ndërhyrja është "proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur", i cili vlerësohet duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke përdorur kriteret e vendosura në jurisprudencën e Gjykatës dhe me ndihmën e parimeve të ndryshme dhe mjeteve interpretuese.

Këto kriteret do të analizohen hollësisht në kapitujt që flasin për zbatimin material të nenit 10 në kategori të ndryshme çështjesh.

70. Më poshtë përshkruhen disa parime dhe mjete interpretimi që Gjykata ka përcaktuar, përdorur dhe artikulluar në arsyetimin e vet ku vlerëson nevojën e ndërhyrjes në lirinë e shprehjes.

a. Ekzistenca e "nevojës së ngutshme shoqërore"

71. Nevoja e ngutshme shoqërore nuk është sinonim me "e domosdoshme", por as nuk ka fleksibilitetin e termave të tilla si "e pranueshme", "e zakonshme", "e dobishme", "e arsyeshme" apo "e dëshirueshme" (*Gorzelik*

dhe Të tjerë k. Polonisë [DhM], § 95; *Barthold k. Gjermanisë*, § 55; *The Sunday Times k. Mbretërisë së Bashkuar (nr. 1)*, § 59).

72. Teksa Shtetet Palë kanë njëfarë hapësire vlerësimi kur përcaktojnë nëse një nevojë e tillë ekziston, si rregull, kjo hapësirë vlerësimi kufizohet në rastet kur është në rrezik liria e shtypit (*Dammann k. Zvicrës*, § 51). Kështu, ndërsa ua njeh Shteteve hapësirën e vlerësimit për të përcaktuar nëse një nevojë e tillë ekziston, Gjykata mund të rrëzojë argumentet e paraqitura në këtë drejtim (shih, për shembull *Erikäinen dhe Të tjerë k. Finlandës*, § 71; *Fáber k. Hungarisë*, § 45).

73. Gjykata jo gjithmonë disponon shprehimisht në konkluzionet e veta nëse ekziston nevoja e ngutshme shoqërore, por gjykon nëse arsyet e dhëna nga autoritetet kombëtare janë relevante dhe të mjaftueshme, si dhe disponon shprehimisht lidhur me hapësirën e vlerësimit të Shtetit nëse një nevojë e tillë ekzistonte (për shembull, *Janowski k. Polonisë* [DhM], §§ 31 dhe 35; *Bladet Tromsø dhe Stensaas k. Norvegjisë* [DhM], §§ 58 dhe 73).

74. Në fund, Gjykata mund t'u japë më shumë peshë faktorëve sesa nevojës së ngutshme shoqërore për të justifikuar ndërhyrjen, si edhe ta fokusojë shqyrtimin e vet te këta faktorë, si edhe te fakti nëse arsyet e dhëna nga autoritetet kombëtare ishin relevante dhe të mjaftueshme për të gjetur baraspeshën mes interesave konkurrues (*Pentikäinen k. Finlandës* [DhM], § 114). Kështu, në çështjen *Pentikäinen k. Finlandës* [DhM], ku analizohen parametrat e mbrojtjes që ofron neni 10 për gazetarët që mbulojnë demonstratat në vende publike dhe detyrimet e gazetarëve sipas kësaj dispozite, Dhoma e Madhe nënvizoi së pari se sjellja e kontestuar nuk kishte të bënte në vetvete me veprimtarinë gazetareske të kërkuesit, por më tepër me refuzimin e tij për të vepruar në përputhje me urdhrat e ligjshëm dhe të arsyeshem të policisë. Më tej, theksoi se gazetarët, si rregull, nuk mund të përjashtohen nga detyrimi për t'iu bindur të drejtës penale me idenë se neni 10 u akordon një mbrojtje të hekurt (kjo vlen si krahasim për peshën që Gjykata i dha në arsyetim "nevojës së ngutshme shoqërore" me peshën që i dha gjykimi në Dhomë, shih § 64).

b. Vlerësimi i natyrës dhe ashpërsisë së sanksioneve⁵

75. Gjykata është veçanërisht e vëmendshme ndaj aspektit "censurues" të çdo ndërhyrjeje dhe duhet të bindet që sanksioni të mos arrijë formën e censurës që synon të dekurajojë shtypin në përcjelljen e kritikave (*Bédat k. Zvicrës* [DhM], § 79). Kështu, dënimi i një gazetari, para publikimit, krijoi bindjen te Gjykata se kjo ishte formë censure që e dekurajonte gazetarin të bënte kërkimet që ishin të qenësishme për punën e tij, me qëllim që të përgatiste shkrime për problematikën në fjalë (*Dammann k. Zvicrës*, § 57). Gjykata e ka përshkruar "censurën" si një urdhër që pezullon publikimin dhe shpërndarjen e gazetave, që e konsideron të pajustificuar, qoftë edhe për një periudhë të shkurtër (*Ürper dhe Të tjerë k. Turqisë*, § 44; shih edhe *Gözel dhe Özer k. Turqisë*, § 63).

76. Po kështu, një urdhër gjykate që ndalonte ekspozimin e një piktore dhe fotografitë e saj që të publikohen, si dhe që nuk kishte kufizim në kohë apo hapësirë, u gjet nga Gjykata si një urdhër joproporcional me qëllimin e ndjekur (*Vereinigung Bildender Künstler k. Austrisë*, § 37; lidhur me relevancën e kalimit të kohës në vlerësimin e proporcionalitetit, shih *Editions Plon k. Francës*, § 53).

i. Masa më pak kufizuese

⁵ Për më shumë informacion për natyrën dhe ashpërsinë e sanksioneve, shih kapitullin "XXX" më poshtë.

77. Gjykata çmon se një masë konsiderohet proporcionale dhe e nevojshme në një shoqëri demokratike vetëm kur nuk ka mjete të tjera për të arritur të njëjtin qëllim që do të ndërhynte ndjeshëm më pak në të drejtën themelore në fjalë (*Glor k. Zvicrës*, § 94).

78. Në analizën që i bën proporcionalitetit, Gjykata i kushtoi rëndësi faktit se gjyqtari vendas zgjodhi masën më pak kufizuese ndër shumë të mundshme (*Axel Springer SE dhe RTL Television GmbH k. Gjermanisë*, § 56; *Perinçek k. Zvicrës* [DhM], § 273; *Tagiyev dhe Huseynov k. Azerbajxhanit*, § 49) ose garantoi pengimin minimal të drejtave të shoqatës kërkuese (*Mouvement raëlien suisse k. Zvicrës* [DhM], § 75).

79. Në një çështje, shoqata kërkuese që bënte fushata në anije për dekriminalizimin e abortit, nuk u lejua me urdhër ministror që të hynte në ujërat territoriale portugeze. Gjykata theksoi se kur autoritetet vendosin të kufizojnë të drejtat themelore, ato duhet të zgjedhin mjetet që shkaktojnë paragjykimin minimal të mundshëm të të drejtave në fjalë, si edhe shembuj të disa masave të mundshme (*Women On Waves dhe Të tjerë k. Portugalisë*, § 41).

80. Në *Amorim Giestas dhe Jesus Costa Bordalo k. Portugalisë*, Gjykata gjeti haptazi joproporcionale dënimet e kërkuesve, së bashku me urdhrat për të paguar gjokat penale dhe dëme; ajo nënvizoi se Kodi Civil parashikonte një mjet specifik lidhur me mbrojtjen e nderit dhe reputacionit (shih edhe *Mätäsaru k. Republikës së Moldavisë*, § 36).

81. Njësoj edhe në çështjen *Fáber k. Hungarisë*, kërkuesi u paraburgos në polici dhe u urdhërua të paguante një gjobë për shkak se refuzoi të hiqte flamurin që tundte kundër nje demonstrate në formë proteste në atë veprimtari. Duke peshuar të drejtat e kërkuesit për lirinë e shprehjes dhe për tubim paqësor me të drejtën e demonstruesve të tjerë që të mos cenohen, Gjykata vlerësoi se Shteti ka detyrimin pozitiv që të mbrojë të drejtat e të dyja palëve dhe të gjejë mjetet më pak kufizuese të cilat, si rregull, mundësojnë zhvillimin e të dyja demonstratave (§ 43).

ii. Masa të përgjithshme

82. Në një çështje ku shqyrtohej nëse ndalimi i reklamës politike në median radiotelevizive ishte në përputhje me Konventën, Gjykata sqaroi kriteret e veta për të përcaktuar proporcionalitetin e një mase të përgjithshme. Gjykata duhet kryesisht të vlerësojë alternativat normative që qëndrojnë në themel të saj. Cilësia e rishikimit parlamentar dhe gjyqësor për nevojën e masës merr rëndësi të veçantë në këtë drejtim, përfshirë këtu edhe hapësirën e vlerësimit. Është logjike që sa më bindëse të jenë arsyet kryesore për masën e përgjithshme, aq më pak rëndësi Gjykata i kushton ndikimit që ka çështja në fjalë (*Animal Defenders International k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], §§ 108-109).

83. Me të njëjtat parime, Gjykata konkludoi në një tjetër çështje se autoritetet kombëtare kishin shkelur hapësirën e vlerësimit që ofron neni 10 i Konventës duke miratuar disa masa të përgjithshme dhe duke i zbatuar në rastet e kërkuesve (*Bayev dhe Të tjerë k. Ruisisë*, § 83).

84. Në fund, Gjykata vëren nëse ekziston konsensus evropian kur shqyrtohet hapësira kombëtare e vlerësimit lidhur me arsyetimin për masat e përgjithshme (*Animal Defenders International k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], § 123; *Bayev dhe Të tjerë k. Ruisisë*, § 66).

c. Kërkesa për masa relevante dhe arsye të mjaftueshme

85. Gjykata ka disponuar në mjaft çështje se mungesa e arsyetimit relevant dhe të mjaftueshme nga ana e gjykatave vendase apo mosmarrja parasysh e standardeve në vlerësimin e ndërhyrjes në fjalë, përbën shkelje

të nenit 10 (shih, mes shumë autoriteteve të tjera, *Uj k. Hungarisë*, §§ 25-26; *Sapan k. Turqisë*, §§ 35-41; *Gözel dhe Özer k. Turqisë*, § 58; *Scharsach dhe News Verlagsgesellschaft k. Austrisë*, § 46; *Cheltsova k. Rosisë*, § 100; *Mariya Alekhina dhe Të tjerë k. Rosisë*, § 264).

C. Konflikti mes dy të drejtave të mbrojtura nga Konventa: baraspeshimi

86. Mund të ndodhë që ushtrimi i të drejtës për lirinë e shprehjes të ndërhyjë në të drejtat e tjera të mbrojtura nga Konventa dhe Protokollat e saj. Në raste të tilla, Gjykata shqyrton nëse autoritetet kombëtare kanë vendosur baraspeshën e duhur midis mbrojtjes së të drejtës së lirisë së shprehjes dhe të drejtave të tjera, si edhe të drejtave dhe vlerave të garantuara prej Konventës (*Perinçek k. Zvicrës* [DhM], § 274).

87. Gjetja e baraspeshës së drejtë mund të kërkoj peshim të dy të drejtave me status të njëjtë, çka e ka shtyrë Gjykatën të miratojë një metodologji specifike që zbatohet në rastet ku ka një konflikt të qartë mes të drejtës së garantuar nga neni 10 i Konventës dhe një të drejtë tjetër të mbrojtur nga Konventa, sidomos të drejtat e personit të vënë në shënjestër nga deklaratat e kontestuara. Këto raste kanë të bëjnë kryesisht me të drejtat e mbrojtura nga neni 6 § 2 (*Bladet Tromsø dhe Stensaas k. Norvegjisë* [DhM], § 65; *Axel Springer SE dhe RTL Television GmbH k. Gjermanisë*, §§ 40-42; *Eerikäinen dhe Të tjerë k. Finlandës*, § 60) dhe nga neni 8 i Konventës (*Axel Springer AG k. Gjermanisë* [DhM], §§ 83-84; *Von Hannover k. Gjermanisë* (nr. 2) [DhM], §§ 104-107).

88. Parimet e përgjithshme që disiplinojnë metodologjinë në këto raste përmbledhen në vendime të ndryshme, veçanërisht në ato të Dhomës së Madhe (*Perinçek k. Zvicrës* [DhM], § 198; *Axel Springer AG k. Gjermanisë* [DhM], §§ 83-84; *Von Hannover k. Gjermanisë* (nr. 2) [DhM], §§ 104-107).

89. E drejta e respektimit të jetës private (neni 8 i Konventës), përfshirë të drejtën për mbrojtjen e reputacionit si një element i jetës private, është ndjeshëm konflikti më i shpeshtë që paraqitet para Gjykatës. Kapitulli V më poshtë fokusohet në këtë fushë.

90. Gjithashtu, më poshtë ilustrohen edhe çështje ku nene të tjera të Konventës mund të kenë qenë në konflikt me nenin 10.

1. Neni 6 § 2 i Konventës⁶

91. Liria e shprehjes e garantuar nga neni 10 i Konventës përfshin lirinë për të marrë dhe për të dhënë informacion. Prandaj, neni 6 § 2 nuk ndalon autoritetet që të informojnë publikun për hetimet penale në proces, por kërkon që këtë ta bëjnë me të gjithë diskrecionin dhe kujdesin e nevojshëm që kërkon respektimi i prezumimit të pafajësisë (*Alenet de Ribemont k. Francës*, § 38; *Fatullayev k. Azerbajxhanit*, § 159; *Garycki k. Polonisë*, § 69). Gjykata ka nënvizuar se rëndësinë e zgjedhjes së fjalëve nga zyrtarët publikë në deklaratat e tyre para se personi të gjykohet dhe të shpallet fajtor për një vepër penale të caktuar (*Daktaras k. Lituanisë*, § 41; *Arrigo dhe Vella k. Maltës* (vend.); *Khuzhin dhe Të tjerë k. Rosisë*, § 94).

92. Sa për fushatat e shtypit kundër të akuzuarit apo publikimet që përmbajnë aspekte akuzuese, Gjykata është shprehur se këto mund të paragjykojnë paanshmërinë e gjyqit duke ndikuar te opinionin publik dhe, rrjedhimisht, te trupa (gjyqësore) që vendos për fajin e të akuzuarit (*Khuzhin dhe Të tjerë k. Rosisë*, § 93).

2. Neni 9 i Konventës

⁶ Shih Kapitullin “ Mbrojtja e autoritetit dhe paanshmërisë së sistemit të drejtësisë dhe liria e shprehjes: e drejta e lirisë së shprehjes në kontekstin e proceseve gjyqësore dhe pjesëmarrja e gjyqtarëve në debatin publik” më poshtë.

93. Në çështjet që lidhen me mbrojtjen e moralit dhe fesë, Gjykata peshon të drejtën e [kërkuesit] për të ndarë me publikun pikëpamjet e veta mbi doktrinën fetare nga njëra anë, ndaj të drejtës së besimtarëve për lirinë e mendimit, ndërjegjes dhe besimit/fesë nga ana tjetër (*Aydın Tatlav k. Turqisë*, § 26).

94. Gjykata ka theksuar kërkesën e përgjithshme për të garantuar gëzim paqësor të të drejtave të garantuara nga neni 9 për personat që kanë këto besime, përfshirë detyrimin për të shmangur sa më shumë shprehjet që janë fyese për të tjerët dhe blasfemike – lidhur me objektet e përndërimit. Kështu, Gjykata ka nënvizuar se shprehjet që synojnë të nxitin apo të justifikojnë urrejtjen me bazë intolerancën, përfshirë këtu intolerancën fetare, nuk gëzojnë mbrojtjen e nenit 10 të Konventës (*E.S. k. Austrisë*, § 43; krahaso me konstatimin e shkëljes së nenit 10 lidhur me dënimin penal për deklarata që u cilësuan si sulm abuziv mbi fenë, ku autoritetet kombëtare dështuan të vlerësonin nëse përbënin nxitje të urrejtjes (*Tagiyev dhe Huseynov k. Azerbajxhanit*, §§ 48-50).

95. Në lidhje me lirinë e shprehjes së personave të punësuar në organizata fetare – liri kjo që mbrohet nga neni 10 i Konventës, ish-Komisioni shpalli të papranueshme kërkesën e një mjeku të punësuar në një spital katolik gjerman dhe të shkarkuar për nënshkrimin e një letre të hapur të botuar në shtyp, e cila shprehte një pikëpamje për abortin që binte ndesh me qëndrimin e Kishës Katolike (*Rommelfanger k. Gjermanisë*, vendim i Komisionit).

96. Në të kundërt, Gjykata konstatoi shkelje të nenit 10 në mosrinovimin e kontratës së punës së një pedagogu të filozofisë juridike në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit Katolik të Zemrës së Shenjtë në Milano. Kongregacioni për Edukimin Katolik, një institucion i Selisë së Shenjtë, nuk e kishte miratuar rinovimin me arsyetimin se disa qëndrime të tij "ishin në kundërshtim të qartë me doktrinën katolike", megjithëse pa specifikuar bazën e atyre pozicioneve. Gjykata pranoi se nuk u takonte autoriteteve vendase të shqyrtonin thelbin e vendimit të Kongregacionit. Sidoqoftë, pesha që Universiteti i kushtonte mësimdhënies bazuar në doktrinën katolike nuk mund të kishte aq shtrirje saqë - sipas mendimit të Gjykatës - të dëmtonte vetë përmbajtjen e garancive procedurale që neni 10 i Konventës ia njeh kërkuesit (*Lombardi Vallauri k. Italisë*).

3. Neni 11 i Konventës

97. Në vendimin *Fáber k. Hungarisë*, kërkuesi u paraburgos në polici dhe u urdhërua të paguante një gjobë për shkak se refuzoi të hiqte flamurin që tundte gjatë një demonstrate për qëllime kundërdemonstrate. Në peshimin e të drejtës së kërkuesit për lirinë e shprehjes dhe pretendimit të tij për tubim paqësor, përkund të drejtës së demonstratës të tjerë për mbrojtje nga prishja e veprimtarisë, Gjykata vlerësoi se Shteti ka detyrimin pozitiv që të mbrojë të drejtën e tubimit të të dyja palëve dhe të gjejë mjetet më pak kufizuese të cilat, si rregull, mundësojnë zhvillimin e të dyja demonstratave (§ 43).

4. Neni 1 i Protokollit nr. 1

98. Në një çështje lidhur me dënimin penal të fotografëve për shkelje të të drejtës së autorit përmes publikimit në internet të fotografive të sfilatave të modës, Gjykata çmoi se autoritetet vendase kishin gëzuar hapësirë vlerësimi veçanërisht të gjerë, duke pasur parasysh qëllimin e ndërhyrjes – konkretisht të drejtat e të tjerëve. Në gjykimin e Gjykatës meqë neni 1 i Protokollit nr. 1 zbatohet për pronësinë intelektuale, ndërhyrja gjithashtu synonte të mbronte garancitë e Konventës apo të Protokolleve të saj (*Ashby Donald dhe Të tjerë k. Francës*, § 40).

99. Çështja *Neij dhe Sunde Kolmisoppi k. Suedisë* (vend.) kishte të bënte me faktin se kërkuesit u dënuan me burgim pa kusht dhe u urdhëruan të paguanin dëmin për përfshirjen e tyre në drejtimin e *The Pirate Bay*, faqes më të madhe në internet që shpërndante skedarë torrent (muzikë, filma, lojëra, etj.), në shkelje të së drejtës së autorit. Gjykata shprehimisht njohu faktin se shpërndarja e këtyre skedarëve në internet – madje edhe në mënyrë të paligjshme apo për të nxjerrë fitime – bënte pjesë në të drejtën për "dhënie dhe marrje informacioni"

Udhëzuesi për nenin 10 të Konventës - Liria e shprehjes

në kuptimin e nenit 10 § 1. Ajo baraspeshoi dy të drejtat që gëzojnë mbrojtje të barabartë sipas Konventës, përkatësisht të drejtën për lirinë e shprehjes dhe të drejtat e pronësisë intelektuale, një fushë në të cilën Shteti gëzonte hapësirë të gjerë vlerësimi. Meqenëse autoritetet suedeze kishin detyrimin të mbronin të drejta pronësore të paditësve sipas Ligjit për Të Drejtën e Autorit dhe sipas Konventës, Gjykata çmoi se ekzistonin arsye të forta për të kufizuar lirinë e shprehjes së kërkuesve. Në këtë kontekst, Gjykata theksoi se kërkuesit janë dënuar vetëm për materiale e drejta e autorit e të cilave ishte e mbrojtur.

IV. Mbrojtja e reputacionit apo e të drejtave të të tjerëve

100. Mbrojtja e reputacionit apo e të drejtave të të tjerëve është qëllimi legjitim më i shpeshtë dhe që evokohet më së shumti në kërkesat pranë Gjykatës në kuadrin e nenit 10.

A. Metodologjia

101. Në arsyetimin e vendimeve për çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e reputacionit apo të të drejtave të të tjerëve, zbatohen dy metoda të dallueshme.

102. Gjykata përdor metodën "klasike" në analizën e proporcionalitetit për të konstatuar në bazë të rrethanave të mosmarrëveshjes që i paraqitet, se neni 8 nuk është i zbatueshëm për mbrojtjen e reputacionit apo të të drejtave të të tjerëve.

103. Metoda e dytë ose e ashtuquajtura përjasje e "baraspeshimit të të drejtave" zbatohet për kategorinë e çështjeve ku Gjykata çmon se neni 8 është i zbatueshëm për mbrojtjen e këtyre qëllimeve legjitime. Këto janë zakonisht çështje për publikimin e fotografive, imazheve apo shkrimeve që pasqyrojnë aspekte intime të jetës së një individi apo të familjes së vet (*Couderc dhe Hachette Filipacchi Associés k. Francës* [DhM], § 79; *Von Hannover k. Gjermanisë (nr. 2)* [DhM], § 103; *MGN Limited k. Mbretërisë së Bashkuar*, § 142).

104. Pas një zhvillimi në jurisprudencë që u konsolidua nga një gjykim i Dhomës së Madhe (*Axel Springer AG k. Gjermanisë* [DhM], § 83), mbrojtja e reputacionit mund të jetë – si element i jetës private – brenda fushëveprimit të nenit 8 të Konventës, me një kusht ama: për të qenë shkelje e të drejtave të garantuara nga neni 8, duhet të tejkalohet një "prag ashpërsie". Që neni 8 të hyjë në lojë në çështjet e shpifjeve, sulmi ndaj reputacionit të një personi duhet të përmbajë njëfarë niveli ashpërsie dhe duhet të jetë në një mënyrë që cenon gëzimin personal të së drejtës për jetë private.

105. Gjykata nënvizoi edhe se neni 8 nuk mund të evokohet për të pretenduar cenim reputacioni që vjen si pasojë e parashikueshme e vetë veprimeve të personit, si për shembull kryerja e një vepre penale (*Axel Springer AG k. Gjermanisë* [DhM], §§ 83-84; *Hachette Filipacchi Associés k. Francës*, § 43; *MGN Limited k. Mbretërisë së Bashkuar*, § 142; *Sidabras dhe Džiautas k. Lituanisë*, § 49).

106. Së pari, Gjykata përcakton parimet e përgjithshme që disiplinojnë metodologjinë për peshimin (apo baraspeshimin) e dy të drejtave dhe, së dyti, një listë joshteruese të kritereve të zbatueshme⁷.

107. Parimet e përgjithshme që zbatohen për metodologjinë e "baraspeshimit të të drejtave" janë përshkruar nga Gjykata në gjykimet e veta në Dhomë të Madhe të çështjeve *Von Hannover k. Gjermanisë (nr. 2)* [DhM] (§§ 104-107) dhe *Axel Springer AG k. Gjermanisë* [DhM] (§§ 85-88), dhe përmbledhen në gjykimin e *Perinçek k. Zvicrës* [DhM] (§ 198):

i. Në çështje të tilla, vendimmarrja nuk duhet të varet nga fakti nëse kërkesa është depozituar sipas nenit 8 nga personi që ka qenë objekt i deklaratave apo sipas nenit 10 nga personi që i ka bërë deklaratat sepse, në parim, të drejtat sipas këtyre neneve meritojnë respektim të barabartë (shih edhe *Delfi AS k. Estonisë* [DhM], § 110; *Satakunnan Markkinapörssi Oy dhe Satamedia Oy k. Finlandës* [DhM], § 163).

ii. zgjedhja e mjetit për të siguruar respektim të nenit 8 të sferën e marrëdhënieve të individëve mes tyre është në parim një çështje që bie brenda hapësirës së vlerësimit të Palës së Lartë Kontraktuese, pavarësisht nëse

⁷ Shih paragrafin XXX dhe në vijim më poshtë.

detyrimet mbi të janë pozitive apo negative. Ekzistojnë mënyra të ndryshme për të siguruar respektimin e jetës private, ndërsa natyra e detyrimit nga aspekti i jetës private që është në diskutim.

iii. Po kështu, sipas nenit 10 të Konventës, Palët e Larta Kontraktuese kanë njëfarë hapësire vlerësimi nëse dhe deri në çfarë mase nevojitet ndërhyrje në të drejtën e lirisë së shprehjes.

iv. Megjithatë, kjo hapësirë shkon dorë për dorë me mbikëqyrjen evropiane, duke përqafuar si legjislacionin edhe vendimet që e zbatojnë, përfshirë ato që jepen nga një gjykatë e pavarur. Në ushtrimin e funksionit mbikëqyrës, detyra e Gjykatës nuk është që të marrë vendin e gjykatave vendase, por të shqyrtojë çështjen në tërësi nëse vendimet e tyre janë në pajtim me dispozitat e Konventës mbi të cilat bazohen.

v. Nëse baraspeshimi i të drejtave kryhet nga autoritetet kombëtare në pajtim me kriteret e përcaktuara në jurisprudencën e Gjykatës, Gjykatës duhet t'i paraqiten arsye të forta që të zëvendësojë pikëpamjet e saj me të tyret (*Delfi AS k. Estonisë* [DhM], § 139; *MGN Limited k. Mbretërisë së Bashkuar*, § 150).

108. Kështu, Gjykata mund të zgjedhë ta kryejë vetë baraspeshimin, kur vëren shkaqe të forta për ta bërë diçka të tillë (*Perinçek k. Zvicrës* [DhM], §§ 274-279).

109. Nëse baraspeshimi i gjetur nga autoritetet kombëtare është i pakënaqshëm, sidomos sepse rëndësia apo fushëveprimi i një prej të drejtave nuk është vlerësuar siç duhet, hapësira e vlerësimit që u është akorduar Shteteve do të jetë e ngushtë (*Aksu k. Turqisë* [DhM], § 67).

110. Nëse autoritetet anëtare kanë bërë baraspeshim të cunguar të dy të drejtave që gëzojnë mbrojtje të barabartë nga Konventa, metodologjia e zbatuar prej Gjykatës mund të rezultojë në konstatim të shkeljes procedurale të nenit 10 (*Ibragim Ibragimov dhe Të tjerë k. Rosisë*, §§ 106-111); ose Gjykata vendos të kryejë vetë baraspeshimin kur konstaton shkaqe të rënda për ta bërë këtë (*Perinçek k. Zvicrës* [DhM], §§ 274-279; *Tête k. Francës*, §§ 57-70), ose, pa bërë baraspeshim vetë, konkludon se ndërhyrja nuk ishte e nevojshme në një shtet demokratik (*Ergüdoğan k. Turqisë*, §§ 32-35).

B. Baraspesha e drejtë mes lirisë së shprehjes dhe të drejtës për jetë private në kontekstin e publikimeve (aspektet intime të jetës dhe reputacionit të individit)

111. Parimet e përgjithshme që rrjedhin nga jurisprudenca e Gjykatës lidhur me mbrojtjen e jetës private në kontekstin e një shkrimi shtypi paraqiten ndër të tjera në pikat 83 dhe 87 të vendimit në çështjen *Couderc dhe Hachette Filipacchi Associés k. Francës* [DhM]. Parimet e përgjithshme lidhur me të drejtën e lirisë së shprehjes në këtë kontekst theksohen në pikat 88 dhe 93 të atij vendimi.

112. Kështu, Gjykata është shprehur se megjithëse shtypi nuk duhet të kapërcejë kufij të caktuar, veçanërisht në lidhje me mbrojtjen të reputacionit dhe të të drejtave të të tjerëve, prapëseprapë detyra e tij është të japë informacion dhe ide për çështje me interes publik – në një mënyrë që është në përputhje me detyrimet dhe përgjegjësitë e shtypit.

113. Jo vetëm shtypi ka detyrën që të japë të tillë informacion dhe ide, por edhe publiku ka të drejtë t'i marrë ato. Po të ishte ndryshe, shtypi do ta kishte të pamundur të luante rolin jetik të "rojtarit publik" (*Bladet Tromsø dhe Stensaas k. Norvegjisë* [DhM], §§ 59 dhe 62; *Pedersen dhe Baadsgaard k. Danimarkës* [DhM], § 71; *Von Hannover k. Gjermanisë (nr. 2)* [DhM], § 102).

114. Kështu që detyra e dhënies së informacionit përfshin domosdoshmërisht detyra dhe përgjegjësitë, si dhe kufij që shtypi duhet t'ia imponojë vetes mënyrë spontane (*Mater k. Turqisë*, § 55). Nuk i takon Gjykatës, madje

as gjykatave vendase, që të zëvendësojnë pikëpamjet e tyre me ato të shtypit se çfarë teknike raportimi duhet të përdorin gazetarët në çdo rast specifik (*Jersild k. Danimarkës*, § 31; *Stoll k. Zvicrës* [DhM], § 146).

1. Publikime (fotografi, imazhe dhe shkrime) lidhur me aspektet intime të jetës së individit apo të familjes së vet

115. Liria e shprehjes përfshin edhe publikimin e fotografive. Në këtë fushë, mbrojtja e të drejtave dhe reputacionit të të tjerëve merr rëndësi të veçantë, pasi fotografitë mund të përmbajnë të dhëna shumë personale dhe madje intime për një individ apo familjen e vet (*Von Hannover k. Gjermanisë (nr. 2)* [DhM], § 103).

116. Gjykata njih të drejtën e çdo personi për mbrojtjen e imazhit të vet, duke theksuar se imazhi i personit përbën një nga veçoritë kryesore të personalitetit të tij, sepse zbulon karakteristikat unike të personit dhe e dallon atë nga të tjerët. E drejta e mbrojtjes së imazhit personal është kështu një nga komponentët thelbësorë të zhvillimit personal dhe presupozon kryesisht të drejtën e individit që të kontrollojë përdorimin e imazhit të vet, përfshirë të drejtën për të refuzuar publikimin e tij (*Von Hannover k. Gjermanisë (nr. 2)* [DhM], § 96).

a. Kriteret dhe zbatimi i tyre⁸

117. Gjykata ka përcaktuar parimet përkatëse që duhet të drejtojnë vlerësimin e saj dhe mbi të gjitha vlerësimin e gjykatave vendase, nëse ishte e nevojshme apo jo ndërhyrja në këtë fushë. Kështu, Gjykata ka identifikuar disa kriteresh në kontekstin e baraspeshimit të të drejtave konkurruese (*Axel Springer AG k. Gjermanisë* [DhM], §§ 90-95).

118. Pesë kriteret përkatëse janë: kontributi në një debat me interes publik; shkalla e famës e personit të prekur; tema e lajmit/shkrimit; sjellja paraprake e personit në fjalë; përmbajtja, forma dhe pasojat e botimit; dhe, sipas rastit, rrethanat në të cilat janë bërë fotografitë (*Von Hannover k. Gjermanisë (nr. 2)* [DhM], §§ 109-113; *Von Hannover k. Gjermanisë (nr. 3)*, § 46; *Axel Springer AG k. Gjermanisë* [DhM], §§ 89-95; *Tănăë k. Rumanisë*, § 41). Kur shqyrton një kërkesë të depozituar nën nenin 10, Gjykata do të shqyrtojë edhe mënyrën si është përfutur informacioni dhe vërtetësinë e tij, si edhe ashpërsinë e dënimit ndaj gazetarëve apo publikuesve (*Couderc dhe Hachette Filipacchi Associés k. Francës* [DhM], § 93; *Axel Springer AG k. Gjermanisë* [DhM], §§ 90-95).

119. Gjykata analizon në secilën çështje nëse kriteret e përcaktuar mund të transpozohen në çështjen në fjalë, edhe pse ndonjë kriter mund të jetë më shumë apo më pak relevant nisur nga rrethanat e çështjes (*Satakunnan Markkinapörssi Oy dhe Satamedia Oy k. Finlandës* [DhM], § 166).

120. Po edhe kriteret të tjera mund të mbahen parasysh, në varësi të rrethanave të posaçme të çështjes. Kështu, në vendimin për *Axel Springer SE dhe RTL Television GmbH k. Gjermanisë*, lidhur me një gjyq për vrasje dhe ndalimin e publikimit të imazheve nga të cilat mund të identifikohet pandehuri, Gjykata shtoi një kriter të ri, konkretisht "influcencën e procesi penal" (§ 42).

i. Kontributi në një debat me interes publik

121. Gjykata gjithmonë i ka kushtuar vëmendje të veçantë faktit se publikimi i informacionit, dokumenteve apo fotografive në shtyp i shërben interesit publik dhe kontribuon në një debat me interes të përgjithshëm. Ky interes mund të konstatohet vetëm në dritën e rrethanave të secilës çështje (*Von Hannover k. Gjermanisë (nr. 2)* [DhM], § 109; *Leempoel & S.A. ED. Ciné Revue k. Belgjikës*, § 68; *Standard Verlags GmbH k. Austrisë*, § 46; *Von Hannover k. Gjermanisë*, § 60).

⁸ Këto kriteret janë të zbatueshme edhe për mbrojtjen e reputacionit, për aq sa janë relevante.

122. Në këtë kontekst, Gjykata ka disponuar vazhdimisht se ka pak hapësirë në fushëveprimin e nenit 10 § 2 të Konventës për kufizime në gjuhën politike apo debatin mbi çështje me interes publik (*Castells k. Spanjës*, § 43; *Wingrove k. Mbretërisë së Bashkuar*, § 58).

123. Sipas Gjykatës, interesi publik zakonisht lidhet me çështje që prekin publikun në një masë të tillë që i legjitimon të kenë interes për to, të cilat tërheqin vëmendjen e publikut ose e shqetësojnë në një shkallë të konsiderueshme, veçanërisht kur ndikojnë në mirëqenien e qytetarëve ose në jetën e komunitetit. Kjo vlen edhe për çështjet që janë në gjendje të krijojnë polemika të mëdha, të cilat kanë të bëjnë me një çështje të rëndësishme shoqërore, ose një problem për të cilin publiku do të kishte interes të informohet (*Satakunnan Markkinapörssi Oy dhe Satamedia Oy k. Finlandës* [DhM], § 171).

124. Gjykata e njohu këtë interes, për shembull, kur publikimi ka të bëjë me informacion për gjendjen mjekësore të një kandidati për një post të lart shtetëror (*Éditions Plon k. Francës* § 44), problematika sportive (*Nikowitz dhe Verlagsgruppe News GmbH k. Austrisë*, § 25; *Colaço Mestre dhe SIC – Sociedade Independente de Comunicação, S.A. k. Portugalisë*, § 28); artistët performues (*Sapan k. Turqisë*, § 34), procedimet penale në përgjithësi (*Dupuis dhe Të tjerë k. Francës*, § 42; *July dhe SARL Libération k. Francës*, § 66), krimet e kryera (*White k. Suedisë*, § 29; *Egeland dhe Hanseid k. Norvegjisë*, § 58; *Leempoel & S.A. ED. Ciné Revue k. Belgjikës*, § 72; *Eerikäinen dhe Të tjerë k. Finlandës* § 59) ose një "skandal seksual" brenda një partie politike me përfshirjen e anëtarëve të caktuar të qeverisë (*Kaçki k. Polonisë*, § 55).

125. Sipas jurisprudencës së Gjykatës, çështjet e interesit publik përfshijnë edhe administrimin e drejtësisë (*Morice k. Francës* [DhM], § 128), mbrojtja e mjedisit dhe shëndetit publik (*Mamère k. Francës*, § 20) dhe ngjarjet historike (*Dink k. Turqisë*, § 135). Gjykata gjithashtu e çmon thelbësore në një shoqëri demokratike që debati për shkaqet e veprimeve të rënda që rezultojnë në krime ndaj njerëzimit duhet të zhvillohet lirshëm (*Giniewski k. Francës*, § 51).

126. Ndërkohë që publiku ka të drejtë të informohet, artikujt ose programet televizive që synojnë vetëm të shuajnë kureshtjen e një audience të veçantë në lidhje me detajet e jetës private të një personi nuk mund të konsiderohet se kontribuojnë në ndonjë debat me interes të përgjithshëm për shoqërinë (*Von Hannover k. Gjermanisë (nr. 2)* [DhM], § 59; *Hachette Filipacchi Associés k. Francës*, § 42; *Rubio Dosamantes k. Spanjës*, § 34; *MGN Limited k. Mbretërisë së Bashkuar*, § 143), madje edhe duke supozuar se personi në fjalë është i mirënjohur mirë (*Von Hannover k. Gjermanisë (nr. 2)* [DhM], § 95). Në lidhje me këtë, Gjykata ka ritheksuar se interesi publik nuk mund të minimizohet në etjen e publikut për informacion në lidhje me jetën private të të tjerëve, ose në dëshirën e lexuesit për bujë apo edhe soditje (*Couderc dhe Hachette Filipacchi Associés k. Francës* [DhM], § 101).

127. Në çështjen e *Khurshid Mustafa dhe Tarzibachi k. Suedisë*, në të cilën kërkuesit me origjinë nga Iraku dëshironin të merrnin programe televizive në gjuhët arabe dhe farsi nga vendi ose rajoni i tyre amtar, Gjykata theksoi se liria për të marrë informacion shtrihet jo vetëm në raportimet e ngjarjeve me interes publik, por përfshin në parim edhe shprehje kulturore si dhe argëtimin. Ajo theksoi rëndësinë, veçanërisht për një familje emigrante me tre fëmijë, për të mbajtur kontakte me kulturën dhe gjuhën e vendit të tyre të origjinës (§ 44).

ii. Masa sa i njohur është personi në fjalë

128. Gjykata ka theksuar se masa sa profil publik ka një individ apo sa i mirënjohur është, ndikon te mbrojtja që mund t'i akordohet jetës private të këtij personi. Roli ose funksioni i personit në fjalë dhe natyra e aktiviteteve që janë objekt i raportimit dhe/ose fotografive përbëjnë një tjetër kriter të rëndësishëm, lidhur me të parin (*Von Hannover k. Gjermanisë (nr. 2)* [DhM], § 110; *Verlagsgruppe News GmbH k. Austrisë (nr. 2)*, § 34; *Alpha Doryforiki Tileorasi Anonymi Etairia k. Greqisë*, § 53).

129. Publiku ka të drejtë të informohet, sepse kjo është një e drejtë thelbësore në një shoqëri demokratike e cila, në rrethana të posaçme, mund të shtrihet edhe në aspekte të jetës private të figurave publike, sidomos politikanët (*Von Hannover k. Gjermanisë (nr. 2)* [DhM], § 64; *Karhuvaara dhe Iltalehti k. Finlandës*, § 45). Edhe pse publikimi i lajmeve për jetën private të figurave publike bëhet zakonisht për argëtim sesa për edukim, prapë kontribuon në larminë e informacionit që i serviret publikut dhe padyshim që përfiton nga mbrojtja e nenit 10 të Konventës. Megjithatë, kjo mbrojtje mund të cedojë para kërkesave të nenit 8 kur informacioni ka natyrë private dhe intime saqë nuk ka interes publik në përhapjen e tij (*Mosley k. Mbretërisë së Bashkuar*, § 131; *Von Hannover k. Gjermanisë (nr. 2)* [DhM], § 110).

130. Në çështjen *Couderc dhe Hachette Filipacchi Associés k. Francës* [DhM], Gjykata përsëriti se e drejta e figurave publike për të mbajtur sekret jetën e tyre private është, në parim, më e gjerë kur nuk mbajnë ndonjë funksion zyrtar dhe është më e kufizuar kur e mbajnë një funksion të tillë. Fakti i ushtrimit të një funksioni publik ose i aspiratës për post politik e ekspozon patjetër individin në vëmendjen e bashkëqytetarëve të vet, përfshirë këtu edhe fushat që hyjnë në jetën private të dikujt. Prandaj, veprime të caktuara private të figurave publike nuk konsiderohen të tilla, duke pasur parasysh ndikimin e tyre të mundshëm nisur nga roli që ata luajnë në skenën politike ose shoqërore dhe interesin rezultues të publikut për t'u informuar për to (§§ 119-120).

131. Kështu, Gjykata theksoi rëndësinë e rolit dhe funksionit të një individi të shënjestruar nga deklaratat e kontestuara që e akuzuan atë se i kishte ofruar një prej ndihmësve të vet punësim të paguar në këmbim të favoreve seksuale, në një kohë kur, përveç se figurë publike, ai ishte edhe anëtar i Parlamentit Evropian, gjatë ushtrimit të funksioneve të tij zyrtare (*Kaçki k. Polonisë*, §§ 54-55).

132. Zbatimi i këtij arsytimi shtrihet përtej figurave politike dhe përfshin çdo person që mund të konsiderohet figurë publike, pra, edhe personat të cilët me veprimet apo pozitën e tyre kanë hyrë në arenën publike (*Kapsis dhe Danikas k. Greqisë*, § 35; shih, për statusin e anëtarëve të Këshillit Konsultativ të cilët ishin të afërta me ekspertët e caktuar nga autoritetet publike për të shqyrtuar çështje specifike, *Kaboğlu dhe Oran k. Turqisë*, § 74).

133. Për rrjedhojë, Gjykata disponoi se biznesmeni ishte figurë publike (*Verlagsgruppe News GmbH k. Austrisë (nr. 2)*, § 36).

134. Nga ana tjetër, në një çështje që ka të bëjë me dënimin e një gazetari për publikimin e informacionit sekret të hetimit penal, posaçërisht letrat e dërguara nga i akuzuari te gjyqtari hetues dhe informacioni i një natyre mjekësore, Gjykata vendosi që autoritetet kombëtare nuk i nënshtrohen thjesht detyrimit negativ për të mos zbuluar me dashje informacionin e mbrojtur nga neni 8, por duhet edhe të kishin ndërmarrë hapa për të siguruar mbrojtje efektive të së drejtës së një personi të akuzuar për të pasur korrespondencë (*Bédat k. Zvicrës* [DhM], § 76; shih edhe *Craxi k. Italisë (nr. 2)*, § 73).

Në këndvështrimin e Gjykatës, ky lloj informacioni kërkon shkallë më të lartë mbrojtjeje nën nenin 8; ky vlerësim është veçanërisht i rëndësishëm pasi i akuzuari nuk ishte i njohur publikisht. Thjesht fakti që ai ishte objekt i një hetimi penal për një vepër penale shumë të rëndë, nuk e justifikon trajtimin e tij njësoj si të ishte figurë publike që e ekspozon veten me vullnet të lirë para publicitetit (shih edhe në kontekst krahasues, *Fressoz dhe Roire k. Francës* [DhM], § 50; *Egeland dhe Hanseid k. Norvegjisë*, § 62; për detyrimin e mbrojtjes së identitetit të palës së dëmtuar, shih *Kurier Zeitungsoverlag und Druckerei GmbH k. Austrisë*).

iii. Sjellja e mëparshme e personit në fjalë

135. Në çështjen *Von Hannover k. Gjermanisë (nr. 2)* [DhM], Gjykata çmoi se sjellja e personit në fjalë para publikimit të raportit, apo fakti që fotoja në fjalë dhe informacioni përkatës ishin shfaqur më herët në një tjetër publikim, janë faktorë që duhen mbajtur parasysh (§ 111).

136. Kështu, në çështjen *Hachette Filipacchi Associés k. Francës*, Gjykata çmoi se zbulimet e informacionit për një këngëtar, sapo bëhen publike, dobësojnë shkallën e mbrojtjes për jetën e tij private që ai gëzon, sepse atëherë ishte bërë lajm i ditur gjerësisht. Për sa kohë që gazetari kërkues kishte riprodhuar pa shtrembërime pjesë të informacionit që ishte përhapur dhe bërë publik nga këngëtari, sidomos në autobiografinë e vet, për pasuritë e veta dhe mënyrën si harxhonte paratë, Gjykata vlerësoi se ai nuk kishte më "pritshmërinë legjitime" që jeta e tij private do të mbrojtjen me efektivitet (§§ 52-53; shih edhe *Minelli k. Zvicrës* (vend.)).

137. Nga ana tjetër, Gjykata specifikon se thjesht fakti i bashkëpunimit me shtypin në raste të mëparshme nuk mund të shërbejë si argument për privimin e palës së interesuar nga çdo mbrojtje ndaj publikimit. Toleranca ose shpërfillja e mëparshme e pretenduar ose reale e individit në lidhje me publikime që i prekin jetën private nuk i heq domosdoshmërisht personit në fjalë të drejtën e privatësisë (*Couderc dhe Hachette Filipacchi Associés k. Francës* [DhM], § 130).

138. Në një kontekst që përveç nenit 8 evokonte edhe nenin 6 § 2 të Konventës, Gjykata u shpreh se rrëfimi i fajit nuk e privon të akuzuarit nga e drejta që të mos portretizohet si fajtor përmes publikimit të fotografive për të cilat nuk kishte dhënë pëlqimin, deri në momentin e shpalljes së vendimit (*Axel Springer SE dhe RTL Television GmbH k. Gjermanisë*, § 51).

139. Gjykata mban parasysh edhe sjelljen e mëparshme të një kompanie për të vlerësuar shkallën e tolerancës ndaj kritikave që pritet prej saj. Në çështjen *Kuliś dhe Różycki k. Polonisë*, ku kërkuesit kishin publikuar një film vizatimor satirik ku përshkruanin patatinat e paditësit - që ishte kompani e prodhimit të artikujve ushqimorë - si plehra, Gjykata e pranoi se fjala e përdorur ishte e ekzagjeruar, por, ata reagues ndaj sloganeve që vetë paditësi kishte përdorur në fushatën e reklamave ku shfaqej një mungesë ndjeshmërie dhe mirëkuptimi për moshën dhe cënueshmërinë e konsumatorëve të synuar të produktit të tyre, konkretisht për fëmijët. Kështu, Gjykata vlerësoi se stili i shprehjes së kërkuesve ishte motivuar nga sloganet ndaj të cilave reagues dhe, duke pasur parasysh këtë kontestit, nuk i tejkaluan kufijtë e lejuar të lirisë së shtypit (§ 39).

iv. Metoda e marrjes së informacionit dhe vërtetësia e tij

140. Gjatë vlerësimit nëse një publikim ndërhyr në të drejtën e kërkuesit për respektimin e jetës së vet, Gjykata merr parasysh mënyrën në të cilën është marrë informacioni ose fotografia. Në veçanti, ajo thekson rëndësinë e marrjes së pëlqimit të personave në fjalë si dhe nëse fotografia shkakton ndërhyrje të vogël apo të madhe në jetën e tjetrit (*Von Hannover k. Gjermanisë*, § 59; *Gurgenidze k. Gjeorgjisë*, §§ 55-60; *Hachette Filipacchi Associés k. Francës*, § 48).

141. Në lidhje me këtë, Gjykata ka pasur rastin të vlerësojë se fotografitë që shfaqen në shtypin "sensacionalist" ose në revistat "rozë", që përgjithësisht synojnë të shuajnë kureshtjen e publikut për detajet e jetës rreptësisht private të një personi, shpesh merren në një klimë ngacmimi të vazhdueshëm i cili mund të shkaktojë te personi në fjalë një ndjenjë shumë të fortë të ndërhyrjes në jetën e tyre private apo edhe të përndjekjes (*Von Hannover k. Gjermanisë*, § 59; *Société Prisma Presse k. Francës (nr. 1)* (vend.); *Société Prisma Presse k. Francës (nr. 2)* (vend.); *Hachette Filipacchi Associés k. Francës*, § 40).

142. Sa i përket shpërndarjes së videove të regjistruara me kamera të fshehtë, Gjykata ka shqyrtuar, ndër të tjera, nëse pamjet në fjalë janë filmuar në ambiente publik apo privat. Ajo vendosi që në ambiente publike, një figurë publike, si e tillë, duhet ta presë që sjellja e tij/saj të monitorohet nga afër dhe madje të regjistrohet me

kamera, ndërsa në ambiente private, i njëjti person ka pritshmërinë legjitime të gëzimit të privatësisë (*Alpha Doryforiki Tileorasi Anonymi Etairia k. Greqisë*, §§ 64-65; shih edhe *Von Hannover k. Gjermanisë*, § 52).

143. Në një rast ku një kompani audiovizive u penalizua kryesisht për transmetimin e informacionit që dikush tjetër kishte marrë në mënyrë të paligjshme, Gjykata çmoi se ky fakt, i marrë vetëm, nuk mjafton që të privojë kompaninë ankuese nga mbrojtja e nenit 10 të Konventës. Sa i përket bisedës telefonike ndërmjet anëtarëve të qeverisë të transmetuar nga kompania ankuese, Gjykata theksoi disa pika mbi mënyrën e marrjes së informacionit dhe vërtetësinë e tij: ajo vuri në dukje se në asnjë fazë nuk ishte pretenduar që kompania ankuese apo punonjësit ose agjentët e saj ishin në çfarëdo mënyre përgjegjës për regjistrimin ose që gazetarët e saj shkelën ligjin penal kur e morën apo e transmetuan materialin. Gjithashtu, Gjykata vuri në dukje se kurrë nuk pati asnjë hetim nga institucionet vendases për rrethanat në të cilat u bë regjistrimi. Së fundmi, ajo vuri në dukje se nuk ishte vërtetuar para gjykatave vendase që regjistrimi përmbante ndonjë informacion të pavërtetë ose të shtrembëruar, apo që informacioni dhe idetë e shprehura në lidhje me të nga gazetari i kompanisë kërkuese kishin shkaktuar ndonjë dëm të veçantë të ndershmërisë personale dhe reputacionit të paditësit (*Radio Twist a.s. k. Sllovakisë*, §§ 59-62).

144. Për më tepër, marrja e pëlqimit të personave në fjalë bën të mundur vlerësimin e vërtetësisë dhe drejtësisë së mjeteve për marrjen e informacionit dhe bërjen publike të tij (*Couderc dhe Hachette Filipacchi Associés k. Francës* [DhM], § 134; shih, a contrario, *Reklos dhe Davourlis k. Greqisë*, § 41, dhe *Gurgenidze k. Gjeorgjisë*, § 56). Në çështjen *Peck k. Mbretërisë së Bashkuar*, duke iu referuar jurisprudencës përkatëse të ish-Komisionit, Gjykata vendosi se regjistrimi dhe publikimi i një tentative vetëvrasjeje në ambient publik përbënte ndërhyrje të rëndë në të drejtën e kërkuesit për respektimin e jetës së vet private (§§ 61-62).

145. Së fundmi, në një rast ku Gjykata shqyrtoi baraspeshën e duhur që duhet gjetur midis të drejtave të mbrojtura nga neni 10 dhe atyre të mbrojtura nga neni 8 në lidhje me një artikull të shoqëruar me fotografi intime të marra nga pamjet të regjistruara fshehurazi në lidhje me aktivitetet e pretenduara seksuale dhe "naziste" të një figurë publike, Gjykata çmoi se neni 8 i Konventës nuk presupozon njoftim paraprak ligjorësi detyrues para publikimit të informacionit rreth jetës private të një personi (*Mosley k. Mbretërisë së Bashkuar*, § 132).

v. Përmbajtja, forma dhe pasojat e artikullit të kontestuar

146. Gjykata gjithmonë është shprehur se neni 10 i Konventës mbron jo vetëm substancën e ideve dhe informacionit të shprehur, por edhe formën me të cilën përcillen (*De Haes dhe Gijssels k. Belgjikës*, § 48; *Jersild k. Danimarkës*, § 31; *Oberschlick k. Austrisë (nr. 1)*, § 57).

147. Lidhur me përmbajtjen dhe formën e artikujve të kontestuar, parimi i gjithmonshëm ka qenë që ekziston - e qenësishme në profesionin e gazetarit - liria për të trajtuar subjekte siç e shohin të përshtatshme. Gjykata ka theksuar, për shembull, se nuk i takon as asaj dhe as gjykatave vendase që të zëvendësojnë pikëpamjet e tyre me ato të shtypit në këtë fushë (*Couderc dhe Hachette Filipacchi Associés k. Francës* [DhM], § 139; *Jersild k. Danimarkës*, § 31). Gjithashtu, Gjykata është shprehur se neni 10 i Konventës ua lë gazetarëve të vendosin cilat detaje duhet të publikojnë për të garantuar besueshmërinë e artikullit (*Fressoz dhe Roire k. Francës* [DhM], § 54).

148. Në çdo rast, Gjykata çmon se kurdo që informacioni përcjell jetën private të një personi, gazetarët duhet të mbajnë parasysh - për aq sa është e mundur - ndikimin e informacionit dhe imazheve që do të publikohen para përhapjes së tyre (*Couderc dhe Hachette Filipacchi Associés k. Francës* [DhM], § 140).

149. Çështja *Haldimann dhe Të tjerë k. Zvicrës* kishte të bënte me dënimin e gazetarëve për filmimin dhe transmetimin - për qëllime të interesit publike - të një interviste me një broker sigurimesh. Edhe pse regjistrimi

235. Gjykata i kushton vëmendje të konsiderueshme ashpërsisë së një sanksioni penal në çështjet e shpifjes, veçanërisht në çështje me interes publik. Për këtë, Gjykata ka theksuar se dhënia e një dënimi me burg për një shkelje të shtypit është në përputhje me lirinë e shprehjes së gazetarëve siç e garanton neni 10 i Konventës vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, veçanërisht kur të drejtat e tjera themelore janë cenuar rëndë si, për shembull, në rastet e gjuhës së urrejtjes ose nxitjes së dhunës (*Cumpănă dhe Mazăre k. Rumanisë* [DhM], § 115; *Ruokanen dhe Të tjerë k. Finlandës*, § 50; shih edhe *Fatullayev k. Azerbajxhanit*, §§ 129 dhe 177, ku Gjykata e përshkroi dënimin me 2 vjet e 6 muaj burg ndaj kërkuesit si "tmerrësisht joproporcional" dhe udhëzoi që të lirohet menjëherë).

236. Kështu, lidhur me dënimin penal të një biznesmeni për gjuhë të urrejtjes ndaj etnive, e plotësuar edhe me gjobë dhe ndalim dyvjeçar të ushtrimit të aktiviteteve gazetareske apo botuese, Gjykata çmoi se nuk ka asnjë shkelje të nenit 10 (*Atamanchuk k. Rusisë**, § 72).

237. Në çështjen *Bédat k. Zvicrës* [DhM], Gjykata theksoi se synon që penalteti të mos arrijë formën e censurës që ka për qëllim të shkurajojë shtypin që të shprehë kritika. Më tej, u shpreh se ky sanksion ka gjasa të frenojë

gazetarët që të kontribuojnë në debatin publik mbi problematika që prekin jetën e komunitetit (§ 79; shih edhe *Toranzo Gomez k. Spanjës*, § 64; *Lewandowska-Malec k. Polonisë*, § 70; *Barthold k. Gjermanisë*, § 58; *Lingens k. Austrisë*, § 44; *Monnat k. Zvicrës*, § 70).

238. Në çështjet lidhur me shtypin, Gjykata ka disponuar se natyra penale e sanksionit është më e rëndësishme sesa natyra e lehtë e sanksionit të dhënë (*Stoll k. Zvicrës* [DhM], § 154; *Haldimann dhe Të tjerë k. Zvicrës*, § 67).

239. Ky arsyetim gjendet edhe në *De Carolis dhe France Télévisions k. Francës*, ku Gjykata theksoi se edhe pse sanksioni është më i lehti i mundshëm, si p.sh. një vendim fajësie që e çliron nga dënimi penal dhe dëmshpërblen me "një euro simbolike", prapë përbën sanksion penal (§ 63; shih edhe *Jersild k. Danimarkës*, § 35; *Brasilier k. Francës*, § 43; *Morice k. Francës* [DhM], § 176).

240. Përkundrazi, në çështjen *Pedersen dhe Baadsgaard k. Danimarkës* [DhM], Gjykata çmoi se ekzistonte "nevojë e ngutshme shoqërore" për të marrë masa lidhur me akuzat e rënda të bëra nga gazetarët, të cilit nuk ishin përpjekur për t'i vërtetuar. Gjykata nuk i gjeti kundërvajtjet penale si të tepërta dhe as se kishin "efekt frenues" në ushtrimin e lirisë së medias (§§ 92-94). Për më tepër, Gjykata Supreme vendase e kishte pranuar shprehimisht peshën që i kushton lirisë së gazetarisë në një shoqëri demokratike (§ 71).

241. Për më tepër, parimi i vetëpërmbytjes para se të bëhet padi penale për shpifje nuk kufizohet vetëm te liria e gazetarisë, por zbatohet për çdo individ. Për ta ilustruar, në çështjen *Kanellopoulou k. Greqisë*, Gjykata çmoi se dënimi me privim lirie i kërkuesit për sulmin ndaj reputacionit të një kirurgu ishte joproporcional. Në atë çështje, mjetet juridike që ofron ligji civil do të ishin të mjaftueshme për të mbrojtur reputacionin e doktorit (§ 38; shih edhe *Mätäsaru k. Republikës së Moldavisë*, § 35; shih *Nikula k. Finlandës*, § 55, lidhur me dënimin penal të një avokati.

242. Në këtë kontekst, Gjykata shpesh i është referuar Rezolutës 1577 (2007) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës e cila nxit Shtetet legjislatore të cilave ende parashikon dënime me burg për shpifje – edhe pse praktikisht nuk jepen dënime me burg – që t'i shfuqizojnë ato pa vonesë (*Otegi Mondragon k. Spanjës; Artun dhe Güvener k. Turqisë; Mariapori k. Finlandës*, § 69; *Niskasaari dhe Të tjerë k. Finlandës*, § 77; *Saaristo dhe Të tjerë k. Finlandës*, § 69; *Ruokanen dhe Të tjerë k. Finlandës*, § 50).

ß. Masat civile restauruese dhe sanksionet

- **Dëmet**

243. Gjykata e pranon se legjislatoret e brendshme lidhur me llogaritjen e dëmshpërblimeve për cenim të reputacionit duhet të mbajnë parasysh larminë e situatave faktike. Mund të duhet një shkallë e konsiderueshme fleksibiliteti për të lejuar juritë të vlerësojnë dëmet që lidhen me faktet e çështjes (*Tolstoy Miloslavsky k. Mbretërisë së Bashkuar*, § 41).

244. Në konstatimin e vet se ishte dhënë një dëmshpërblim shumë i madh dhe disproporcional në çështjen *Tolstoy Miloslavsky k. Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata theksoi se kjo ndodhi ngaqë mungonin garancitë adekuate dhe efektive në atë kohë ndaj dëmshpërblimeve të mëdha dhe disproporcionale (§ 51; shih, me efektet të njëjtë, *Independent Newspapers (Ireland) Limited k. Irlandës*, § 105).

245. Kur vlerëson proporcionalitetin e dëmshpërblimit, Gjykata mund të marrë parasysh pasojat e shumës së dëmshpërblimit në situatën ekonomike të kërkuesit (për mungesë të efekteve të dëmshme të dëmshpërblimit, shih *Delfi AS k. Estonisë* [DhM], § 161; për natyrën joproporcionale të një dëmshpërblimi monetar në kontekstin e situatës ekonomike të kërkuesit, shih *Kasabova k. Bullgarisë*, § 43).

246. Vlerësimi i proporcionalitetit të dëmshpërblimit mund të varet edhe nga natyra e sanksioneve të tjera dhe shpenzimeve ligjore që i ngarkohen personit që është gjetur përgjegjës për aktet e shpifjes nga gjykatat vendase (*Ileana Constantinescu k. Rumanisë*, § 49).

247. Së fundmi, edhe "efekti frenues" i një urdhri për të paguar dëmshpërblim është parametër në vlerësimin e proporcionalitetit të këtij mjeti si kompensim për komentet shpifëse. Lidhur me lirinë e shprehjes së gazetarëve, Gjykata përpiqet të garantojë që dëmshpërblimet që u ngarkohen kompanive të shtypit të mos jenë aq të larta sa që të kërcënojnë themelet ekonomike të tyre (*Blaja News Sp. z o. k. Polonisë*, § 71). Kështu, në çështjen *Timpul Info-Magazin dhe Anghel k. Moldavisë*, Gjykata vërejtë se dëmshpërblimi që iu ngarkua kompanisë çoi në mbylljen e saj (§ 39).

248. Njëkohësisht, lidhur me dëmshpërblimet "një frangë si kompensim simbolik", Gjykata gjeti rastin që të theksonte efektin frenues të sanksionit të drejtë e lirisë së shprehjes, edhe kur sanksioni është relativisht i lehtë (*Brasilier k. Francës*, § 43; *Paturel k. Francës*, § 49; *Desjardin k. Francës*, § 51).

- **E drejta e replikës, heqjes ose korigjimit, urdhri i gjykatës për të kërkuar falje dhe për të botuar përgënjeshtim**

249. Në çështjen *Melnychuk k. Ukrainës* (vend.), e cila kishte të bënte me refuzimin nga një gazete për të botuar përgjigjen e kërkuarit ndaj kritikës së një prej librave të tij, Gjykata vuri në dukje se Shteti kishte detyrimin pozitiv për të mbrojtur të drejtën e kërkuarit për lirinë e shprehjes në dy mënyra: duke siguruar që ai të kishte mundësi të arsyeshme për të ushtruar të drejtën e replikës duke dërguar një përgjigje në gazetë për botim; dhe duke siguruar që ai të kishte mundësinë për të kundërshtuar refuzimin e gazetës para gjykatave vendase. Gjykata vlerësoi se e drejta e replikës, si element i rëndësishëm i lirisë së shprehjes, rrjedh nga nevoja jo vetëm për të qenë në gjendje të kontestosh informacionin e pavërtetë, por edhe për të siguruar pluralizëm opinionesh, veçanërisht në çështje me interes të përgjithshëm siç janë debatet letrare dhe politike (§ 2).

250. Për pasojë, e drejta e replikës i nënshtrohet njësoj kufizimeve dhe kufijve të nenit 10 § 2 të Konventës.

251. Po kështu, Gjykata është shprehur se publikimi i një përgënjeshtrimi, kërkesë për falje apo madje edhe vendimi gjyqësor në një çështje shpifjeje, është përjashtim ndaj diskrecionit editorial që gëzojnë gazetat dhe mediat e tjera për të vendosur nëse të publikojnë artikuj dhe komente të paraqitura nga individë privatë (*Eker k. Turqisë*, § 45; *Melnychuk k. Ukrainës* (vend.)).

252. Në vendimin e Komisionit në çështjen *Ediciones Tiempo k. Spanjës*, ankesa e kompanisë kërkuese kishte të bënte me një urdhër gjykatë për të botuar një përgjigje ndaj një artikulli botuar më herët në një gazetë javore në pronësi të saj. Kompania u ankua se ishte urdhëruar të botonte deklarata të cilat e dinte se ishin të rreme. Komisioni i mëparshëm e hodhi poshtë ankesën, duke theksuar se një gazetë nuk mund të refuzonte të drejtën e replikës me arsyen e vetme se informacioni pretendohet se ishte i rremë. Sipas këndvështrimit të Komisionit, neni 10 i Konventës nuk mund të interpretohet si garantim i të drejtës së kompanive botuese për të botuar vetëm informacione që ato gjykojnë se pasqyrojnë të vërtetën, si dhe aq më pak u jep të drejtën kompanive të tilla të vendosin çfarë është e vërtetë përpara se të përmbushin detyrimin për të publikuar replikat që kanë të drejtë të bëjnë individët privatë. Qëllimi i akteve normative që rregullojnë të drejtën e replikës është të mbrojnë interesin publik për të marrë informacion nga një larmi burimesh dhe në këtë mënyrë të garantojë akses sa më të plotë të informacionit. Komisioni gjithashtu vuri në dukje se kompania botuese nuk ishte detyruar të ndryshonte përmbajtjen e artikullit dhe se pati mundësinë të paraqesë sërish versionin e vet të fakteve kur publikoi replikën e personit që ishte kritikuar (*Ediciones Tiempo k. Spanjës*, § 2).

253. Nisur nga fakti që replika duhet të shpërndahet menjëherë në mënyrë që të jetë efektive, Komisioni gjykoi se vërtetësia e fakteve të pretenduara në replikë nuk mund të verifikohet hollësisht në momentin e publikimit.

- **Masat që urdhërojnë heqjen, korrigjimin apo kërkesën për falje**

254. Në aktgjykimin e *Karsai k. Hungarisë* lidhur me urdhrin që gjykata i vendosi një historiani për të tërhequr publikisht deklaratat e tij, Gjykata çmoi se urdhri cenonte besueshmërinë profesionale të tij si historian dhe rrjedhimisht mbartte potencialin e shkaktit të efektit frenues (§ 36).

255. Në çështjen *Smolorz k. Polonisë*, në vlerësimin e proporcionalitetit të një urdhri që detyronte gazetarin të publikonte falje publike pas disa deklaratave shpifëse, Gjykata theksoi se edhe pse sanksioni ndaj z. Smolorz ishte i lehtë, e rëndësishme ishte se iu kërkua që të kërkonte ndjesë publike për komentet e tij (§ 42).

- **Publikime të tjera**

256. Gjykata, gjatë analizimit të një vendimi gjyqësor që urdhëronte kërkuesit të publikonte një vendim gjyqësor në një gazetë kombëtare me shpenzimet e veta, theksoi efektin frenues të sanksionit, nisur nga rëndësia e debatit ku kërkuesi kishte të drejtën legjitime të merrte pjesë (*Giniewski k. Francës*, § 55).

257. Në një tjetër çështje ku shoqata kërkuese u urdhërua të hiqte artikujt fyes nga faqja e vet e internetit, të publikonte konstatimet kryesore të vendimit të gjykatës së kantonit dhe të paguante shpenzimet e procesit gjyqësor, Gjykata çmoi se ky ishte në një masë të madhe një kompensim simbolik dhe nuk mund të konsiderohet i tepërt apo joproporcional (*Cicad k. Zvicrës*, § 62).

- **Vendimet paraprake dhe përfundimtare**

258. Gjykata është shprehur se, në përgjithësi, neni 10 nuk ndalon kufizimet paraprake të publikimeve si të tilla. Sidoqoftë, në këndvështrimin e Gjykatës, kufizimet paraprake mbartin rreziqe dhe kërkojnë analizë të kujdesshme nga ana e Gjykatës, sidomos kur bëhet fjalë për shtypin, sepse lajmet janë një mall që zhduket dhe vonesa e publikimit qoftë edhe për një periudhë të shkurtër mund t'ia bjerrë të gjithë vlerën dhe interesin (*Observer dhe Guardian k. Mbretërisë së Bashkuar*, § 60; shih edhe *Cumpănă dhe Mazăre k. Rumanisë* [DhM], § 118). Prandaj, kufizime të tilla duhet të jenë pjesë e një kuadri ligjor që garanton kontroll të fortë mbi objektin e ndalimit dhe shqyrtim gjyqësor efektiv për të parandaluar çfarëdo abuzimi (*Ahmet Yıldırım k. Turqisë*, § 64, me referenca të mëtejshme).

259. Në çështjen *Cumhuriyet Vakfı dhe Të tjerë k. Turqisë*, Gjykata konfirmon të njëjtat parime dhe thekson se duhet të kryejë edhe shqyrtim të hollësishëm të garancive procedurale që parashikon sistemi për të parandaluar cenimin arbitrar të lirisë së shprehjes, si edhe shqyrtoi objektin dhe kohëzgjatjen e vendimit të ndërmjetëm, arsyetimin e tij dhe mundësinë për ta kontestuar masën para se të miratohet (§§ 61-74).

260. Gjykata çmoi se ndalimi 180-ditor i transmetimeve të një radiostacioni për komenteve që bëri një i ftuar ishte joproporcionale me qëllimet e ndjekura (*Nur Radyo Ve Televizyon Yayıncılığı A.Ş. k. Turqisë*, § 31).

261. Në një tjetër çështje, Gjykata çmoi se një vendim civil që ndalonte transmetimin e filmave të caktuar, që ishte objekt rishikimi në rastin e ndryshimit të rrethanave përkatëse, pasqyronte baraspeshë të drejtë të gjetur nga gjykatat gjermane ndërmjet të drejtës së shoqatës kërkuese për lirinë e shprehjes dhe interesave të kompanisë në fjalë në mbrojtjen e reputacionit të vet (*Tierbefreier e.V. k. Gjermanisë*, § 58).

262. Në një çështje lidhur me ndalimin e përgjithshëm dhe absolut të publikimit si një mjet për të mbrojtur reputacionin e të tjerëve si dhe për të ruajtur autoritetin e gjyqësorit, Gjykata vlerësoi se arsyetimi i gjykatave vendase ishte i pamjaftueshëm, duke vënë në pah se ndalimi gjente zbatim në procese penale të filluara mbi bazën e një kërkesë të një pale civile dhe jo në procese që ngriheshin nga prokuroria apo që nuk shoqëroheshin me kërkesën e një pale civile. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, një ndryshim i tillë në trajtimin e së drejtës për informim nuk dukej se bazohej në ndonjë shkak objektiv, por e pengoi plotësisht të drejtën e shtypit për të informuar publikun për çështje që mund të kishte interes publik, edhe pse kishin të bënin me procese penale ku ishte bërë kërkesë nga një palë civile, si në këtë rast *Du Roy dhe Malaurie k. Francës*, §§ 35-36).

V. Roli i "rojtarit publik": rritja e mbrojtjes, detyrimet dhe përgjegjësitë

A. Roli i rojtarit

263. Gjykata gjithmonë e ka theksuar rolin thelbësor që luan shtypi si "rojtari" në një shoqëri demokratike, si edhe e ka lidhur detyrën e shtypit për dhënie informacioni dhe idesh mbi çështje të interesit publik me të drejtën e publikut për t'i marrë ato (*Satakunnan Markkinapörssi Oy dhe Satamedia Oy k. Finlandës* [DhM], § 126; *Bédat k. Zvicrës* [DhM], § 51; *Axel Springer AG k. Gjermanisë* [DhM], § 79; *The Sunday Times k. Mbretërisë së Bashkuar (nr. 2)*, § 50; *Bladet Tromsø dhe Stensaas k. Norvegjisë* [DhM], §§ 59 dhe 62; *Pedersen dhe Baadsgaard k. Danimarkës* [DhM], § 71; *News Verlags GmbH & Co.KG k. Austrisë*, § 56; *Dupuis dhe Të tjerë k. Francës*, § 35; *Campos Dâmaso k. Portugalisë*, § 31).

264. Kur liria e "shtypit" është në rrezik, autoritetet e kanë të kufizuar hapësirën e vlerësimit për të vendosur nëse ekziston "nevojë e ngutshme shoqërore" (*Stoll k. Zvicrës* [DhM], § 102).

265. Edhe pse shtypi është në zemër të konceptit "rojtari publik", Gjykata pranon edhe se OJF-të luajnë rol të njëjtë (*Animal Defenders International k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], § 103; *Medžlis Islamske Zajednice Brčko dhe Të tjerë k. Bosnjë-Hercegovinës* [DhM], § 86; *Cangi k. Turqisë*, § 35).

266. Nivel të lartë mbrojtjeje gëzojnë njësoj edhe studiuesit akademikë dhe autorët e literaturës mbi çështje me shqetësime publike. Gjykata ka nënvizuar se nisur nga roli i rëndësishëm i internetit në rritjen e aksesit të publikut në lajme dhe lehtësimin e qarkullimit të informacionit, funksioni i blogerëve dhe përdoruesve popullorë të medias sociale mund të asimilohet edhe si funksion "rojtari publik" për aq sa i takon mbrojtjes që jep neni 10 (*Magyar Helsinki Bizottság k. Hungarisë* [DhM], § 168).

267. Në veçanti, Gjykata vlerëson se roli i rojtarit publik që luajnë OJF-të është "me rëndësi të ngjashme me atë të shtypit" (*Animal Defenders International k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], § 103; *Steel dhe Morris k. Mbretërisë së Bashkuar*, § 89; *Magyar Helsinki Bizottság k. Hungarisë* [DhM], § 166. Në këndvështrimin e Gjykatës, krahasuar me shtypin, një OJF që luan rolin e rojtarit publik ka gjasa të ketë ndikim më të madh kur denoncon parregullsitë e zyrtarëve publikë dhe shpesh përdor më shumë mjete verifikimi dhe vërtetimi të vërtetësisë së kritikave, sesa në një rastin kur një individ denoncon se çfarë ka vërejtur personalisht (*Medžlis Islamske Zajednice Brčko dhe Të tjerë k. Bosnjë-Hercegovinës* [DhM], § 87).

268. Referuar edhe Parimeve Themelore për Statusin e Organizatave Joqeveritare në Evropë (*Medžlis Islamske Zajednice Brčko dhe Të tjerë k. Bosnjë-Hercegovinës* [DhM], §§ 45 dhe 87), Gjykata çmoi se konsideratat që vlejné për "detyrimet dhe përgjegjësitë" të qenësishme në lirinë e shprehjes së gazetarëve¹⁰ duhet të zbatohen njësoj edhe për një OJF që merr përsipër funksionin e rojtarit shoqëror (*Magyar Helsinki Bizottság k. Hungarisë* [DhM], §§ 159 dhe 166).

B. Të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë lidhur me funksionin e gazetarit

269. Mbrojtja e shtuar që u akordohet "rojtareve publikë" dhe sidomos shtypit nga neni 10 është objekt i kushtit që të respektojnë detyrimet dhe përgjegjësitë lidhur me funksionin e gazetarit si edhe detyrimin rrjedhues të "gazetarisë së përgjegjshme".

270. Më poshtë shtjellohen aspektet më të rëndësishme të kësaj mbrojtjeje si dhe të detyrimeve dhe përgjegjësisive që disiplinojnë në kuadrin e nenit 10 § 2 të Konventës.

¹⁰ Shih pjesën "Të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë lidhur me funksionin e gazetarit" më poshtë.

1. Mbledhja e informacionit

a. Hapat e kërkimit dhe hetimit

271. Gjykata e ka çmuar se mbledhja e informacionit është hap përgatitur thelbësor në gazetari si edhe një pjesë e qenësishme dhe e mbrojtur e lirisë së shtypit (*Satakunnan Markkinapörssi Oy dhe Satamedia Oy k. Finlandës* [DhM], § 128; *Magyar Helsinki Bizottság k. Hungarisë* [DhM], § 130; *Guseva k. Bullgarisë*, § 37; *Shapovalov k. Ukrainës*, § 68).

272. Gjykata çmon se në mbikëqyrjen e saj janë jo vetëm kufizimet në lirinë e shtypit lidhur me hapin përgatitur para publikimit, por edhe aktivitetet e kërkimit dhe hetimit të gazetarit që imponojnë shqyrtim të ngushtë të Gjykatës sepse kufizimet ndaj këtyre dy hapave paraqesin rrezik të lartë (*Dammann k. Zvicrës*, § 52; *The Sunday Times k. Mbretërisë së Bashkuar (nr. 2)*, § 51).

273. Gjykata vlerëson se pengesat që krijohen për të penguar aksesin në informacion me interes publik mund të dekurajojnë punën e medias apo sektorëve të tjerë që të ndjekin çështje të tilla (*Magyar Helsinki Bizottság k. Hungarisë* [DhM], § 167; *Társaság a Szabadságjogokért k. Hungarisë*, § 38; *Shapovalov k. Ukrainës*, § 68).

274. Në një tjetër çështje, kërkuesi (gazetar), po kryente një hetim mbi dënimet e mëparshme të personave privatë. Ai u dënua për një veprë penale për nxitje të një personi tjetër që të zbulonte sekrete zyrtare në mënyrë që të merrte informacion. Gjykata vendosi se dënimi i tij përbënte një lloj censure që kishte të ngjarë ta dekurajonte nga kryerja e hulumtimeve që janë të qenësishme për punën e tij, me synimin për të përgatitur një artikull të informuar për shtyp mbi një temë aktuale. Duke ndëshkuar një hap që ishte ndërmarrë para publikimit, ky dënim në opinionin e Gjykatës kishte gjasa të frenonte gazetarët që të kontribuonin në debatin publik mbi çështje që prekin jetën e komunitetit (*Dammann k. Zvicrës*, § 57).

275. Po njësoj, në një çështje lidhur me transmetimin e një reportazhi mbi praktikën tregtarë të brokerave të sigurimit që ishin filmuar me kamera të fshehtë, Gjykata, gjatë vlerësimit të metodës së përdorur për marrjen e informacionit, vendosi se kërkuesit që ishin gazetarë nuk mund të akuzohen se vepruan me dashje në shkelje të etikës profesionale (*Haldimann dhe Të tjerët k. Zvicrës*, § 61). Gjykata vërejti edhe se gjykatat vendase dështuan në arritjen e një pozicioni unanim nëse kërkuesit kishin shpërfillur rregullat e gazetarisë gjatë mbledhjes së informacionit. Gjykata çmoi se kërkuesve duhet t'u jepej luksi i dyshimit (*po aty*, § 61).

b. Aksesit në vende specifike dhe prania aty për qëllime të mbledhjes së informacionit

276. Në një çështje ku gazetari nuk i ishte dhënë akses në Davos gjatë Forumit Ekonomik Botëror për shkak të një ndalimi të përgjithshëm të vendosur nga policia, Gjykata vuri në dukje, së pari, se kjo masë kolektive u ngrit në nivelin e "ndërrhyrjes" në ushtrimin e lirisë së shprehjes së kërkuesit. Duke arritur në atë konstatim, Gjykata vuri në dukje se kërkuesi dëshironte të udhëtonte në Davos për të shkruar një artikull mbi një temë specifike. Pastaj, theksoi se autoritetet nuk kishin bërë asnjë dallim midis individëve potencialisht të dhunshëm dhe demonstruesve paqësorë. Duke qenë se autoritetet kompetente nuk kishin të drejtë të evokonin klauzolën e policimit të përgjithshëm, moslejimi i kërkuesve në Davos nuk mund të konsiderohet "e parashikuar me ligj" për qëllime të nenit 10 § 2 të Konventës (*Gsell k. Zvicrës*, §§ 49 dhe 61).

277. Për lirinë e shprehjes në Parlament, Gjykata ritheksoi se fjalimi parlamentar gëzon një nivel të lartë të mbrojtjes. Parlamenti është një forum unik për debat në një shoqëri demokratike, që ka rëndësi themelore (*Karácsony dhe Të tjerët k. Hungarisë* [DhM], § 138). Në lidhje me largimin e gazetarëve nga galeria e shtypit gjatë punimeve të parlamentit, Gjykata çmoi se gazetarët në fjalë po ushtronin të drejtën për të përcjellë

informacion te publiku në lidhje me sjelljen e përfaqësuesve të zgjedhur dhe se si autoritetet po trajtonin trazirat që kishin shpërthyer gjatë debateve. Çdo përpjekje për të hequr gazetarët nga vendi i debateve duhej t'i nënshtrohej një kontrolli të rreptë (*Selmani dhe Të tjerë k. ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, § 75; referuar aktgjykimit në *Pentikäinen k. Finlandës* [DhM], §§ 89 dhe 107). Gjykata theksoi, së pari, se gazetarët nuk përbënin ndonjë kërcënim për sigurinë publike ose rendin në dhomë (§ 80) dhe, së dyti, se largimi i tyre solli efekte të menjëhershme negative që i penguan të merrnin informacion të dorës së parë dhe të drejtpërdrejtë bazuar në perceptimin personal të punimeve në dhomë, megjithëse këto ishin elementë të rëndësishëm në ushtrimin e funksioneve gazetareske të kërkuesve, nga të cilat publiku nuk duhej t'i ishte privuar (§ 84).

278. Në këndvështrimin e Gjykatës, në situata kur autoritetet kryejnë operacione për të ruajtur rendin publik, media luan një rol vendimtar në sigurimin e informacionit, për shembull, se si autoritetet trajtojnë demonstratat publike dhe vënë nën kontroll prishjen e rendit. Roli "rojtar" i medias merr një rëndësi të veçantë në kontekste të tilla pasi prania e medias është një garanci që autoritetet të japin llogari për sjelljen e tyre karshi demonstruesve dhe publikut të gjerë kur bëhet fjalë për policimin e tubimeve të mëdha, përfshirë metodat e përdorura për të kontrolluar ose shpërndajë protestuesit ose për të ruajtur rendin publik (*Pentikäinen k. Finlandës* [DhM], § 89).

279. Në një çështje në lidhje me një refuzim absolut për të lejuar filmimin e një interviste me një të burgosur brenda burgut, Gjykata vuri në dukje sidomos mungesën e ndonjë nevoje të ngutshme shoqërore për kufizimin në fjalë, dhe mungesën në vendimet e autoriteteve vendase të ndonjë baraspeshimi real të interesave në fjalë (*Schweizerische Radio- und Fernsehgesellschaft SRG k. Zvicrës*, §§ 22 dhe 65).

280. Në çështjen *Szurovecz k. Hungarisë*, kërkuesi (gazetar investigativ) kishte aplikuar pa sukses për leje që të vizitonte një qendër pritjeje për azilkërkuesit, me qëllim që të bënte intervista me banorët aty për një shkrim mbi kushtet e jetesës brenda qendrës. Gjykata vlerësoi se interesi publik për të raportuar nga vende të caktuara është veçanërisht i rëndësishëm kur ka të bëjë me trajtimin e grupeve të cenueshme nga autoritetet. Roli "rojtar" i medias merr rëndësi të veçantë në kontekste të tilla, pasi prania e tyre është një garanci që autoritetet të japin llogari. Meqenëse tema kishte të bënte me një çështje me interes publik, Shteti kishte pak hapësirë që të vendoste kufizime ndaj lirisë së shprehjes (§§ 61-62). Gjykata vendosi që ekzistenca e alternativave të tjera për mbledhjen e drejtpërdrejtë të lajmeve brenda qendrës së pritjes nuk e shteruan interesin e kërkuesit për të pasur diskutime ballë për ballë dhe për të marrë përshtypje të dorës së parë mbi kushtet e jetesës në të (§ 74).

c. Ligjshmëria e sjelljes së gazetarit

281. Koncepti i "gazetarisë së përgjegjshme", si një aktivitet profesional që gëzon mbrojtjen e nenit 10 të Konventës, nuk kufizohet në përmbajtjen e informacionit që mblidhet dhe/ose shpërndahet me mjete gazetarie. Ky koncept gjithashtu përfshin, ndër të tjera, ligjshmërinë e sjelljes së gazetarit, përfshirë bashkëveprimin e tij/saj publik me autoritetet gjatë ushtrimit të funksioneve gazetareske. Fakti që një gazetar shkel ligjin në këtë drejtim është konsideratë shumë e rëndësishme, edhe pse jo vendimtare kur vlerësohet nëse gazetari ka vepruar me përgjegjësi (*Pentikäinen k. Finlandës* [DhM], § 90).

282. Në këtë kontekst, Gjykata ka pranuar që gazetarët ndonjëherë mund të përballen me një konflikt midis detyrës së përgjithshme për të respektuar ligjin e zakonshëm penal – nga i cili gazetarët nuk çlirohen – dhe detyrës së tyre profesionale për të marrë dhe për të shpërndarë informacion, duke u mundësuar kështu mediave të luajnë rolin e tij thelbësor si rojtare publike. Në sfondin e këtij konflikti interesash, duhet të theksohet se koncepti i "gazetarisë së përgjegjshme" kërkon që sa herë që një gazetar – si dhe punëdhënësi i tij – duhet të bëjë një zgjedhje midis dy detyrave dhe nëse ai zgjedh në dëm të detyrimit që të respektojë ligjin e zakonshëm penal, ky gazetar i tillë duhet të jetë i vetëdijshëm se po merr përsipër rrezikun e sanksioneve ligjore dhe përgjegjësi penale duke mos iu bindur urdhrave të ligjshëm të policisë, ndër të tjera (*Pentikäinen k.*

Finlandës [DhM], § 110). Gjykata vazhdimisht ka përsëritur se gazetarët nuk mund të përjashtohen nga detyrimi që t'i binden ligjit të zakonshëm penal thjesht në bazë të mbrojtjes që u garanton neni 10 (*Stoll k. Zvicrës* [DhM], § 102).

283. Me fjalë të tjera, gazetari nuk mund të pretendojë imunitet ekskluziv ndaj përgjegjësisë penale për të vetmen arsye se, ndryshe nga individët e tjerë që ushtrojnë të drejtën e lirisë së shprehjes, shkelja penale në fjalë është kryer gjatë ushtrimit të funksioneve të veta gazetareske (*Pentikäinen k. Finlandës* [DhM], § 91 dhe referenca të mëtejshme).

284. Kështu, Gjykata çmoi se ndërhyrja në lirinë e shprehjes së gazetarëve pas sjelljes së paligjshme të tyre ishte proporcionale me qëllimet legjitime që ndiqen në rastet e mosbindjes ndaj urdhrave të policisë për shpërndarje sapo demonstrata bëhet e dhunshme (*Pentikäinen k. Finlandës* [DhM]); përgjimi i komunikimeve policore me anë të pajisjeve radio (*Brambilla dhe Të tjerë k. Italisë*); marrja e armës në avion për të konstatuar dështimin e sistemit të sigurisë (*Erdtmann k. Gjermanisë* (vend.)); posedimi i paligjshëm i armës së zjarrit për të ilustruar lehtësinë në sigurimin e armëve të tilla (*Salihu dhe Të tjerë k. Suedisë* (vend.)); publikimi i një shkresë diplomatike të klasifikuar ose konfidenciale (*Stoll k. Zvicrës* [DhM]); blerja dhe transportimi i paligjshëm i fishekzjarrëve të ndaluar (*Mikkelsen dhe Christensen k. Danimarkës* (vend.)); ose shantazhi dhe krimi i organizuar (*Man dhe Të tjerë k. Rumanisë* (vend.)).

285. Në çështjen *Satakunnan Markkinapörssi Oy dhe Satamedia Oy k. Finlandës* [DhM], megjithëse të dhënat nuk u morën me mjete të paligjshme, Gjykata vlerësoi se kompanitë kërkuese, profesionistët e medias, qartazi kishin një politikë për të anashkaluar kanalet normale për gazetarët që të merrnin të dhëna tatimore dhe, sipas rrethanave, kontrollin dhe balancat e vendosura nga autoritetet vendase për të rregulluar aksesin dhe shpërndarjen e këtij informacioni (§ 185). Gjykata vuri në dukje sidomos se si profesionistë të medias, kompanitë kërkuese duhet të kishin qenë të vetëdijshme për mundësinë që mbledhja masive e të dhënave në fjalë dhe shpërndarja e tyre në një shkallë të tillë nuk mund të konsiderohej si përpunim të dhënash vetëm për qëllime gazetareske (§ 151).

286. Në çështjen *Zarubin dhe Të tjerë k. Lituaniës* (vend.) që kishte të bënte me urdhrin e dëbimit dhe moslejimin e hyrjes në territor kombëtar të gazetarëve, Gjykata vuri në dukje se gjykatat vendase kishin konkluduar se prania e këtyre gazetarëve në Lituani përbënte kërcënim për sigurinë kombëtare për shkak të sjelljes së tyre agresive dhe provokuese në një eveniment politik të nivelit të lartë, dhe jo për shkak të përhapjes së ideve të tyre (§§ 53, 57).

2. Detyrimet dhe përgjegjësitë lidhur me vendimmarrjen editoriale

287. Detyrimet dhe përgjegjësitë që lidhen me vendimmarrjen mbulohen edhe nga koncepte si "etika" gazetareske apo "kodet profesionale", ose nga koncepti i "gazetarisë së përgjegjshme". Elementët e këtyre detyrimeve dhe përgjegjësisë ndërveprojnë me kritere të tjera që përdor Gjykata në vlerësimin e vet dhe trajtohen në kapitujt e tjerë të këtij Udhëzimi. Megjithatë, është e përshtatshme të përmbledhim pikat kryesore këtu.

288. Lidhur me lirinë gazetareske, Gjykata gjithmonë ka vlerësuar objektin e këtyre "detyrimeve dhe përgjegjësisë" në dritën e rolit udhëheqës që luan shtypi në një Shtet që disiplinohet nga parimi i shtetit të së drejtës (*Thorgeir Thorgeirson k. Islandës*, § 63).

289. Pavarësisht rolit thelbësor që shtypi luan në një shoqëri demokratike, paragrafi 2 i nenit 10 nuk garanton liri shprehje krejtësisht të pakufizuar, edhe kur bëhet fjalë për mbulimin nga shtypi të çështjeve që përbëjnë shqetësim serioz për publikun (*Bladet Tromsø dhe Stensaas k. Norvegjisë* [DhM], § 65; *Monnat k. Zvicrës*, § 66).

290. Gjykata çmon se garancia që jep neni 10 për gazetarët lidhur me raportimin e çështjeve me interes të përgjithshëm është objekt i kushtit që ata të veprojnë më mirëbesim dhe mbi një bazë faktike të saktë si dhe të japin informacion "të besueshëm dhe preciz" në përputhje me etikën e gazetarisë (*Axel Springer AG k. Gjermanisë* [DhM], § 93; *Bladet Tromsø dhe Stensaas k. Norvegjisë* [DhM], § 65; *Pedersen dhe Baadsgaard k. Danimarkës* [DhM], § 78; *Fressoz dhe Roire k. Francës* [DhM], § 54; *Stoll k. Zvicrës* [DhM], § 103; *Kasabova k. Bullgarisë*, §§ 61 dhe 63-68; si shembull se Gjykata aplikon të njëjtin parim edhe për të tjerët që angazhohen në debat publik, shih *Steel dhe Morris k. Mbretërisë së Bashkuar*, § 90).

291. Këto kushte përshkruhet se veprojnë "në përputhje me bazat e gazetarisë së përgjegjshme" (*Bédat k. Zvicrës* [DhM], § 50; *Pentikäinen k. Finlandës* [DhM], § 90).

292. Në këto konsiderata luajnë rol veçanërisht të rëndësishëm në ditët e sotme, duke pasur parasysh ndikimin e medias në shoqërinë bashkëkohore: jo vetëm që informon, por edhe mund të sugjerojë si të vlerësohet informacioni nga mënyra si paraqitet. Në një botë ku individit ballafaqohet me sasi të mëdha informacioni që qarkullon përmes mediave tradicionale dhe elektronike dhe me aktorë mediatikë gjithnjë në rritje, monitorimi i respektimit të etikës gazetareske merr rëndësi të shtuar (*Stoll k. Zvicrës* [DhM], § 104).

a. Informacioni i besueshëm dhe preciz: përgjegjësitë lidhur me verifikimin dhe transmetimin

293. Në përgjithësi, Gjykata çmon se gazetarët duhet të jenë të lirë të raportojnë ngjarjet bazuar në informacionin e mbledhur nga burime zyrtare pa qenë nevoja t'i verifikojnë (*Selistö k. Finlandës*, § 60; *Axel Springer AG k. Gjermanisë* [DhM], § 105; *Yordanova dhe Toshev k. Bullgarisë*, § 51).

294. Në një çështje ku kërkuesi bazohej në materialet publike nga një hetim i aktiviteteve të pjesëtarëve të caktuar të njësisë antidrogë dhe një certifikatë mjekësore zyrtare që tregonte numrin e vdekjeve nga mbidoza, Gjykata konkludoi se publikimi i kërkuesit ishte një koment i drejtë për një shqetësim publik, sesa një sulm i paramenduar ndaj reputacionit të efektivëve policorë në fjalë (*Godlevskiy k. Rusisë*, § 47).

295. Në një çështje në lidhje me përmbledhjen nga një gazetar (kërkuesi) situatës financiare të një deputeti të dëbuar në dritën e deklarimit të pasurisë së tij, Gjykata arriti në përfundimin se kërkuesi kishte të drejtë të bazohej në një dokument zyrtar pa qenë nevoja të bëjë kërkime të pavarura (*Gorelishvili k. Gjeorgjisë*, § 41).

296. Në një çështje tjetër, drejtori i botimit të një gazete ditore u gjet përgjegjës në një çështje civile për botimin e deklaratave të përshkruara si shpifëse ndaj një kreu shteti, sipas të cilave ky i fundit ishte implikuar në trafikun ndërkombëtar të drogës. Gjykata vuri në dukje, së pari, se gjykatat vendase nuk kishin mohuar që përmbajtja e informacionit të botuar ishte në thelb e vërtetë. Në lidhje me pretendimin se procesi civil nuk ishte i plotë, Gjykata vuri në dukje se artikulli i botuar i referohej informacionit në dispozicion të gazetares në kohën e përgatitjes së tekstit dhe gjykoj se shkrimtarja e artikullit nuk kishte si të dinte rezultatit e procesit penal dy muaj para dhënies së dënimit, as të kryente kërkime në polici dhe në dokumente gjyqësore që ishin të kufizuara (*Gutiérrez Suárez k. Spanjës*, § 37).

297. Gjykata ka theksuar se është e rëndësishme që gjykatat vendase të bëjnë dallimin midis llojeve të burimeve në të cilat bazohen pretendimet e kundërshtuara. Në lidhje me dyshimet se individit i përkiste mafies, gjykatat vendase vendosën që kompania kërkuesi e kishte tepruar me nivelin e dyshimit që përcillnin raportet e brendshme zyrtare dhe nuk kishte qenë në gjendje vërtetonte këto dyshime të mëdha me anë të fakteve shtesë. Sipas dallimit të gjykatës vendase, edhe pse gazetarët mund të mbështeten në raportet zyrtare publike ose njoftimet zyrtare për shtyp pa hulumtime të mëtejshme, situata nuk ishte e njëjtë për raportet e brendshme zyrtare. Në këndvështrimin e Gjykatës, ky dallim ishte veçanërisht i vërtetë për raportet në lidhje me akuzat

për sjellje kriminale ku bëhej fjalë për të drejtën e prezumimit të pafajësisë (*Verlagsgruppe Droemer Knaur GmbH & Co. KG k. Gjermanisë*, § 48).

298. Në një çështje që përfshin riprodhimin fjalë për fjalë të një materiali nga një portal lajmesh, duke treguar burimin, Gjykata pranoi se ekzistojnë dallime midis shtypit të shkruar dhe internetit dhe që, duke pasur parasysh rolin që luan interneti në kontekstin e aktiviteteve të medias profesionale dhe rëndësinë e tij për ushtrimin e të drejtës së lirisë së shprehjes në përgjithësi, mungesa e një kuadri ligjor të mjaftueshëm kombëtar që lejon gazetarët të përdorin informacionin nga interneti pa pasur frikë nga penalitetet pengon seriozisht ushtrimin e funksionit jetik të shtypit si "rojtar publik" (*Redaksia e Pravoye Delo dhe Shtekel k.Ukrainës*, § 64).

299. Në çështjen *Kaçki k. Polonisë*, Gjykata deklaroi se "gazetaria e përgjegjshme" nënkupton që gazetarët të kontrollojnë në masë të arsyeshme informacionin që i japin publikut. Kështu, nuk mund të pritët që gjithmonë të kontrollojnë informacionin që japin në një intervistë. Gjykata theksoi dallimin midis riprodhimit në shtypin e shkruar të një interviste në të cilën gazetari kishte transkriptuar deklaratat e personit që intervistohet dhe jo deklarimet e vetë gazetarit, si dhe faktin që ai kishte treguar mirëbesimin sepse para publikimit kishte lejuar individin në fjalë që të verifikonte që deklaratat e saj ishin cituar me saktësi në artikull (§ 52).

300. Gjykata gjithmonë ka njohur lirinë e gazetarëve në zgjedhjen e teknikave ose metodave për të raportuar thëniet e një pale të tretë që mund të arrijnë nivelin e shpifjes. Ajo ka pranuar se metodat e raportimit objektiv dhe të balancuar mund të ndryshojnë shumë, edhe në varësi të medias në fjalë (*Jersild k. Danimarkës*, § 31).

301. Gjykata vlerëson se kriteri i përgjithshëm për gazetarët që të distancohen sistematikisht dhe formalisht nga përmbajtja e një citimi që mund të fyejë apo të provokojë të tjerët ose të dëmtojë reputacionin, nuk është në pajtim me rolin e shtypit për të dhënë informacione mbi ngjarjet aktuale, opinione dhe ide (*Thoma k. Luksemburgut*, § 64; *Brunet-Lecomte dhe Lyon Mag' k. Francës*, § 47).

302. Në një çështje ku një gazetar u procedua penalisht dhe u dënua për realizimin e një dokumentari televiziv për të rinjtë që konfirmonin racizmin e tyre, Gjykata arriti në përfundimin se kërkuesi nuk kishte për qëllim të përhapte mendime raciste, por të nxirrte në pah një çështje me interes publik: raportimi i lajmeve bazuar në intervista përbënte një nga mjetet më të rëndësishme me të cilat shtypi është në gjendje të luajë rolin jetik të "rojtarit publik" (*Jersild k. Danimarkës*, § 35).

303. Liria e shtypit mbulon edhe njëfarë mase teprimi (ekzagjerimi), apo edhe provokimi (*Pedersen dhe Baadsgaard k. Danimarkës*, § 71). Nuk i takon as Gjykatës dhe as gjykatave vendase që të zëvendësojnë pikëpamjet e tyre me ato të shtypit se cilat teknika raportimi duhet të përdorin gazetarët në një rast të caktuar (*Jersild k. Danimarkës*, § 31; *Eerikäinen dhe Të tjerë k. Finlandës*, § 65). Gazetarët gëzojnë lirinë të zgjedhin, nga moria e lajmeve që vijnë në vëmendjen e tyre, se cilat lajme të trajtojnë dhe si (*Couderc dhe Hachette Filipacchi Associés k. Francës* [DhM], §§ 31 dhe 139).

304. Thënë kjo, Gjykata i kushtoi rëndësi të konsiderueshme faktit që kërkuesi, drejtor i një gazete ditore, botoi, së bashku me editorialin e kundërshtuar në të cilin kritikonte pikëpamjet politike të një kandidati zgjedhor, ekstrakte të shumta nga artikujt e fundit të shtypit. Gjykata vendosi që kjo praktikë pune e gazetarit ishte në përputhje me rregullat që disiplinojnë profesionin e gazetarit. Ajo shpjegoi se, në reagimin ndaj atyre artikujve, drejtori i kishte lejuar lexuesit të formonin mendimin e tyre duke vendosur editorialin në fjalë krahas deklaratave të bëra nga personi i referuar në atë editorial (*Lopes Gomes da Silva k. Portugalisë*, § 35).

305. Në këtë kontekst, Gjykata çmon se paanshmëria e mjeteve që përdoren për marrjen dhe riprodhimin e informacionit për publikun dhe respekti që tregohet për personin që është objekt i lajmit janë kritere thelbësore që duhen marrë parasysh. Natyra zvogëluese dhe e cunguar e një shkrimi që ka gjasa të keqorientojë lexuesin,

i heq ndjeshëm kontributit të artikullit në fjalë për debatin me interes publik (*Couderc dhe Hachette Filipacchi Associés k. Francës* [DhM], § 132; *Travaglio k. Italisë* (vend.), § 34).

306. Gjykata ka theksuar në disa raste se duhet bërë dallimi edhe nëse deklaratat janë opinione të gazetarit apo citime të tjerëve (*Godlevskiy k. Ruisë*, § 45; *Pedersen dhe Baadsgaard k. Danimarkës* [DhM], § 77; *Thorgeir Thorgeirson k. Islandës*, § 65; *Jersild k. Danimarkës*, § 35).

307. Në një çështje lidhur me deklaratat e kërkuesit, një gazetar, në një program televiziv drejtpërdrejt pa qenë në dijeni të pamjeve që redaktori kishte zgjedhur të përdorte si hyrje të debatit, Gjykata vendosi që përgjegjësia e gazetarit nuk mund të shkonte përtej fjalëve të tij dhe ai nuk mund të mbahej përgjegjës për deklaratat ose pretendimet e bëra nga të tjerët - qofshin redaktorë televizivë apo gazetarë (*Reznik k. Ruisë*, § 45).

308. Në një çështje ku gjykatat vendase i kishin mbështetur gjetjet e tyre vetëm në pjesën e artikullit të kontestuar që përmbante akuza për ryshfet, Gjykata vuri në dukje se pjesa e kontestuar ishte nxjerrë nga konteksti. Edhe pse akuzat ishin të rënda, artikulli i lexuar në tërësinë e vet paralajmëronte qartë lexuesin se zërat në fjalë nuk ishin të besueshme. Gjykata përsëriti në këtë aktgjykim se raportimi i medias mbi "histori" ose "zëra" që burojnë nga persona të tjerë ose "opinion publik" duhet të mbrohet edhe kur ato nuk janë plotësisht pa baza (*Timpul Info-Magazin dhe Anghel k. Moldavisë*, § 36).

b. Përgjegjësi të tjera: redaktorët dhe drejtorët botues të gazetarëve, lexuesit, kontribuuesit

309. Gjykata ka vendosur se botuesit jo vetëm që marrin pjesë plotësisht në ushtrimin e lirisë së shprehjes të autorëve të botuar prej tyre, por gjithashtu ndajnë me ta "detyrimet dhe përgjegjësitë" e këtyre të fundit, për shkak se ndihmojnë autoritetet me një medium për shprehjen e ideve të tyre. Me kushtin që të respektohen kërkesat e paragrafit 2, neni nuk i përjashton botuesit nga penalizimi për botimin e një teksti autori i të cilit i ka shpërfillur këto "detyrime dhe përgjegjësi", madje edhe kur botuesi nuk ndan personalisht opinionet e shprehura të autorit (*Orban dhe Të tjerë k. Francës*, § 47, me referenca të mëtejshme).

310. Një çështje tjetër kishte të bënte me një dënim të trefishtë për shpifje në lidhje me një parti të ekstremit të djathtë dhe kryetarin e saj: autori dhe botuesi i një romani dhe drejtori botues i një gazete, pas shtypjes së një peticioni duke cituar pasazhet fyese dhe duke protestuar kundër dy dënimeve të para. Gjykata vendosi që, përveç dy dënimeve të para, ajo e drejtorit botues të gazetës ishte në përputhje me nenin 10, duke pasur parasysh se nuk dukej e paarsyeshme të konsiderohej se i kishte tejkalar kufijtë e "provokimit" të lejueshëm duke riprodhuar pasazhe shpifëse (*Lindon, Otchakovsky-Laurens dhe July k. Francës* [DhM], § 66).

311. Në një tjetër çështje për dënimin me burg (por në periudhë prove) të një drejtori gazete për publikimin e një artikulli shpifës për dy gjyqtarë, Gjykata theksoi se si drejtor gazete, kërkuesi kishte fuqinë dhe detyrimin që të garantonte se debati politik të mos degjeneronte në fyerje apo sulme personale (*Belpietro k. Italisë*, § 41).

312. Megjithatë, "për shkak të natyrës së veçantë të Internetit, 'detyrimet dhe përgjegjësitë' që i ngarkohen portalit të internetit për qëllimet e nenit 10 mund të dallojnë në njëfarë mase nga ato të botuesit tradicional, për sa i përket përmbajtjes së palëve të treta" (*Delfi AS k. Estonisë* [DhM], § 113; shih edhe *Orlovskaya Iskra k. Ruisë*, § 109), fakti i ofrimit të një forumi për ushtrimin e lirisë së shprehjes duke i mundësuar publikut që të japë informacion dhe ideve në internet duhet të vlerësohet në dritën e parimeve të zbatueshme për shtypin (*Magyar Tartalomsgazdálkodók Egyesülete dhe Index.hu Zrt k. Hungarisë*, § 61)¹¹.

¹¹ Për përgjegjësitë e ndërmjetësve në internet, shih Kapitullin "Liria e Shprehjes dhe Interneti" më poshtë.

VI. Mbrojtja e burimeve gazetareske

A. Parime të përgjithshme

313. Mbrojtja e burimeve gazetareske është një nga gurët e themelit të lirisë së shprehjes. Pa një mbrojtje të tillë, burimet mund të frenohen dhe të mos ndihmojnë shtypin në informimin e publikut për çështjet me interes publik. Si rezultat, mund të minohet roli jetik i shtypit si "rojtat publik" dhe të cenohet aftësia e shtypit për të dhënë informacion të saktë dhe të besueshëm (*Ressiot dhe Të tjerë k. Francës*, § 99; *Goodwin k. Mbretërisë së Bashkuar*, § 39; *Roemen dhe Schmit k. Luksemburgut* § 57; *Ernst dhe Të tjerë k. Belgjikës*, § 91; *Tillack k. Belgjikës*, § 53).

314. Dy qëllimet legjitime që evokohen shpesh për të justifikuar ndërhyrjen në mbrojtjen e burimeve janë "siguria kombëtare" dhe "për të parandaluar zbulimin e informacionit të marrë në besim". "Parandalimi i prishjes së rendit", "parandalimi i krimit" dhe "mbrojtja e të drejtave të të tjerëve" janë evokuar gjithashtu në disa çështje të kësaj natyre.

315. Duke pasur parasysh rëndësinë e mbrojtjes së burimeve gazetareske për lirinë e shtypit në një shoqëri demokratike dhe efektin potencialisht frenues që ka një urdhër për zbulim burimi të ushtrimit në kësaj të drejte, ndërhyrja nuk mund të jetë në pajtim me nenin 10 të Konventës, përveç se kur ekziston një arsye më të rëndësishme në interes të publikut (*Goodwin k. Mbretërisë së Bashkuar*, § 39; *Weber dhe Saravia k. Gjermanisë (vend.)*, § 149; *Financial Times Ltd dhe Të tjerë k. the Mbretërisë së Bashkuar*, § 59; *Tillack k. Belgjikës*, § 53).

Po kështu, kufizimet në konfidencialitetin e burimeve gazetareske kërkojnë shqyrtimin më të kujdesshëm të mundshëm nga ana e Gjykatës (*Goodwin k. Mbretërisë së Bashkuar*, §§ 39-40).

316. Konfidencialiteti i burimeve gazetareske ka dy aspekte: përfshin jo vetëm vetë gazetarët, por sidomos edhe burimet që ndihmojnë shtypin të informojë publikun për çështje me interes publik (*Stichting Ostade Blade k. Vendeve të Ulëta* (vend.), § 64; *Nordisk Film & TV A/S k. Danimarkës* (vend.)).

317. Gjykata ka theksuar se e drejta e gazetarëve për të mos zbuluar burimet e tyre nuk mund të konsiderohet si privilegj i thjeshtë që jepet ose hiqet në varësi të ligjshmërisë ose paligjshmërisë së burimeve të tyre, por është pjesë e pandashme e së drejtës për informim që duhet trajtuar me kujdesin maksimal (*Nagla k. Letonisë*, § 60; *Tillack k. Belgjikës*, § 65).

B. Përkufizime, fusha e zbatimit

318. Në çështjet në lidhje me mbrojtjen e burimeve gazetareske, Gjykata shpesh i referohet Rekomandimit nr. R(2000)7 për të drejtën e gazetarëve për të mos zbuluar burimet e tyre të informacionit, i miratuar nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës më 8 mars 2000 (shih, midis autoriteteve të tjera, *Sanoma Uitgevers B.K. k. Vendeve të Ulëta* [DhM], § 44; *Telegraaf Media Nederland Landelijke Media B.K. dhe Të tjerë k. Vendeve të Ulëta*, § 86).

319. Kështu, kuptimi i Gjykatës për konceptin e "burimit" gazetaresk është "çdo person që i jep informacion gazetarit". Për më tepër, sipas Gjykatës, shprehja "informacioni që identifikon një burim" përfshin - për aq sa mund të çojë në zbulimin e burimit - jo vetëm "rrethanat faktike të marrjes së informacionit nga një burim prej gazetarit", por edhe "përmbajtjen e papublikuar të informacionit që burimi i jep gazetarit" (*Görmüş dhe Të tjerë k. Turqisë*, § 45; *Telegraaf Media Nederland Landelijke Media B.K. dhe Të tjerë k. Vendeve të Ulëta*, § 86).

320. Në një çështje lidhur me një urdhër që një kompani televizive t'i dorëzonte policinë pamje të pashfaqura që implikonin individë të dyshuar për pedofili, Gjykata vuri në dukje se pari se gazetari kishte punuar i

maskuar dhe se personat që flisnin me të nuk kishin dijeni se ai ishte gazetar. Meqenëse personat pjesëmarrës në program nuk kishin ndihmuar me vullnetin e tyre të lirë shtypin në informimin e publikut për çështje me interes publik, ata nuk mund të konsideroheshin si burime të informacionit gazetaresk në kuptimin tradicional. Përkundër këtij konstatimi, Gjykata vendosi që vendimi i kontestuar nga gjykatat vendase përbënte një ndërhyrje në kuptimin e nenit 10 § 1 të Konventës. Në vendimin e saj, Gjykata pranoi mundësinë që neni 10 i Konventës mund të jetë i zbatueshëm në një situatë të tillë dhe vuri në dukje se një dorëzim i detyrueshëm i materialit kërkimor mund të ketë efekt frenues në ushtrimin e lirisë gazetareske të shprehjes (*Nordisk Film & TV A/S k. Danimarkës* (vend.)).

321. Në një çështje lidhur me bastisjen e ambienteve të një reviste pas publikimit të një letre që merrte përgjegjësinë për një sulm me bombë, Gjykata vërejti se bastisja synonte të hetonte një krim të rëndë dhe të parandalonte sulme. Gjykata theksoi se informatori i revistës, i cili po kërkonte publicitet për sulmet, nuk gëzonte të njëjtën mbrojtje si ajo që u njihet "burimeve" (*Stichting Ostade Blade k. Vendeve të Ulëta* (vend.)).

C. Format dhe proporcionaliteti i ndërhyrjes

1. Urdhrat për zbulimin e burimeve

322. Gjykata ka vërejtur se urdhrat për zbulimin e burimeve kanë ndikim potencialisht dëmtues jo vetëm te burimi, identiteti i të cilit mund të zbulohet, por edhe te gazeta ose publikime të tjera të cilave u drejtohet urdhri, reputacioni i të cilave mund të reduktohet në sytë e burimeve potenciale në të ardhmen dhe në sytë e publikut që kanë interes në marrjen e informacionit përmes burimeve anonime (*Sanoma Uitgevers B.K. k. Vendeve të Ulëta* [DhM], § 89; *Financial Times Ltd dhe Të tjerë k. the Mbretërisë së Bashkuar*, § 70).

323. Në një çështje në të cilin një gazetar u ndalua me qëllim që të detyrohej të zbulonte burimin e tij të informacionit në një hetim penal për trafik armësh, Gjykata shfaqti habinë se sa shumë ishin angazhuar autoritetet vendase për të mësuar identiteti i burimit. Masa të tilla të skajshme vetëm sa dekurajojnë personat që kanë informacione të vërteta dhe të sakta për keqberjet që t'i bëjnë të ditura në të ardhmen dhe t'i ndajnë ato me shtypin (*Voskuil k. Vendeve të Ulëta*, § 71).

2. Kontrolllet

324. Gjykata ka vendosur në disa çështje se kontrolli që kryhet për të zbuluar burimin e gazetarit, edhe kur rezulton i pasuksesshëm, është masë më drastike sesa urdhri për të treguar identitetin e burimit. Arsyeja është se hetuesit që bastisin vendin e punës së gazetarit pa njoftim dhe të pajisur vendimin e kontrollit kanë kompetenca shumë të gjera hetuese sepse, për nga vetë përkufizimi, ata kanë akses në të gjithë dokumentacionin që posedon gazetari (*Roemen dhe Schmit k. Luksemburgut*, § 57; *Ernst dhe Të tjerë k. Belgjikës*, § 103; *Görmüş dhe Të tjerë k. Turqisë*, §§ 57-59).

325. Në çështjen *Görmüş dhe Të tjerë k. Turqisë*, masa e kontestuar kishte disa aspekte: kontrollin në ambientet e punës së kërkuesve, kopjimin e disqeve të jashtme të të gjithë kompjuterëve të gazetarëve duke marrë të dhënat, si edhe mbajtjen e këtyre disqeve nga prokuroria. Gjykata u shpreh se kjo kërcënon mbrojtjen e burimit shumë më tepër se një urdhër që detyron zbulimin e informatorëve. Autoritetet morën pa dallim të gjitha të dhënat që gjendeshin në softuerë, duke marrë informacion që nuk kishte lidhje me aktet në fjalë.

Në këndvështrimin e Gjykatës, kjo ndërhyrje jo vetëm që mund të kishte pasoja shumë negative të marrëdhëniet e kërkuesve me të gjithë burimet e tyre, por mund të kishte edhe efekt frenues të fortë te gazetarët e tjerë apo sinjalizuesit e punësuar nga Shteti, si dhe mund t'i dekurajonte që të denonconin çdo parregullsi apo veprime të diskutueshme të autoriteteve publike (*Görmüş dhe Të tjerë k. Turqisë*, §§ 73-74;

401. Nëse neni 8 nuk është i zbatueshëm, Gjykata kalon në analizën nëse ndërhyrja është proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur (*Magyar Helsinki Bizottság k. Hungarisë* [DhM], § 196). Gjykata shqyrton sidomos nëse gjykatat vendase kanë kryer vlerësim kuptimplotë nëse janë respektuar të drejtat e lirisë së shprehjes sipas nenit 10 të Konventës. Në këtë drejtim, ajo ka theksuar se çdo kufizim për një publikim të propozuar që synohet të kontribuojë në një debat për çështje me interes të përgjithshëm, duhet t'i nënshtrohet një shqyrtimi

Udhëzuesi për nenin 10 të Konventës - Liria e shprehjes

maksimal (po aty, § 199; shih edhe *Roșianu k. Rumanisë*, § 67, ku Gjykata konstatoi se Shteti nuk kishte paraqitur asnjë argument që tregon se ndërhyrja në të drejtën e kërkuarit ishte e parashikuar me ligji apo se kishte ndjekur një apo disa qëllime legjitime.

X. Mbrojtja e autoritetit dhe paanshmërisë së sistemit të drejtësisë dhe liria e shprehjes: e drejta e lirisë së shprehjes në kontekstin e proceseve gjyqësore dhe pjesëmarrja e gjyqtarëve në debatin publik

402. Në kategorinë e çështjeve të analizuara në këtë kapitull, e drejta e lirisë së shprehjes mund të bjerë ndesh jo vetëm me interesat legjitime, por edhe me të drejtat e garantuara nga Konventa. Me këtë kemi parasysh sidomos të drejtën për gjykim të drejtë dhe përfundimin e tij, prezumimin e pafajësisë, të cilat mbrohen nga neni 6 i Konventës, si dhe të drejtën për jetë private që mbrohet nga neni 8 i Konventës

403. Kështu, ky kapitull analizon çështjet që përfshijnë lirinë e shprehjes së anëtarëve të shërbimeve juridike kombëtare, avokatëve dhe të të pandehurve në kontekstin e proceseve gjyqësore, lidhur si me sjelljen në sallën e gjyqit, ashtu edhe deklaratat jashtë gjyqit, sidomos ato drejtuar shtypit.

Ky kapitull përshkruan edhe parimet lidhet me pasqyrimin mediatik të proceseve gjyqësore si edhe zbatimin e tyre.

Në fund, përshkruan jurisprudencën e Gjykatës për lirinë e shprehjes të gjyqësorit në një kontekst më të përgjithshëm të debatit publik, në mënyrë të pavarur nga proceset gjyqësore.

A. Statusi i posaçëm i aktorëve në sistemin e drejtësisë dhe liria e shprehjes së tyre në kontekstin e proceseve gjyqësore

1. Pjesëtarët e gjyqësorit¹⁴

404. Parimet e përgjithshme të zbatueshme për lirinë e shprehjes përmbledhen në paragrafët 162-167 të aktgjykimit në *Baka k. Hungarisë* [DhM].

405. Detyra e veçantë e gjyqësorit në shoqëri kërkon që gjyqtarët të respektojnë detyrimin e diskrecionit (*Morice k. Francës* [DhM], § 128). Megjithatë, ky detyrim ndjek një qëllim specifik: fjala e gjyqtarëve, ndryshe nga avokatët, merret si shprehje e vlerësimit objektiv që përkushton jo vetëm personin që shprehet, por përmes tij edhe tërë sistemin e drejtësisë (*po aty*, § 168).

406. Gjatë shqyrtimit të çështjeve mbi të drejtën e nëpunësve civilë për lirinë e shprehjes, Gjykata mban parasysh se "detyrimet dhe përgjegjësitë" e përcaktuara në nenin 10 § 2 marrin peshë të veçantë, prandaj u lejon njëfarë hapësire vlerësimi autoriteteve kombëtare që të konstatojnë nëse ndërhyrja e kontestuar është proporcionale me qëllimin më lart (*Baka k. Hungarisë* [DhM], § 162; *Vogt k. Gjermanisë*, § 53; *Guja k. Moldavisë* [DhM], § 70; *Albayrak k. Turqisë*, § 41).

407. Nisur nga fakti që gjyqësori mban një pozitë të spikatur ndër organet shtetërore në shoqëri demokratike, kjo përjasje zbatohet edhe në rastet kur kufizohet liria e shprehjes së një gjyqtari lidhur me performancën e punës së vet, pavarësisht se gjyqësori nuk është pjesë e shërbimit civil të zakonshëm (*Albayrak k. Turqisë*, § 42; *Pitkevich k. Ruisë* (vend.)).

408. Për sa u përket zyrtarëve publikë që shërbejnë në gjyqësor, Gjykata ka theksuar se nuk mund të pritët prej tyre që të tregojnë vetëpërmbytje në ushtrimin e lirisë së shprehjes në të gjitha rastet ku mund të vihet në diskutim autoriteti dhe paanshmëria e gjyqësorit (*Wille k. Lihtenshtejnit* [DhM], § 64; *Kayasu k. Turqisë*, § 92).

409. Në këndvështrimin e Gjykatës, statusi i prokurorëve publikë, që kanë fuqinë e deleguar direkt nga ligji për qëllime të parandalimit dhe ndjekjes penale dhe mbrojtjen e qytetarëve, u imponon detyrimin që të jenë

¹⁴ Kuptimi i termit "pjesëtar i gjyqësorit" këtu përfshin si gjyqtarët edhe prokurorët.

garantues të lirive individuale dhe shtetit të së drejtës, përmes kontributit të tyre në administrimin e duhur të drejtësisë dhe rrjedhimisht besimit publik te ata (*Kayasu k. Turqisë*, § 91).

410. Gjatë ushtrimit të funksionit të tyre gjykues, nga autoritetet gjyqësore pritet të ushtrojnë diskrecion maksimal në çështjet që shqyrtojnë, në mënyrë që të ruajnë figurën si gjyqtarë të paanshëm (*Olujić k. Kroacisë*, § 59), por edhe kur shprehin kritika ndaj zyrtarëve publikë dhe në veçanti ndaj gjyqtarëve të tjerë (*Di Giovanni k. Italisë*).

411. Gjykata ka theksuar se zyrtarët publikë duhet të tregojnë vigjilencë të shtuar gjatë ushtrimit të së drejtës për lirinë e shprehjes në kontekstin e hetimeve në proces, sidomos kur vetë këta zyrtarë janë të ngarkuar me kryerjen e hetimeve për informacione të klasifikuara për të garantuar administrimin e duhur të drejtësisë (*Poyraz k. Turqisë*, §§ 76-78).

412. Për deklaratat e autoriteteve lidhur me hetime penale në proces, Gjykata ka theksuar se neni 6 § 2 nuk mund të pengojë autoritetet që të informojnë publikun për hetime të tilla; megjithatë, Gjykata kërkon që ky informim të bëhet me të gjithë diskrecionin dhe maturinë e nevojshme me qëllim që të respektohet prezumimi i pafajësisë (*Fatullayev k. Azerbajxhanit*, §§ 159-162; *Garycki k. Polonisë*, § 69; *Lavents k. Letonisë*, §§ 126-127; *Slavov dhe Të tjerë k. Bullgarisë*, §§ 128-130).

413. Gjykata ka theksuar rëndësinë e zgjedhjes së fjalëve nga zyrtarët publikë në deklaratat e tyre, para se një person të gjykohet dhe të shpallet fajtor për një shkelje penale (*Daktaras k. Lituanisë*, § 41; shih edhe në kontekstin e intervistave për shtypin kombëtar, *Butkevičius k. Lituanisë*, § 50; *Gutsanovi k. Bullgarisë*, §§ 197 dhe 202-203).

414. Kur Gjykata thekson rëndësinë që ka ruajtja e autoritetit të gjyqësorit në një Shtet që sundohet nga shteti i së drejtës dhe në një shoqëri demokratike, thekson edhe se funksionimi i duhur i gjykatave do të ishte i pamundur pa marrëdhëniet bazuar në konsideratën dhe respektin e ndërsjellë mes protagonistëve në sistemin e drejtësisë, në ballë të të cilit qëndrojnë gjyqtarët dhe avokatët (*Morice k. Francës* [DhM], § 170).

2. Avokatët

415. Statusi specifik i avokatëve u jep atyre pozitë qendrore në administrimin e drejtësisë, si ndërmjetës mes publikut dhe gjykatave. Prandaj, avokatët luajnë rol kyç që gjykatat – misioni i të cilave është thelbësor në një shtet që sundohet nga shteti i së drejtës – të gëzojnë besimin e publikut (*Morice k. Francës* [DhM], §§ 132-139; *Schöpfer k. Zvicrës*, §§ 29-30; *Nikula k. Finlandës*, § 45; *Amihalachioaie k. Moldavisë*, § 27; *Kyprianou k. Qipros* [DhM], § 173; *André dhe Një tjetër k. Francës*, § 42; *Mor k. Francës*, § 42).

416. Që pjesëtarët e publikut të kenë besim te administrimi i drejtësisë, ata duhet të kenë besim te aftësia e avokatisë në ofrimin e përfaqësimit efektiv (*Morice k. Francës* [DhM], § 132; *Kyprianou k. Qipros* [DhM], § 175).

417. Ky rol i posaçëm i avokatëve si profesionistë të pavarur në administrimin e drejtësisë përfshin një sërë detyrimesh, sidomos lidhur me sjelljen e tyre (*Morice k. Francës* [DhM], § 133; *Van der Mussele k. Belgjikës*; *Casado Coca k. Spanjës*, § 46; *Steur k. Vendeve të Ulëta*, § 38; *Veraart k. Vendeve të Ulëta*, § 51; *Coutant k. Francës* (vend.)).

418. Teksa u nënshtrohen kufizimeve në sjelljen e tyre profesionale që duhet të jetë diskrete, e ndershme dhe e denjë, avokatët gëzojnë edhe të drejta dhe privilegje ekskluzive që mund të ndryshojnë nga një juridiksion në tjetrin, si p.sh. një marzh i caktuar në lidhje me argumentet e përdorura në gjykatë (*Morice k. Francës* [DhM], § 133; *Steur k. Vendeve të Ulëta*, § 38).

419. Për më tepër, duke pasur parasysh statusin specifik të avokatëve dhe pozicionin e tyre në administrimin e drejtësisë, Gjykata çmon se avokatët nuk mund të barazohen me gazetarët. Pozicionet dhe rolet e tyre në procedurat gjyqësore janë thelbësisht të ndryshme. Gazetarët kanë për detyrë të japin - në përputhje me detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre - informacione dhe ide për të gjitha çështjet me interes publik, përfshirë ato që lidhen me administrimin e drejtësisë. Avokatët, nga ana tjetër, janë protagonistë në sistemin e drejtësisë dhe përfshihen drejtpërdrejt në funksionimin e saj dhe në mbrojtjen e një pale (*Morice k. Francës* [DhM], §§ 148 dhe 168).

B. Përcjellja mediatike e proceseve gjyqësore

1. Metodologjia

420. E drejta e informimit të publikut dhe e drejta e publikut për të marrë informacione përballeshme me interesat publike dhe private po aq të rëndësishme që mbrohen nga ndalimi i publikimit të informacionit që kanë të bëjnë me fshehtësinë e hetimeve penale. Këto interesa janë autoriteti dhe paanshmëria e gjyqësorit, efektiviteti i hetimit penal dhe e drejta e të akuzuarit për prezumimin e pafajësisë dhe mbrojtja e jetës së tij private (*Bédat k. Zvicrës* [DhM], § 55). Kështu, në lojë janë zakonisht të drejtat e garantuara nga neni 6 § 2 i Konventës (*Bladet Tromsø dhe Stensaas k. Norvegjisë* [DhM], § 65; *Axel Springer SE dhe RTL Television GmbH k. Gjermanisë*, §§ 40-42; *Eerikäinen dhe Të tjerë k. Finlandës*, § 60) dhe nga neni 8 i Konventës (*Bédat k. Zvicrës* [DhM], §§ 72 e vijues; *Axel Springer SE dhe RTL Television GmbH k. Gjermanisë*, § 40).

421. Kur Gjykata investohet të gjykojë mbi konfliktin mes dy drejtave që gëzojnë mbrojtje të njëjtë sipas Konventës, ajo duhet të peshojë interesat që lindin. Parimisht, vendimmarrja nuk duhet të ndryshojë pavarësisht nëse kërkesa është depozituar nga personi që ka qenë objekt i artikullit të kontestuar apo nga autori i këtij artikulli (*Bédat k. Zvicrës* [DhM], §§ 52-53; *Egeland dhe Hanseid k. Norvegjisë*, §§ 53 dhe 63).

422. Kështu, kur autoritetet kombëtare kanë bërë këtë baraspeshim të këtyre dy të drejtave në përputhje me kriteret e përcaktuara në jurisprudencën e Gjykatës, Gjykatës i duhen arsye të forta për të zëvendësuar pikëpamjet e saj me ato të gjykatave vendase (*Haldimann dhe Të tjerë k. Zvicrës*, § 55).

423. Kur roli mbikëqyrës i Gjykatës nuk imponon peshimin e dy të drejtave të që gëzojnë mbrojtje të njëjtë, ajo kryen analizën e proporcionalitetit. Gjykata vlerëson ndërhyrjen e pretenduar në dritën e çështjes si e tërë, përfshirë masën e komenteve të kërkuarit dhe kontekstin ku janë bërë, si edhe përcakton nëse "i korrespondonte një "nevoje të ngutshme shoqërore", nëse ishte "proporcionale me qëllimin legjitim të synuar" dhe nëse arsyet e autoriteteve kombëtare për ta justifikuar janë "relevante dhe të mjaftueshme" (*Amihalachioaie k. Moldavisë*, § 30).

2. Parime të përgjithshme

424. Gjykata vlerëson se togfjalëshi "autoriteti i gjyqësorit" përfshin konceptin që gjykatat janë dhe pranohen nga publiku i gjerë si forumi i duhur për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ligjore dhe për përcaktimin e fajësisë apo pafajësisë së personit për një akuzë penale dhe se publiku i gjerë ka respekt dhe besim në kapacitetin e gjykatave për të përmbushur këtë funksion (*Morice k. Francës* [DhM], § 129; *Di Giovanni k. Italisë*, § 71).

425. Besimi që gjykatat në një shoqëri demokratike duhet të ngjallin jo vetëm te i akuzuari, për sa u përket proceseve penale (*Kyprianou k. Qipros* [DhM], § 172), por edhe te publiku i gjerë (*Morice k. Francës* [DhM], § 130; *Kudeshkina k. Rusisë*, § 86) është themelor.

426. Në mjaft aktgjykime, Gjykata ka theksuar rolin e veçantë të sistemit të drejtësisë, si institucion thelbësor për çdo shoqëri demokratike (*Di Giovanni k. Italisë*, § 71; *Prager dhe Oberschlick k. Austrisë*, § 34).

427. Për pasojë, si garantuese e drejtësisë, vlerë themelore në një Shtet të sunduar nga ligji, gjykata duhet të gëzojë besimin e publikut, në mënyrë që të jetë e suksesshme në kryerjen e detyrave të saj. Prandaj, mund të rezultojë e nevojshme që ky besim të mbrohet ndaj sulmeve të rënda dëmtuese që janë të pabaza, sidomos në dritën e faktit se gjyqtarët e kritikuar i nënshtrohen detyrimit të diskrecionit që ua mohon të drejtën e replikës (*Morice k. Francës* [DhM], § 128; *Di Giovanni k. Italisë*, § 71; *Kudeshkina k. Rusisë*, § 86).

428. Sidoqoftë, kufizimet në lirinë e shprehjes që lejohen nga paragrafi i dytë i nenit 10 "për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor" nuk u japin të drejtën Shteteve të kufizojnë të gjitha format e diskutimit publik mbi çështjet që po shqyrtohen nga gjykatat (*Worm k. Austrisë*, § 50).

429. Vërtet që Gjykata e cilëson të pakonceptueshme që të mos ketë diskutime paraprake apo të njëkohshme për objektin e gjyqeve, qoftë në gazeta të specializuara, në shtypin e zakonshëm apo mes publikut të gjerë. Jo vetëm që mediat kanë detyrën që të shpërndajnë këto informacione dhe ide, por edhe publiku ka të drejtë t'i marrë ato (*Bédat k. Zvicrës* [DhM], § 51).

430. Me kusht që të mos kapërcejë kufijtë e vendosur në interes të administrimit të duhur të drejtësisë, raportimi si dhe komentet mbi procedurat gjyqësore kontribuojnë në publicitetin e tyre dhe kështu janë në sintoni të plotë me kërkesën e nenit 6 § 1 të Konventës që seancat të jenë publike. Jo vetëm që media ka për detyrë të japë informacione dhe ide të tilla, por edhe publiku ka të drejtë t'i marrë ato (*Worm k. Austrisë*, § 50).

431. Në këtë kontekst, Gjykata i referohet rregullisht Rekomandimit Rek(2003)13 të Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare për sigurimin e informacionit përmes medias, miratuar më 10 korrik 2003 (shih, për shembull, *Dupuis dhe Të tjerë k. Francës*, § 42).

432. Gjykata ka vërejtur se gazetarët që raportojnë gjatë zhvillimit të proceseve gjyqësore duhet të mos tejkalojnë kufijtë e vendosur në interesat e administrimit të duhur të drejtësisë dhe të respektojnë të drejtën e të akuzuarit për prezumimin e pafajësisë (*Du Roy dhe Malaurie k. Francës*, § 34), pavarësisht nëse gjyqi i bëhet një figure publike (*Worm k. Austrisë*, § 50).

433. Gjykata është shprehur më tej se konsideratë i duhet të kushtuar të drejtës së gjithkujt që të dëgjohet drejtësisht siç garantohet nga neni 6 § 1 i Konventës, i cili, në çështjet penale, përfshin të drejtën për një gjykatë të paanshme dhe në këtë kontekst kufijtë e komentit të lejueshëm nuk mund të përfshijnë deklarata që mund të paragjykojnë me dashje ose jo shanset e një personi për të pasur proces të rregullt apo që mund të minojnë besimin e publikut te roli i gjykatave në administrimin e drejtësisë penale (*Tourancheau dhe July k. Francës*, § 66).

3. Kriteret për ankim

434. Më poshtë renditen kriteret për depozitim ankimi pranë Gjykatës, por që nuk janë shteruese, ndërsa konsideratat shtesë që zbatohen në varësi të interesave që prekin publikimet e kontestuara ilustrohen në pjesën 4 në vijim.

a. Kontributi në një debat publik mbi një çështje me interes të përgjithshëm

435. Çështjet lidhur me funksionimin e sistemit të drejtësisë si një institut thelbësor për çdo shoqëri demokratike, janë brenda interesit publik (*Morice k. Francës* [DhM], § 128; *July dhe SARL Libération k. Francës*,

§ 67), prandaj kërkojnë nivel më të lartë mbrojtjeje të lirisë së shprehjes, ku hapësira e vlerësimit që u lejohet autoriteteve është veçanërisht e ngushtë (*Morice k. Francës* [DhM], §§ 125 dhe 153; *July dhe SARL Libération k. Francës*, § 67).

436. Komentet për funksionimin e gjyqësorit duhet të kenë natyrën e "interesit publik; kjo vlen edhe kur po zhvillohet procesi gjyqësor për të pandehur të tjerë (*Morice k. Francës* [DhM], § 125; *Roland Dumas k. Francës*).

437. Edhe nëse komentet kanë një dozë armiqësie (*E.K. k. Turqisë*, §§ 79-80) apo ashpërsie të fortë (*Thoma k. Luksemburgut*, § 57) e drejta për nivel të lartë mbrojtjeje prapë prevalon për shkak se çështja është me interes publik (*Paturel k. Francës*, § 42).

438. Përcjellja e gjerë mediatike e një çështjeje ku janë dhënë deklarata të kontestuara, mund të jetë tregues i kontributit të saj në një debat me interes publik (*Bédat k. Zvicrës* [DhM], § 64; *Morice k. Francës* [DhM], § 151).

b. Natyra ose përmbajtja e komenteve të kontestuara

439. Gjykata shqyrton natyrën e komenteve të kontestuara duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e çështjes, sidomos interesat legjitime që lindin përkundër të drejtës për informimin e publikut dhe të drejtën e publikut për të marrë informacione, e mbrojtur nga neni 10 i Konventës (shih, për shembull, *Bédat k. Zvicrës* [DhM], §§ 58 e vijues, për fshehtësinë e hetimit gjyqësor dhe prezumimin e pafajësisë; *Morice k. Francës* [DhM], §§ 154 e vijues, për mbrojtjen e reputacionit të gjyqtarëve).

c. Metoda e marrjes së informacionit të kontestuar

440. Mënyra me të cilin një person merr informacionin e kontestuar është kriter i rëndësishëm, sidomos për publikimet që cenojnë fshehtësinë e hetimeve gjyqësore (*Bédat k. Zvicrës* [DhM], § 56).

441. Në çështjen *Bédat k. Zvicrës* [DhM], Gjykata çmoi se fakti që kërkuesi nuk kishte vepruar në mënyrë të paligjshme për marrjen e informacionit nuk ishte detyrimisht faktor vendimtar në vlerësimin nëse kishte respektuar detyrimet dhe përgjegjësitë e veta kur publikoi informacionin, për shkak se kërkuesi si gazetar profesionist nuk mund të mos ishte në dijeni të natyrës konfidenciale së informacionit që kishte në plan të publikonte (§ 57; shih edhe *Pinto Coelho k. Portugalisë (nr. 2)*, për përdorim të paautorizuar të një incizimi në një seancë gjyqësore; *Dupuis dhe Të tjerë k. Francës* për përdorimin dhe riprodhimin në një libër të pjesëve të dosjes së një hetimi që ishte ende në proces).

d. Nëse ndalimi i publikimit apo penaliteti ishte proporcional

442. Gjatë shqyrtimit të një ndalimi të përgjithshëm dhe absolut që zbatohet vetëm për proceset penale të filluara mbi një ankesë të shoqëruar nga një kërkesë e palës civile dhe jo për ato të ngritura mbi një kërkesë të prokurorit apo tjetër, Gjykata çmon se ky dallim në trajtimin e së drejtës për informim dukej se nuk bazohet në ndonjë shkak objektiv, teksa pengon plotësisht të drejtën e shtypit për të informuar publikun për çështje të cilat mund të jetë në interes të publikut, megjithëse kishin të bënin me proces penal ku ishte bërë një kërkesë nga pala civile (*Du Roy dhe Malaurie k. Francës*, § 35).

443. Përkundrazi, Gjykata çmon se një kufizim i ngushtë dhe i përkohshëm që thjesht ndalon riprodhimin fjalë për fjalë të dokumenteve procedurale deri në momentin që lexohen në gjykatë, nuk parandalon analizën dhe komentet mbi materialet procedurale ose publikimin e informacionit të marrë nga vetë procesi gjyqësor, dhe nuk kufizon plotësisht të drejtën e shtypit për të informuar publikun (*Tourancheau dhe July k. Francës*, § 73).

444. Në një çështje për një urdhër gjykatë që ndalonte një gazetar të raportonte për një incident që përfshinte një gjyqtar dhe procedurat gjyqësore përkatëse, Gjykata çmoi se masa e kontestuar, nisur nga objekti shumë i gjerë i saj, ishte në dëm të autoritetit të gjyqësorit sepse reduktonte transparencën e procesit gjyqësor dhe mund të ngrinte pikëpyetje për paanshmërinë e gjykatës (*Obukhova k. Ruisë*, § 27).

445. Në këndvështrimin e Gjykatës, çështja e lirisë së shprehjes lidhet me pavarësinë e profesionit të juristit, çka është thelbësore për funksionimin efektiv të administrimit të paanshëm të drejtësisë (*Morice k. Francës* [DhM], § 135; *Sialkowska k. Polonisë*, § 111). Vetëm në raste përjashtimore kufizimi i lirisë së shprehjes së avokatit mbrojtjes, qoftë edhe me sanksion penal të butë, mund të pranohet si i nevojshëm në një shoqëri demokratike (*Nikula k. Finlandës*, § 55; *Kyprianou k. Qipros* [DhM], § 174; *Mor k. Francës*, § 44).

446. Gjykata vëren se penaliteti ndaj një avokati mund të ketë pasoja të drejtpërdrejta (procedim disiplinor) ose të tërthorta, për shembull në imazhin e avokatëve apo në besimin që publiku dhe klientët e tyre kanë te ata (*Mor k. Francës*, § 176; shih edhe *Dupuis dhe Të tjerë k. Francës* § 48; *Mor k. Francës*, § 61), ose më përgjithësisht, efekt frenues në profesionin e avokatisë në tërësi (*Pais Pires de Lima k. Portugalisë*, § 67).

447. Gjykata vazhdimisht është shprehur se pozita dominuese e institucioneve shtetërore kërkon që autoritetet të tregojnë vetëpërmbytje në ngritjen e padive penale në çështjet e lirisë së shprehjes, sidomos kur kanë në dispozicion sanksione të tjera nga dënimi me burg.

448. Në një çështje mbi dënimin e një avokati për "përçmim të gjykatës" sepse doli nga kontrolli në një seancë, Gjykata theksoi se ndërkohë që u takon autoriteteve gjyqësore dhe disiplinore që në interes të funksionimit normal të drejtësisë të penalizojnë sjellje të caktuara të avokatëve, këto autoritete duhet të garantojnë që ky shqyrtim të mos përbëjë kërcënim me efekt frenues që do të dëmtonte mbrojtjen e interesave të klientëve të tyre (*Bono k. Francës*, § 55; *Kyprianou k. Qipros* [DhM], § 181; *Rodriguez Ravelo k. Spanjës*, § 49).

449. Gjykata çmoi ndër të tjera se gjykimi i shkurtuar dhe mungesa e paanshmërisë gjatë procedimit të "përçmimit" që rezultoi në dënim të avokatit bashkërisht përbënin mungesë të proporcionalitetit (*Kyprianou k. Qipros* [DhM], §§ 171 dhe 181).

450. Në një çështje në lidhje me botimin e një artikulli në ballinën e një reviste, me akuza se një studente ishte përdhunuar në festën e një ekipi bejsbolli, Gjykata vendosi se ishte shkelur e drejta e prezumimit të pafajësisë për pjesëtarët e ekipit dhe, në këtë rast, sanksionet penale që janë jashtëzakonisht të pajtueshme me nenin 10, nuk kishin qenë joproporcionale. Këto akuza shumë të rënda ishin paraqitur si fakte dhe ankuesit nuk verifikuan nëse kishin ndonjë bazë faktike; përveç kësaj, akuzat u publikuan para fillimit të hetimit penal (*Ruokanen dhe Të tjerë k. Finlandës*, § 48).

451. Në një çështje ku një avokat që ishte edhe politikan u dënua për shpifje ndaj një prokurori pas botimit të një libri në të cilin përshkruante gjyqin e vet, Gjykata vuri në dukje se komentet e mbajtura si shpifëse ishin të njëjtat me ato të bëra nga kërkuesi dy vjet më parë gjatë një incidenti në gjykim. Gjykata vuri në dukje se nuk kishte filluar asnjë procedim disiplinor ndaj kërkuesit, ose për fyerje siç përcaktonte Kodi Penal, ose në bazë të statusit të tij si avokat. Gjykata nënvizoi edhe se kur kërkuesi përsëriti komentet e kontestuara në librin e vet dy vjet pas incidentit në seancë, dhe pasi u lirua nga akuzat, ai tregoi kujdes t'i vendoste në kontekst dhe t'i shpjegonte. Në vlerësimin nëse masa e kontestuar ishte proporcionale, Gjykata i kushtoi një peshë faktit që gjykatat vendase nuk kishin marrë parasysh këta faktorë të rëndësishëm (*Roland Dumas k. Francës*, §§ 47-49).

4. Konsiderata kontekstuale lidhur me interesat që mund të preken nga publikimet e kontestuara

a. Publikimet/deklaratat që mund të ndikojnë në proceset gjyqësore

452. Gjykata merr parasysh aspekte të ndryshme të çështjes në mënyrë që të vlerësojë ndikimin e mundshëm të një publikimi të kontestuar në zhvillimin e procedurave gjyqësore. Koha e botimit, natyra e përmbajtjes (nëse është provokuese ose jo) dhe statusi (profesional ose jo) i gjyqtarëve që vendosin në një çështje janë ndër aspektet që Gjykata shqyrton më shpesh.

453. Lidhur me rëndësinë e kohës së botimit, Gjykata vuri në dukje në një çështje se artikulli i kontestuar u botua në një moment kritik të procesit penal - kur prokuroria po paraqiste konkluzionet përfundimtare - dhe kur respektimi i prezumimit të pafajësisë të palës së paditur ishte veçanërisht i rëndësishëm (*Campos Dâmaso k. Portugalisë*, § 35; shih, për publikimin para një seance të apelit, *Touranbeau dhe July k. Francës*, § 75; shih edhe *Dupuis dhe Të tjerë k. Francës*, § 44).

454. Gjykata mban parasysh edhe statusin joligjor të anëtarëve të një jurie (porotët) që duhet të vendosin mbi fajësinë e të pandehurve është një tjetër aspekt që Gjykata mban parasysh (*Touranbeau dhe July k. Francës*, § 75) kur vlerëson ndikimin e mundshëm të një artikulli të zhvillimi i procedurave gjyqësore.

455. Duke pasur parasysh hapësirën e vlerësimit të Shtetit, parimisht u takon gjykatave vendase të vlerësojnë gjasat që gjyqtarët porotë të lexojnë artikullin e kontestuar dhe ndikimin që ai mund të ketë (*The Sunday Times k. Mbretërisë së Bashkuar (nr. 1)*, § 63; *Worm k. Austrisë*, § 54).

456. Në këndvështrimin e Gjykatës, fakti që gjyqtarë porotë mund të investohen për të vendosur çështje, redukton rrezikun që publikimet të prekin rezultatin e procesit gjyqësor (*Campos Dâmaso k. Portugalisë*, § 35; *A.B. k. Zvicrës*, § 55).

457. Ndikimi i një publikimi të kontestuar në proceset e krijimit të opinionit dhe vendimmarrjes brenda gjyqësorit u tregua kur artikulli në fjalë paraqiste një pamje shumë negative të të pandehurit, duke theksuar disa aspekte shqetësuese personaliteti të tij dhe duke konkluduar se ai po bënte gjithçka për ta pamundësuar mbrojtjen e vet (*Bédât k. Zvicrës* [DhM], § 69).

458. Përkundrazi, Gjykata vendosi në një çështje se kërkuesi, një gazetar, nuk kishte mbajtur qëndrim në artikujt e veta lidhur me reduktimin potencial të masës së dënimit të një individi deri në gjobë, çka, sipas Gjykatës reduktohte mundësinë që artikujt të preknin rezultatin e procesit gjyqësor (*Campos Dâmaso k. Portugalisë*, § 35).

b. Publikimet që mund të cenojnë konfidencialitetin e hetimit gjyqësor dhe prezumimin e pafajësisë

459. Gjykata thekson se fshehtësia e hetimeve synon të mbrojë si interesat e proceseve penale duke i paraprirë rrezikut të bashkëpunimit dhe manipulimit ose shkatërrimit të provave, ashtu edhe interesat e të akuzuarit, kryesisht nga optika e prezumimit të pafajësisë, si edhe më përgjithësisht, marrëdhëniet dhe interesat e tij personale. Kjo fshehtësi justifikohet edhe nga nevoja për të mbrojtur proceset e formimit të opinionit dhe vendimmarrjes brenda gjyqësorit (*Bédât k. Zvicrës* [DhM], § 68; *Brisic k. Rumanisë*, § 109; *Touranbeau dhe July k. Francës*, § 63; *Dupuis dhe Të tjerë k. Francës*, § 44).

460. Kur një çështje përcillet gjerësisht në media për shkak të fakteve të rënda dhe individëve që mund të implikohen, një avokat nuk mund të penalizohet për shkeljen e sekretit hetimor kur thjesht bën komente personale mbi informacionin që është e ditur tashmë për gazetarët dhe që synojnë të raportojnë, me ose pa ato komente. Sidoqoftë, kur bën deklarata publike, avokati nuk përjashtohet nga detyrimi që të tregohet i matur mbi fshehtësinë e një hetimi gjyqësor në proces (*Morice k. Francës* [DhM], § 138; *Mor k. Francës*, §§ 55-56).

461. Në një çështje lidhur me shkarkimin e një kryeprokurori sepse iu dha informacione medias mbi një hetim që po kryhej për trafik influencash, Gjykata vuri në dukje se ai kishte dhënë një përshkrim përmbledhës të organit të akuzës në fazën fillestare; kërkuesi nuk kishte nxjerrë emrin e ndonjë individi të përfshirë në pritje të përfundimit të hetimit gjyqësor dhe nuk kishte zbuluar ndonjë informacion ose dokument konfidencial nga dosja. Ajo çmoi edhe se gjykatat vendase nuk dhanë arsye "relevante dhe të mjaftueshme" në mbështetje të vendimit të tyre se ishte shkelur fshehtësia e hetimit penal (*Brisic k. Rumanisë*, §§ 110-115).

462. Në një çështje lidhur me një gazetare që transmetoi pa leje një regjistrim audio nga një seancë gjyqësore, Gjykata konkludoi se interesi për informimin e publikut eklipson "detyrimet dhe përgjegjësitë" që i takojnë gazetares kërkuese. Veprimet e saj synonin të zbulonin një gabim të drejtësisë të cilin ajo besonte se kishte ndodhur në lidhje me një nga personat e dënuar. Gjykata pati parasysh veçanërisht dy elementë: së pari, kur u transmetua raporti i kontestuar, çështja gjyqësore ishte vendosur dhe nuk dihej me siguri se transmetimi i regjistrimeve audio mund të kishte efekt negativ në administrimin e duhur të drejtësisë. Madje, zërat e pjesëmarrësve në seancë ishin shtrembëruar që të mos identifikoheshin (*Pinto Coelho k. Portugalisë (nr. 2)*, §§ 49-50).

463. Në një çështje lidhur me kufizimet në përcjelljen mediatike të një gjyqi penal të rëndësishëm në Norvegji, Gjykata argumentoi që, në varësi të rrethanave, transmetimi i drejtpërdrejtë i pamjeve dhe zërit nga salla e gjyqit mund të tjetërsojë karakteristikat e tij, të krijojë presion shtesë mbi pjesëmarrësit në gjykim dhe madje të ndikojë keq në mënyrën si sillen dhe kështu paragjykon administrimin e drejtë të drejtësisë. Gjykata vërejti se nuk kishte asnjë pikë të përbashkët mes sistemeve të brendshme të Shteteve Kontraktuese lidhur me efektet e transmetimit drejtpërdrejtë, qoftë në radio ose televizion, por ai është një mjet jetik për shtypin që të japë informacion dhe ide mbi proceset gjyqësore (*P4 Radio Hele Norge ASA k. Norvegjisë* (vend.)).

c. Publikimi i informacionit për jetën private të palëve në gjyq

464. Në një çështje lidhur me dënimin e një gazetari për zbulimin e informacionit që përbënte sekret hetimor, sidomos letrat që i pandehuri i shkruante gjyqtarit dhe informacionin me natyrë mjekësore, Gjykata çmoi se autoritetet kombëtare nuk ishin thjesht objekt i detyrimit negativ për të mos zbuluar me dashje informacionin e mbrojtur nga neni 8, por se edhe duhej të merrnin masa për mbrojtje efektive të të drejtave të një akuzuari, përfshirë të drejtën për respektimin e korrespondencës së tij (*Bédat k. Zvicrës* [DhM], § 76; shih edhe *Craxi k. Italisë (nr. 2)*, § 73).

465. Në këndvështrimin e Gjykatës, ky lloj informacioni kërkon nivelin më të lartë të mbrojtjes sipas nenit 8; kjo gjetja është veçanërisht e rëndësishme pasi i akuzuari nuk ishte i njohur për publikun. Thjesht fakti se ishte objekt i një hetimi penal për një vepër shumë të rëndë nuk e justifikon trajtimin e tij njësoj si një figurë publike që ekspozohet vullnetarisht ndaj reklamës (shih gjithashtu, në një kontekst të ngjashëm, *Fressoz dhe Roire k. Francës* [DhM], § 50; *Egeland dhe Hanseid k. Norvegjisë*, § 62; lidhur me mbrojtjen e identitetit të palës së dëmtuar, shih *Kurier Zeitungsverlag und Druckerei GmbH k. Austrisë*).

d. Përçmimi i gjykatës

466. Gjykata pranon që gjyqtarët janë pjesë e një institucioni themelor të Shtetit të cilët - përveç sulmeve të rënda dëmtuese që janë thelbësisht të pabazuara – mund të jenë objekt i kritikave personale brenda kufijve të lejueshëm jo vetëm në një mënyrën teorike dhe të përgjithshme. Kur veprojnë në cilësinë e tyre zyrtare, kufijtë e kritikës së pranueshme ndaj tyre mund të jenë më të gjera sesa për qytetarët e zakonshëm (*Morice k. Francës* [DhM], § 131; *July dhe SARL Libération k. Francës*, § 74; *Aurelian Oprea k. Rumanisë*, § 74; *Do Carmo de Portugal e Castro Câmara k. Portugalisë*, § 40).

467. Gjithsesi, mund të rezultojë e nevojshme që gjyqësori të mbrohet ndaj sulmeve të rënda dëmtuese që janë thelbësisht të pabazuara (*Prager dhe Oberschlick k. Austrisë*, § 34; *Lešník k. Sllovakisë*, § 54; për kritikën e të pandehurit ndaj prokurorit, shih *Čeferin k. Sllovenisë*, §§ 56 e 58).

468. Avokatëve u takon të bëjnë komente publike për administrimin e drejtësisë, me kusht që kritika e tyre të mos tejkalojë disa kufij të caktuar (*Amihalachioaie k. Moldavisë*, §§ 27-28; *Foglia k. Zvicrës*, § 86; *Mor k. Francës*, § 43). Këto kufizime përcaktohen zakonisht në kodin e sjelljes së anëtarëve të Dhomës së Avokatisë (*Kyprianou k. Qipros* [DhM], § 173).

469. Në këtë kontekst, Gjykata i është referuar dhjetë parimeve bazë të përcaktuar në Këshillin e Avokatisë dhe Shoqatave të Ligjit të Evropës, me referencë të veçantë të "dinjiteti, nderi dhe integriteti", si edhe të "respektimi i administrimit të drejtë të drejtësisë" (*Morice k. Francës* [DhM], §§ 58 dhe 134). Në opinionin e Gjykatës, rregulla të tilla kontribuojnë në mbrojtjen e gjyqësorit ndaj sulmeve të pabaza të cilat mund të nxiten vetëm nga dëshira apo strategjia që debati gjyqësor të bëhet në media apo që të hakmerren ndaj gjyqtarëve që trajtojnë çështjen.

470. Për më tepër, duhet bërë dallimi nëse avokati shprehet në sallën e gjyqit apo gjetkë. Së pari, sa i përket "sjelljes në sallën e gjyqit", meqë liria e shprehjes mund të ngrejë problematikën e të drejtës së klientit të vet për proces të rregullt, parimi i paanshmërisë shkon në favor të shkëmbimit të lirë dhe madje edhe të detyrueshëm ndërmjet palëve. Avokatët kanë detyrimin "të mbrojnë me zell interesat e klientëve të tyre", që nënkupton se ndonjëherë duhet të vendosin nëse të kundërshtojnë apo të ankohen për sjelljen në gjyq. Gjithashtu, Gjykata mban parasysh faktin se komentet e kontestuara nuk janë përsëritur jashtë sallës së gjyqit (*Morice k. Francës* [DhM], §§ 136-137).

471. Duke iu kthyer komenteve të bëra jashtë sallës së gjyqit, Gjykata thekson se mbrojtja e klientit mund të bëhet përmes shfaqjes në lajmet televizive ose një deklaratë në shtyp, dhe përmes kanaleve të tilla, avokati mund të informojë publikut për mangësitë që mund të cenojnë procedurën para gjyqit (*Morice k. Francës* [DhM], § 138). Për shembull, Gjykata vërejtë se komentet e bëra nga avokati për gazetarët sapo del nga salla e gjyqit ishte pjesë e një përqsajeje analitike me synimin që të bindej prokurori që të ankimonte vendimin për rrëzimin e akuzave, prandaj ishte koment në kuadrin e detyrës për të mbrojtur klientin e vet (*Ottan k. Francës* § 58).

472. Po kështu, Gjykata bën dallimin e personit në fjalë; kështu, prokurori, që është "palë" në procesin gjyqësor, duhet "të tolerojë kritika të ashpra nga... avokati mbrojtës" (*Morice k. Francës* [DhM], § 137; *Nikula k. Finlandës*, §§ 51-52; *Foglia k. Zvicrës*, § 95; *Roland Dumas k. Francës*, § 48).

473. Kështu, në një çështje ku procedimi privat për shpifje u iniciua nga një prokuror kundër një avokateje, gjatë një seance gjyqësore, kishte ngritur kundërshtim dhe kishte lexuar me zë një deklaratë ku kritikonte prokurorin, Gjykata çmoi se kritikën e tilla të bëra nga avokatja brenda sallës së gjyqit dhe jo përmes medias, ishin të natyrës procedurale dhe rrjedhimisht nuk arrinin nivelin e fyerjes personale (*Nikula k. Finlandës*, § 52; shih edhe *Lešník k. Sllovakisë*).

474. Për më tepër, avokatët nuk mund të bëjnë komente aq të rënda saqë të tejkalojnë shprehjen e lejueshme të komenteve pa një bazë të shëndoshë faktike, as nuk mund të parashtrajnë fyerje. Gjykata vlerëson komentet në kontekstin e tyre të përgjithshëm, sidomos për të vlerësuar nëse janë keqorientuese apo sulme personale të qëllimta si edhe për të konstatuar se komentet kanë lidhje mjaftueshëm të ngushtë me faktet e çështjes (*Morice k. Francës* [DhM], § 139, me referenca të mëtejshme).

475. Në një çështje ku një i burgosur (kërkuesi) i dërgon një letër gjykatës së rrethit, Gjykata bëri një dallim të qartë mes kritikës dhe fyerjes. Në këndvështrimin e Gjykatës, kur qëllimi i vetëm i individit është të fyejë gjykatën ose gjyqtarët e trupës, nuk përbën parimisht shkelje të nenit 10 me kusht që të vendoset një ndëshkim i përshtatshëm. Sidoqoftë, dënimi i rëndë me burg u gjet nga Gjykata në tejkallim të ashpërsisë së veprës penale, sidomos ngaqë kërkuesi nuk ishte dënuar më parë për një shkelje të ngjashme dhe letra nuk ishte bërë publike (*Skalka k. Polonisë*, §§ 39-42).

476. Në një çështje tjetër ku kërkuesi ishte ndjekur penalisht, paraburgosur dhe shtruar pastaj në një institucion psikiatrik për 35 ditë për shkak të letrave që u kishte dërguar gjyqtarëve të cilat ishin vlerësuar si përcmuese, Gjykata çmoi se komentet e kërkuesit, të cilat ishin veçanërisht kaustike, virulente dhe fyese ndaj disa anëtarëve të gjyqësorit, ishin regjistruar vetëm me shkrim dhe nuk ishin bërë publike. Si rrjedhojë, ndikimi i tyre te besimi i publikut për administrimin e drejtësisë kishte qenë shumë i kufizuar. Gjykata vëren më tutje se prokuroria që kërkoi burgimin e tij kishte marrë pjesë në procesin gjyqësor për t'i vendosur një kujdestar dhe prandaj ishte e vetëdijshme në momentin kur kërkoi burgosjen se gjendja mendore e kërkuesit ishte më së paku e diskutueshme dhe mund të ishte arsyeja pse veproi ashtu (*Ümit Bilgiç k. Turqisë*, §§ 133-136).

477. Në një çështje ku kërkuesi, një avokat që u ankua pranë Këshillit të Lartë të Gjyqësorit me akuza korrupsioni ndaj një gjyqtari që kishte vendosur në një çështje civile lidhur me një prej klientëve të tij, u urdhërua të paguante 50 000 Euro dëmshpërblim ndaj gjyqtarit në fjalë, Gjykata çmoi se penaliteti ishte i tepërt dhe i mungonte baraspesha e drejtë. Gjykata vërejti në veçanti se gjykatat vendase vlerësuan se edhe pse akuzat nuk u bënë publike, ato ishin diskutuar në rrethet gjyqësore. Në këtë kuptim, Gjykata çmoi se kërkuesi nuk mund të ngarkohej me përgjegjësi për rrjedhje të informacionit nga procese gjyqësore që supozoheshin të ishin konfidenciale (*Pais Pires de Lima k. Portugalisë*, § 66).

C. Pjesëmarrja e gjyqtarëve në debatin publik

478. Edhe nëse një problematikë e debatuar ka aspekte politike, kjo nuk mjafton për ta ndaluar gjyqtarin që të bëjë deklaratë mbi atë çështje (*Wille k. Lihtenshtejnit* [DhM], § 67).

479. Gjykata e zbatoi këtë parim në një çështje për mbarimin e parakohshëm të mandatit të kërkuesit si Kryetar i Gjykatës së Lartë sepse shprehu pikëpamjet e veta dhe kritika, kryesisht ndaj Parlamentit, lidhur me reformat kushtetuese dhe normative që preknin organizimin e sistemit gjyqësor, edhe pse mbante postin e gjyqtarit brenda gjyqësorit. Në këtë rast, Gjykata i kushtoi rendësi të veçantë postit që mbante kërkuesi, i cili ishte edhe Kryetar i Këshillit Kombëtar të Gjyqësorit, funksionet dhe detyrat e të cilit përfshinin shprehjen e opinionëve për reformat normative që pritej të ndikonin te gjyqësori dhe pavarësia e tij (*Baka k. Hungarisë* [DhM], § 168).

480. Gjykata iu referua instrumenteve të Këshillit të Evropës, të cilat pranojnë se çdo gjyqtar është përgjegjës për promovimin dhe mbrojtjen e pavarësisë gjyqësore dhe se gjyqtarët dhe gjyqësori duhet të konsultohen dhe të përfshihen në hartimin e legjislacionit lidhur me statusin e tyre dhe më përgjithësisht edhe në funksionimin e sistemit gjyqësor (shih paragrafin 34 të Opinionit nr. 3 (2002) të CCJE (Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë) dhe paragrafët 3 dhe 9 të Magna Kartës së Gjyqtarëve (*Baka k. Hungarisë* [DhM], §§ 80-81).

481. Në një rast, kërkuesja pretendonte se është larguar nga detyra në gjyqësor për shkak të disa deklaratave që bëri në media gjatë fushatës së zgjedhjeve. Gjykata vuri re në këtë rast që kërkueses nuk i ishin dhënë "garanci të rëndësishme procedurale" në kontekstin e procedimit disiplinor dhe se sanksioni ndaj saj kishte qenë i ashpër dhe joproporcional si edhe kishte "efekt frenues" te gjyqtarët që dëshironin të merrnin pjesë në debatin publik mbi efektivitetin e institucioneve gjyqësore (*Kudeshkina k. Ruisë*, §§ 97-99).

482. Në çështjen *Previti k. Italisë* (vend.), Gjykata vendosi që gjyqtarët, në cilësinë e tyre si ekspertë ligjorë, mund të shprehin pikëpamjet e tyre si dhe kritika lidhur me ndryshimet normative që ndërmerret Qeveria. Një qëndrim i tillë i shprehur në mënyrë të përshtatshme, nuk cenon autoritetin e gjyqësorit dhe as nuk paanshmërinë e tyre në një çështje të caktuar. Siç deklaroi Gjykata, fakti që, në zbatim të parimeve të demokracisë dhe pluralizmit, disa gjyqtarë ose grupe gjyqtarësh, në cilësinë e tyre si ekspertë ligjorë, mund të shprehin rezerva ose kritika në lidhje me propozimet normative të Qeverisë nuk cenon paanshmërinë e procedurave gjyqësore për të cilat mund të zbatohen këto propozime.

483. Nga ana tjetër, në një çështje ku një gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese u ankua se ishte shkarkuar nga detyra pasi kishte shprehur pikëpamjet e tij publikisht (në një letër dërguar zyrtarëve të lartë publikë dhe në një intervistë për media, si dhe një konferencë për shtyp të paautorizuar, në të cilën foli për punën e Gjykatës Kushtetuese, duke e akuzuar atë për korrupsion), Gjykata vuri në dukje se vendimi i pushimit kishte të bënte me dyshime të arsyeshme për paanshmërinë dhe pavarësinë e tij, dhe sjelljen e papajtueshme me rolin e gjyqtarit, dhe arriti në përfundimin se ankesa e paraqitur nga kërkuesi sipas nenit 10 ishte qartazi e pabazuar (*Simić k. Bosnjë-Hercegovinës* (vend., §§ 35-36).

XI. Liria e shprehjes dhe qëllimet legjitime të sigurisë kombëtare, integritetit territorial apo sigurisë publike, parandalimi i prishjes së rendit apo krimin

484. Qëllimet legjitime që përmenden në këtë kapitull evokohen në kombinim, dhe ndonjëherë njëkohësisht me qëllimet e tjera legjitime, si parandalimi i publikimit të informacionit të marrë në mirëbesim (*Stoll k. Zvicrës* [DhM], § 53) ose mbrojtja e të drejtave të të tjerëve (*Brambilla dhe Të tjerë k. Italisë*, § 50). Në disa raste, fokusi vihet te një nga qëllimet legjitime të evokuara, siç është "garantimi i integritetit territorial" në përballjet me të ashtuquajturin diskurs "separatist" (*Sürek dhe Özdemir k. Turqisë* [DhM], § 50).

485. Lufta kundër terrorizmit¹⁵ shpesh citohet si konteksti mbizotërues i çështjeve që futen në këtë kategori.

486. Dispozitat e legjislacionit të brendshëm që parashikojnë këto qëllime legjitime janë shumë të ndryshme dhe zakonisht shfaqen në Kodin Penal ose në legjislacionin kundër terrorizmit, por ndonjëherë madje edhe në Kushtetutë.

A. Parime të përgjithshme

487. Si parim i përgjithshëm, "nevoja" për çdo kufizim mbi ushtrimin e lirisë së shprehjes duhet të konstatohet bindshëm. (*Sürek dhe Özdemir k. Turqisë* [DhM], § 57; *Dilipak k. Turqisë*, § 63). Gjykatës i duhet të përcaktojë nëse arsyet që parashtrijnë autoritetet kombëtare për të justifikuar kufizimin janë "relevante dhe të mjaftueshme" (*Barthold . Gjermanisë*, § 55; *Lingens k. Austrisë*, § 40).

488. Veçanërisht për publikimin e informacionit të marrë në mirëbesim, Gjykata ka theksuar se konceptet e "sigurisë kombëtare" dhe "sigurisë publike" duhet të zbatohen me kursim dhe të interpretohen në mënyrë të kufizuar, si dhe duhet të ngrihen si shkaqe vetëm kur demonstron se janë të nevojshme për të ndaluar publikimin e informacionit për qëllimet e mbrojtjes së sigurisë kombëtare dhe sigurisë publike (*Stoll k. Zvicrës* [DhM], § 54; *Görmüş dhe Të tjerë k. Turqisë*, § 37).

489. Nga ana tjetër, Gjykata vazhdimisht është shprehur se neni 10 § 2 i Konventës lejon pak fushëveprim për të kufizuar debatin apo të folurin politik (*Brasilier k. Francës*, § 41) ose debatin për çështje me interes publik (*Sürek k. Turqisë (nr. 1)* [DhM], § 61; *Lindon, Otchakovsky-Laurens dhe July k. Francës* [DhM], § 46; *Wingrove k. Mbretërisë së Bashkuar*, § 58).

490. Liria e shprehjes është veçanërisht e rëndësishme për partitë politike dhe anëtarët e tyre aktivë. Ndërhyrja në lirinë e shprehjes së politikanëve, veçanërisht kur ata janë anëtarë të një partie opozitare, kërkon analizën më të thellë nga ana e Gjykatës. Kufijtë e kritikës së pranueshme janë më të gjerë në lidhje me Qeverinë sesa në lidhje me një qytetar privat, apo edhe një politikan (*Faruk Temel k. Turqisë*, § 55; *Incal k. Turqisë*, § 54; *Han k. Turqisë*, § 29; *Yalçmer k. Turqisë*, § 43).

491. Sipas Gjykatës, në një shoqëri demokratike të bazuar në shtetin e së drejtës, ideve politike që sfidojnë rendin ekzistues dhe realizimi i të cilave mbështetet në mjete paqësore duhet t'u ofrohet mundësia e duhur e shprehjes (*Eğitim ve Bilim Emekçileri Sendikası k. Turqisë*, § 70).

492. Nga ana tjetër, Gjykata merr parasysh problemet që lidhen me parandalimin e terrorizmit (*Gözel dhe Özer k. Turqisë*, § 55; *Karataş k. Turqisë*, § 51). Në këtë kontekst, Gjykata i kushton vëmendje të veçantë nevojës që autoritetet të jenë vigjilente ndaj veprimeve që mund të ushqejnë dhunë shtesë, konkretisht duhet të mbrojnë

¹⁵ Shih edhe [Udhëzuesin me Jurisprudencën mbi Terrorizmin](#).

sigurinë publike dhe të parandalojë prishjen e rendit apo krimin brenda kuptimit të nenit 10 § 2 (*Leroy k. Francës*, § 36).

493. Gjykata vlerëson se vështirësitë e ngritura nga lufta kundër terrorizmit nuk mjaftojnë vetvetiu për të çliruar autoritetet kombëtare nga detyrimet e tyre sipas nenit 10 të Konventës (*Döner dhe të tjerët k. Turqisë*, § 102). . Me fjalë të tjera, parimet që shfaqen nga jurisprudenca e Gjykatës në lidhje me nenin 10 zbatohen edhe për masat që marrin autoritetet kombëtare për të ruajtur sigurinë kombëtare dhe sigurinë publike në kuadrin e luftës kundër terrorizmit (*Faruk Temel k. Turqisë*, § 58).

494. Duke i kushtuar vëmendjen e duhur rrethanave të secilës çështje dhe hapësirës së vlerësimit të Shtetit, Gjykata duhet të përcaktojë nëse është gjetur baraspesha e drejtë ndërmjet të drejtës themelore të individit për lirinë e shprehjes si edhe të drejtës legjitime të shoqërisë demokratike për t'u mbrojtur ndaj veprimtarive të organizatave terroriste (*Zana k. Turqisë*, § 55; *Karataş k. Turqisë*, § 51; *Yalçın Küçük k. Turqisë*, § 39; *İbrahim Aksoy k. Turqisë*, § 60).

B. Kriteret e vlerësimit lidhur me justifikimin e ndërhyrjes

1. Kontributi në një debat me interes të përgjithshëm

495. Gjykata e ka përcaktuar qartë se çfarë nënkupton me konceptin e çështjes me interes të përgjithshëm: interesi publik zakonisht lidhet me çështje të cilat prekin publikun deri në atë masë sa që i takon të ketë interes të ligjshëm për to, të cilat tërheqin vëmendjen e publikut ose që e shqetësojnë në një masë të konsiderueshme, sidomos çështjet që ndikojnë në mirëqenien e qytetarëve ose në jetën e komunitetit. Kjo vlen edhe për çështje që kanë gjasa të shkaktojnë polemika të mëdha, siç janë çështjet për problematika të mëdha sociale apo problem për të cilin publiku ka interes të informohet (*Satakunnan Markkinapörssi Oy dhe Satamedia Oy k. Finlandës* [DhM], § 171; *Sürek dhe Özdemir k. Turqisë* [DhM], § 61).

496. Në mjaft çështje lidhur me publikimet që mund të minojnë konfidencialitetin e disa informacioneve për sigurinë kombëtare, Gjykata ka theksuar kontributin që kanë dhënë këto publikime në debate me interes të përgjithshëm. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, ato justifikoheshin nga kërkesa për të zbuluar veprime të paligjshme të shërbimeve shtetërore të sigurisë dhe nga e drejta e publikut që të informohet (*Observer dhe Guardian k. Mbretërisë së Bashkuar*, § 69; *The Sunday Times k. Mbretërisë së Bashkuar (nr. 2)*, §§ 54-55).

497. Në një çështje lidhur me dënimin e pronarit të një reviste pasi botoi një raport me akuza për dhunë ndaj agjentëve shtetërorë të përfshirë në luftimin e terrorizmit, Gjykata vuri në dukje se, duke pasur parasysh rëndësinë e shkeljes së pretenduar, publiku kishte interes legjitim të dinte jo vetëm natyrën e sjelljes së agjentëve, por edhe identitetin e tyre. Në lidhje me këtë, Gjykata vuri në dukje se informacioni mbi të cilin bazohej raporti ishte raportuar tashmë edhe nga gazeta të tjera ndaj të cilave nuk pati procedim penal (*Sürek k. Turqisë (nr. 2)* [DhM], §§ 39-40).

2. Natyra dhe përmbajtja e deklaratave dhe ndikimi potencial i tyre: analiza e tekstit në kontekst

498. Çështja thelbësore që lind në këtë lloj çështjeje është nëse deklarata ka të ngjarë të përshkallëzojë ose të justifikojë dhunën, urrejtjen ose intolerancën. Në disa çështje të tilla, Gjykata është vënë në lëvizje që të vendosë mbi zbatueshmërinë e nenit 10 të Konventës.¹⁶

¹⁶ Shih Udhëzuesin për nenin 17 të Konventës (ndalimi i abuzimit me të drejtat)

499. Sipas qëndrimit të Gjykatës, për të përcaktuar nëse deklaratat, të marra si një e tërë, mund të klasifikohen si nxitje e dhunës, duhen pasur parasysh fjalët e përdorura dhe konteksti në të cilin janë publikuar, si edhe ndikimi i tyre potencial, *Özgür Gündem k. Turqisë*, § 63; *Gözel dhe Özer k. Turqisë*, § 52).

500. Një nga faktorët kyçë në vlerësimin e Gjykatës është sfondi politik apo social në të cilin janë bërë deklaratat (*Perinçek k. Zvicrës* [DhM], § 205); për shembull: një sfond i tendosur politik ose social (*Mariya Alekhina dhe Të tjerë k. Ruisisë*, § 218; *Zana k. Turqisë*, §§ 57-60; *Sürek k. Turqisë (nr. 3)* [DhM], § 40), atmosfera gjatë një revolte vdekjeprurëse në burg (*Saygılı and Falakaoğlu (nr. 2) k. Turqisë*, § 28), problemet lidhur me integrimin e emigrantëve joevropianë në Francë dhe sidomos ata myslimanë (*Soulas dhe Të tjerë k. Francës*, §§ 38-39; *Le Pen k. Francës* (vend.)), ose marrëdhëniet me pakicat kombëtare në Lituani pak pas rifitimit të pavarësisë në vitin 1990 (*Balsytė-Lideikienė k. Lituanisë*, § 78)).

501. Një tjetër faktor ka qenë nëse deklaratat, të interpretuara apo të para në kontekstin e ngushtë apo edhe të gjerë, mund të cilësohen si thirrje e drejtpërdrejtë apo e tërthortë për dhunë apo si justifikim i dhunës, urrejtjes apo intolerancës (*Perinçek k. Zvicrës* [DhM], § 206; shih, ndër të tjera, *Incal k. Turqisë*, § 50; *Sürek k. Turqisë (nr. 1)* [DhM], § 62; *Özgür Gündem k. Turqisë*, § 64; *Gündüz k. Turqisë*, §§ 48 and 51; *Soulas dhe Të tjerë k. Francës*, §§ 39-41 dhe 43; *Balsytė-Lideikienė k. Lituanisë*, §§ 79-80; *Féret k. Belgjikës*, §§ 69-73 dhe 78; *Hizb ut-Tahrir dhe Të tjerë k. Gjermanisë* (vend.), § 73; *Kasymakhunov dhe Saybatalov k. Ruisisë*, §§ 107-112; *Fáber k. Hungarisë*, §§ 52 dhe 56-58; *Vona k. Hungarisë*, §§ 64-67).

502. Gjykata ka theksuar se në vendimmarrjen e saj i kushton rëndësi ndërveprimin mes aktorëve të sipërcituar dhe jo shqyrtimit të tyre më vete (*Perinçek k. Zvicrës* [DhM], § 208).

503. Në çështjen *Savva Terentyev k. Ruisisë*, Gjykata vuri në dukje se autoritetet vendase u përqendruan në formën dhe peshën e deklaratave të kontestuara, pa i analizuar ato në kontekstin e diskutimit përkatës, pa u përpjekur fare të vlerësonin potencialin e këtyre deklaratave për të provokuar ndonjë pasojë të dëmshme duke marrë parasysh sfondin politik dhe social ku janë bërë, si edhe pa analizuar shtrirjen e tyre. Gjykata arriti në përfundimin se, nuk janë marrë parasysh të gjitha faktet dhe faktorët përkatës, prandaj arsyet e paraqitura nuk konsiderohen "relevante dhe të mjaftueshme" për të justifikuar ndërhyrjen në lirinë e shprehjes së kërkuesit (§§ 82-84).

504. Kur pikëpamjet e shprehura nuk përmbajnë nxitje të dhunës ose, thënë ndryshe, nuk mbështesin akte dhunë ose hakmarrje të përgjakshme, nuk justifikojnë kryerjen e akteve terroriste sipas qëllimeve të mbështetësve të tyre ose nuk mund të interpretohen si inkurajim i dhunës përmes shprehjes së urrejtjes së thellë dhe joracionale ndaj personave të identifikuar, atëherë Shtetet Kontraktuese nuk duhet të kufizojnë të drejtën e publikut të gjerë për t'u informuar mbi këto pikëpamje, qoftë edhe në kuadrin e qëllimeve të përcaktuara në nenin 10 § 2 që janë mbrojtja e integritetit territorial dhe sigurisë kombëtare dhe parandalimi i prishjes së rendit ose krimit, duke bërë që peshën e të drejtës penale ta mbajë media (*Sürek k. Turqisë (nr. 4)* [DhM], § 60; *Gözel dhe Özer k. Turqisë*, § 56; *Nedim Şener k. Turqisë*, § 116; *Dilipak k. Turqisë*, § 62).

505. Sidoqoftë, kur komentet e kontestuara nxisin dhunë ndaj një individi ose një zyrtari publik ose një segmenti të popullsisë, atëherë autoritetet shtetërore gëzojnë hapësirë më të gjerë vlerësimi kur shqyrtojnë nevojën për ndërhyrje në lirinë e shprehjes (*Sürek k. Turqisë (nr. 3)* [DhM], § 37). Kjo vlen për komentet që bëjnë thirrje për përdorimin e forcës së armatosur (po aty, § 40; *Taşdemir k. Turqisë* (vend.)) ose komentet që mund të vënë në rrezik stabilitetin shoqëror, edhe nëse individët nuk bëjnë thirrje haptas në komente për përdorimin e forcës së armatosur si mjet veprimi, apo, njësoj e rëndësishme, nuk distancohen nga përdorimi i dhunës (*Yalçınmer k. Turqisë*, § 46; *Zana k. Turqisë*, § 58).

506. Në çështjen *Zana k. Turqisë*, Gjykata theksoi dy kritere në lidhje me konceptin e ndikimit potencial të deklaratave të kontestuara: së pari, roli dhe funksioni i personit që bën deklaratat dhe, së dyti, situata në aspektin e kontekstit shoqëror ku ngrihen problematikat nga këto deklarata *Yalçiner k. Turqisë*, §§ 46-49).

507. Në çështjen *Savva Terentyev k. Ruisë*, lidhur me dënimin me burg të një blogeri për komente fyese në internet kundër oficerëve të policisë, Gjykata vuri në dukje formulimin fyes, ofendues dhe virulent të komenteve të kërkuesit. Sidoqoftë, Gjykata çmoi se këto deklarata nuk mund të konsiderohen si përpjekje për të nxitur urrejtje ose për të provokuar dhunë ndaj oficerëve të policisë, pra, nuk paraqisnin rrezik të qartë dhe të afërt çka do të kërkonte dënimin e kërkuesit. Gjykata theksoi, në veçanti, se kërkuesi nuk ishte as bloger i njohur dhe as përdorues i njohur i mediave sociale dhe se, në këto rrethana, nuk kishte statusin e një figure me influencë (§ 81).

508. Ndër të tjera, Gjykata ka njohur nevojën për të garantuar mbrojtje më të madhe për pakicat e cenueshme, të karakterizuara nga një histori shtypjeje dhe pabarazie, përkundër fyerjes apo diskursit diskriminues (*Savva Terentyev k. Ruisë*, § 76; *Soulas dhe Të tjerë k. Francës*, §§ 38-39; *Le Pen k. Francës* (vend.)). Në çështjen *Savva Terentyev k. Ruisë*, ajo vuri në dukje se gjykatat e brendshme dështuan të shpjegonin pse i konsideronin të cenueshëm oficerët e policisë, për sa kohë që nuk ishin identifikuar me emër (§§ 75-76).

509. Mjetet e komunikimit të deklaratës janë gjithashtu kriter i rëndësishëm në vlerësimin e ndikimit potencial të ligjëritimit. Kështu, Gjykata ka vendosur se dënimi i një individi për botimin e një antologjie me poezi ishte joproporcionale, duke pasur parasysh formën e shprehjes së përdorur, e cila nënkuptonte gjuhë metaforike dhe arrinte te një audiencë të kufizuar (*Karataş k. Turqisë*, § 52; shih edhe *Polat k. Turqisë* [DhM], § 47).

510. Mjeti i komunikimit të përdorur mund të ketë rëndësi të veçantë sidomos kur shpërndahe me pamfletet e partive politike në kontekstin e fushatave zgjedhore (*Féret k. Belgjikës*, § 76), ose përmes internetit, i cili e përforcon ndikimin potencial të deklaratave. Sipas Gjykatës, deklaratat shpifëse dhe deklarata qartësisht të paligjshme, përfshirë gjuhën e urrejtjes dhe gjuhën që nxit dhunë, mund të përhapen si kurrë më parë në të gjithë botën brenda pak sekondash dhe, nganjëherë, mbeten të disponueshme në internet (*Delfi AS k. Estonisë* [DhM], § 110). Kjo do të thotë se rreziku i dëmit që materialet dhe komunikimit në internet mund të kenë të ushtrimit dhe gëzimit i të drejtave dhe lirive të njeriut është më i lartë sesa rreziku që paraqet shtypi i shkruar; prandaj, për të vlerësuar ndikimin potencial të një publikimi në internet, është thelbësore të përcaktohet rrezja e shtrirjes për të arritur te publiku (*Savva Terentyev k. Ruisë*, § 79; *Delfi AS k. Estonisë* [DhM], § 133).

511. Nga jurisprudenca e Gjykatës mund të evidentohen disa kategori diskursi, në varësi të përmbajtjes dhe ndikimit të tyre të qëllimet legjitime. Edhe pse disa kategori nuk shquhen qartë, ia vlen të përshkruhen dhe të analizohen kriteret e zbatueshme për secilën. Kategoritë në fjalë përshkruhen një nga një më poshtë.

a. Diskursi separatist dhe publikimi nga organizata të paligjshme

512. Në përgjithësi, Gjykata çmon se thelbi i demokracisë kërkon që të lejohet propozimi dhe debati mbi një shumëllojshmëri programesh politike, madje edhe ato që vënë në pikëpyetje mënyrën se si është i organizuar Shteti, me kusht që të mos dëmtojnë vetë demokracinë (*Partia Socialiste dhe Të tjerë k. Turqisë*, § 47).

513. Kur vlerëson nëse një ndërhyrje është proporcionale, Gjykata bën dallimin midis diskursit të ashtuquajtur paqësor ose demokratik separatist dhe diskursit separatist që lidhet me kryerjen e veprave penale ose veprimeve që nxisin dhunën. Gjykata ka çmuar se ndërhyrja në lirinë e shprehjes së një udhëheqësi politik të lëvizjes separatiste franceze baske ishte proporcional; masa kishte të bënte me një ndalim - të vlefshëm gjatë periudhës së lirimit me kusht - që të mos shpërndante vepra apo komente publike lidhur me shkeljet për të

cilat ishte dënuar, pasi kërkuesi ende gëzonte të drejtën të shprehte pikëpamjet e veta për çështjen baske, me kusht që të mos përmendte ato shkelje (*Bidart k. Francës*, § 42).

514. Gjykata mban parasysh kontekstin në të cilin bëhen deklaratat, sidomos kur pretendimet separatiste në një rajon të caktuar shoqërohen me konflikte të armatosura. Kështu, edhe pse konceptet e sigurisë kombëtare dhe sigurisë publike duhet të interpretohen në mënyrë kufizuese, Gjykata ka vendosur se çështjet që lidhen me konfliktin në Republikën Çeçene ishin të një natyre shumë të ndjeshme dhe për këtë arsye kërkohej vigjilencë e veçantë nga ana e autoriteteve (*Stomakhin k. Ruisë*, §§ 85-86; *Dmitriyevskiy k. Ruisë*, § 87).

515. Gjykata çmon se ndërhyrja në lirinë e shprehjes cilësohet e justifikuar kur deklaratat separatiste (sidomos në formën e parullave) duhet të ketë një ndikim në sigurinë kombëtare dhe rendin publik dhe të paraqesin rrezik të qartë dhe të afërt në lidhje me këto qëllime legjitime (*Gül dhe Të tjerë k. Turqisë*, § 42; *Kılıç dhe Eren k. Turqisë*, §§ 29-30; *Bülent Kaya k. Turqisë*, § 42).

516. Sipas Gjykatës, dënimi penal i një redaktori gazete rajonale për botimin e artikujve që supozohej se ishin shkruar nga udhëheqësit e një lëvizjeje separatiste që kërkoheshin për vepra të rënda penale nuk mund të justifikohet vetëm në bazë të profilit të autorëve të supozuar (*Dmitriyevskiy k. Ruisë*, §§ 104 dhe 114; shih, me efekt të njëjtë, *Ceylan k. Turqisë* [DhM], § 36; *Süreç dhe Özdemir k. Turqisë* [DhM], § 61; *Erdoğan dhe İnce k. Turqisë* [DhM], §§ 52 dhe 55; *Faruk Temel k. Turqisë*, §§ 62 dhe 64; *Polat k. Turqisë* [DhM], § 47).

517. Për të vlerësuar nëse publikimi i deklaratave të organizatave terroriste të shpallura të paligjshme shkakton rrezikun e provokimit publik për të kryer akte terroriste ose hakmarrje terroriste, është e nevojshme të merret parasysh jo vetëm natyra e autorit dhe e të adresuesit të mesazhit, por edhe përmbajtja e artikullit në fjalë dhe sfondi në të cilin është publikuar. Për të gjetur baraspeshën mes interesave konkurruese, autoritetet kombëtare duhet të kenë mjaft parasysh të drejtën e publikut për t'u informuar me perspektiva të ndryshme mbi një situatë konfliktit, nga këndvështrimi i njëres prej palëve në konflikt, pavarësisht sa e papëlqyeshme ajo perspektivë mund të jetë për publikun (*Gözel dhe Özer k. Turqisë*, § 56).

518. Kështu, Gjykata ka konstatuar shkelje të nenit 10 të Konventës në shumë çështje kundër Turqisë lidhur me dënimin e pronarëve, botuesve ose redaktorëve të botimeve periodike për publikimin e deklaratave ose trakteve nga organizata të klasifikuara si "terroriste" sipas të drejtës së brendshme (*Gözel dhe Özer k. Turqisë*; *Karakoyun dhe Turan k. Turqisë*; *Çapan k. Turqisë*; *İmza k. Turqisë*; *Kanat dhe Bozan k. Turqisë*; *Demirel et Ateş k. Turqisë*; *Özer k. Turqisë* (nr. 3)). Sipas Gjykatës, këto raste ndërhyrjeje patën efektin pjesërisht të censurimit të profesionistëve të medias dhe kufizimit të aftësisë së tyre për të përcjellë publikisht një opinion – me kusht që të mos mbronin drejtpërdrejtë ose tërthorazi kryerjen e akteve terroriste – që është pjesë e debatit publik (shih, sidomos, *Ali Gürbüz k. Turqisë*, § 77, *Özgür Gündem k. Turqisë*, §§ 62-64, dhe katër aktgjykimet për *Yıldız dhe Taş k. Turqisë* (nr. 1, nr. 2, nr. 3 dhe nr. 4); lidhur me dënimin e një individi për përhapjen e propagandës në favor të një organizate terroriste vetëm sepse mori pjesë në funeralin e anëtarëve të vdekur të asaj organizate, shih *Nejdet Atalay k. Turqisë*, §§ 20-23).

519. Ndryshe nga më lart, në një çështje lidhur me sekuestrimin dhe shkatërrimin nga autoritetet doganore zvicerane të një sasive të madhe materiale propagandistike të Partisë së Punëtorëve Kurdë (PKK), Gjykata vendosi se materiali i sekuestruar mbronte dhe lavdëronte dhunën dhe synonte të angazhonte sa më shumë persona për luftë të armatosur kundër autoriteteve turke, duke arritur në përfundimin se kufizimi ishte i justifikuar sipas nenit 10 § 2 (*Kaptan k. Zvicrës* (vend.)).

520. Duhet theksuar edhe se në një çështje lidhur me dënimin e një kompanie televizive për transmetimin e programeve që promovonin një organizatë terroriste, Gjykata, që konstatoi se ankesa e kompanisë kërkuese dilte jashtë fushëveprimit të nenit 10 për shkak të nenit 17, shqyrtoi përmbajtjen e programeve, prezantimin

dhe lidhjen, si dhe analizoi elementët e mëposhtëm: paraqitjen e njëanshme të ngjarjeve shoqëruar me nxitje të përsëritur për pjesëmarrje në luftime dhe veprime, nxitje për t'u bashkuar me organizatën ose luftën e armatosur, si dhe portretizimin e anëtarëve të ndjerë të organizatës si heronj. Gjithashtu, Gjykata vuri në dukje se gjykatat kombëtare kishin vërtetuar se në atë kohë kompania kërkuese financohej në një masë të konsiderueshme nga kjo organizatë (*Roj TV A/S k. Danimarkës* (vend.)).

b. Lavdërimi dhe mbrojtja e akteve kriminale dhe/ose terroriste

521. Kur Gjykata shqyrton arsyetimin/justifikimin e ndërhyrjes në diskursin që mbron terrorizmin, ajo shikon ndërhyrjen duke parë çështjen në tërësi, përfshirë përmbajtjen e deklaratave të kontestuara dhe kontekstin në të cilin bëhen (*Erdoğan dhe İnce k. Turqisë* [DhM], § 47), si edhe personalitetin dhe funksionin e personit që i bën deklaratat në fjalë (*Demirel et Ateş k. Turqisë*, § 37).

522. Në një çështje lidhur me dënimin e pronarit të një gazete javore, Gjykata vendosi që përmbajtja e artikullit ishte e aftë të nxiste dhunë të mëtejshme në rajon. Sipas pikëpamjes së Gjykatës, lexuesit i krijohej përshtypja se përdorimi i dhunës është masë e domosdoshme dhe e justifikuar e vetëmbrojtjeje përballë agresorit, dhe doli në përfundimin se ajo që ishte problematike në këtë çështje ishte nxitja e dhunës. Megjithëse kërkuesi nuk u rreshtua personalisht për krahas pikëpamjeve të paraqitura në artikull, ai prapëseprapë i kishte ofruar autoritet të artikullit mjetin për nxitjen e dhunës (*Sürek k. Turqisë (nr. 3)* [DhM], §§ 40-41).

523. Në një tjetër çështje, kërkuesi ishte një karikaturist i dënuar për bashkëpunim në mbrojtjen e terrorizmit pas botimit të një karikature dy ditë pas sulmit të 11 shtatorit 2001 ndaj kullave binjake të Qendrës Botërore të Tregtisë. Gjykata theksoi aspektin kohor dhe mungesën e masave paraprake për sa i përket gjuhës, në një kohë kur e gjithë bota ishte ende në një gjendje shoku nga lajmi i sulmit. Gjykata më tej vuri në dukje se publikimi i vizatimit solli reagime që mund të kishin nxitur dhunë dhe tregoi se mund të ketë cenuar në rendin publik në rajonin politikisht të ndjeshëm në të cilin u botua. Kështu, ajo vendosi që sanksioni i moderuar i vendosur ndaj kërkuesit ishte bazuar në shkaqe relevante dhe të mjaftueshme (*Leroy k. Francës*, §§ 45-46).

524. Sa i përket mbrojtjes publike të krimeve të luftës, Gjykata i kushton rëndësi faktit nëse deklaratat kontribuojnë në një debat me interes të përgjithshëm. Në çështjen lidhur me botimin e një libri nga një shkrimtar që kishte qenë anëtar i forcave të armatosura franceze, ku përshkruante torturat gjatë Luftës së Algerisë, Gjykata vendosi që teksti i kontestuar mbartte rëndësi të veçantë për kujtesën kolektive, duke informuar publikun jo vetëm se praktika të tilla kanë ekzistuar, por për më tepër kishin edhe pëlqimin e autoriteteve franceze (*Orban dhe Të tjerë k. Francës*, § 49).

525. Gjykata ka përsëritur se kërkimi i të vërtetës historike është pjesë e pandarë e lirisë së shprehjes dhe se duhet të ekzistojnë kushtet që debati mbi shkaqet e akteve që mund të përbëjnë krime lufte ose krime kundër njerëzimit duhet të zhvillohet lirisht (*Dmitriyevskiy k. Ruisë*, § 106).

c. Lloje të tjera deklaratash që kufizohen mbi bazën e parandalimit të prishjes së rendit dhe krimin

526. Qëllimi legjitim i parandalimit të prishjes së rendit, siç mishërohet në paragrafin e dytë të nenit 10, është evokuar nga Shtetet Anëtare edhe në kontekstin e deklaratave që kundërshtojnë shërbimin ushtarak ose advokojnë demilitarizimin (*Arrowsmith k. Mbretërisë së Bashkuar*, Raport i Komisionit; *Chorherr k. Austrisë*, § 32). Në çështjen *Ergin k. Turqisë* (nr. 6), Gjykata specifikoi që edhe pse fjalët e përdorura në artikullin fyes i jepnin ngjyrim armiqësor shërbimit ushtarak, për sa kohë që nuk nxiste përdorimin e dhunës ose rezistencë apo kryengritje të armatosur, për më tepër që artikulli nuk kishte gjuhë urrejtjeje, atëherë ndërhyrja nuk mund të justifikohet me qëllimin legjitim të parandalimit të prishjes së rendit. Gjykata vuri në dukje se artikulli

ofendues ishte botuar në një gazetë që i shitej publikut të gjerë. Artikulli nuk kërkonte, qoftë në formë apo në përmbajtje, nxitjen e dezertimit të menjëhershëm (§ 34).

527. Në një çështje tjetër, legjislacioni penal portugez ndalonte hyrjen e një anijeje në ujërat territoriale, ku shoqata kërkuese synonte të përcillte informacion dhe të zhvillonte takime që të bënte fushatë për dekriminalizimin e ndërprerjes vullnetare të shtatzënisë. Gjykata pranoi që ky ndalim ndiqte ndër të tjera qëllimin legjitim të parandalimit të prishjes së rendit (*Women On Waves dhe Të tjerë k. Portugalisë*, § 35). Megjithatë, çmoi se kjo masë radikale dështoi të kishte efekt parandalues, qoftë te shoqata kërkuese, por edhe te palët e tjera që dëshirojnë të ndajnë ide dhe informacion që bie ndesh me rendin e vendosur.

528. Po kështu, Gjykata pranoi se ndalimi i një fushate posterash për sjellje imorale të botuesve dhe referimi te një faqe interneti proslitizuese ndiqte qëllime legjitime siç është parandalimi i prishjes së rendit (*Mouvement raélien suisse k. Zvicrës* [DhM], § 54). Gjykata vuri në dukje se nuk ishin ngritur pretendime për efektivitetin e shqyrtimit gjyqësor prej gjykatave vendase, të cilat kishin dhënë arsye të hollësishme për vendimet e tyre, referuar promovimit të klonimit njerëzor, advokimit të "gjeniokracisë" dhe mundësisë që literatura dhe idetë e Lëvizjes Raeliane mund të rezultojnë në abuzim seksual të fëmijëve nga disa prej pjesëtarëve të saj.

529. Në një çështje lidhur me një postim në blog që shfaqte simbole antikushetuese (naziste), Gjykata vendosi, në dritën e kontekstit historik, se Shtetet që kanë përjetuar tmerre naziste mund të konsiderohen se kanë përgjegjësi të veçantë morale për t'u distancuar nga mizoritë masive të kryera, çka mund të justifikojë ndalimin - me qëllim parandalimin e prishjes së rendit - mbi përdorimin e atyre simboleve në të gjitha mjetet e komunikimit në mënyrë që të mos lejojë njerëzit që të mësohen me shfaqjen e tyre dhe ta perceptojnë si diçka të zakonshme (*Nix k. Gjermanisë* (vend.)).

530. Në një çështje lidhur me shkarkimin e diplomatëve të lartë sepse deklaruan publikisht se zgjedhjet presidenciale ishin të pandershme, Gjykata pranoi që ndërhyrja ndiqte qëllimet legjitime të mbrojtjes së sigurisë kombëtare dhe sigurisë publike, si dhe parandalimin e prishjes së rendit. Gjykata theksoi detyrimin e besnikërisë që duhet të respektojnë diplomatët si dhe nevojën që Shteti i paditur të jetë në gjendje të mbështetet në trupa diplomatike politikisht neutrale (*Karapetyan dhe Të tjerë k. Armenisë*, §§ 49-50).

531. Parandalimi i prishjes së rendit apo krimit është evokuar edhe për dënimin e akteve të gazetarëve në shkelje të dispozitave të brendshme të së drejtës penale, me pretendimin se kanë qenë duke bërë gazetari.¹⁷

3. Ashpërsia e dënimit

532. Në një sistem demokratik, qeveria zotëron një pozitë dominuese që i imponon vetëpërmbajtje në përdorimin e procedurave penale, veçanërisht kur ekzistojnë mjete të tjera për t'iu përgjigjur sulmeve të padrejta dhe kritikave të kundërshtarëve të saj. Sidoqoftë, autoritetet shtetërore përgjegjëse janë të lira kompetente të marrin masa qoftë edhe të natyrës penale, në cilësinë e tyre si garantues të rendit publik, që synojnë të reagojnë në mënyrë të përshtatshme dhe pa tejkalar masën e komenteve të tilla (*Incal k. Turqisë*, § 54; për shembuj të dënimeve penale në këtë fushë, shih *Arslan k. Turqisë* [DhM], §§ 49-50; *Stomakhin k. Rusisë*, §§ 128 dhe 132).

533. Në një çështje, Gjykata gjykoi se dënimi ishte proporcional me qëllimin legjitim të synuar, sidomos ngaqë kërkuesi kishte shlyer vetëm një pjesë të vogël të dënimit (*Zana k. Turqisë*, § 61).

¹⁷ Shih seksionin "Ligjshmëria e sjelljes së gazetarit" në Kapitullin V më lart.

534. Gjykata çmoi se një masë për të parandaluar publikimin e informacionit kishte qenë joproporcionale, për shkak se informacioni në fjalë ishte bërë tashmë publik (*Vereniging Weekblad Bluf! k. Vendeve të Ulëta*, §§ 44-46).

535. Në çështjet lidhur me lirinë e shtypit në veçanti, rëndësi nuk ka fakti se dënimi është i ulët, por Gjykata kërkon që të mos ketë dënim fare, sepse ka të ngjarë të frenojë gazetarët që të kontribuojnë në debatin publik për çështje që ndikojnë te jeta e komunitetit (*Dammann k. Zvicrës*, § 57). Në lidhje me këtë, Gjykata pati parasysh sidomos faktin që kërkuesi nuk ishte dënuar kurrë për një vepër të ngjashme, përndryshe, ky dënim i ashpër do të kishte qenë i pranueshëm (*Stomakhin k. Rusisë*, § 130).

536. Në një çështje lidhur me paraburgimin e një gazetari, Gjykata vuri në dukje se, edhe në rastet kur janë ngritur akuza të rënda, paraburgimi duhet të përdoret vetëm si një masë e fundit përjashtimore kur të gjitha masat e tjera kanë rezultuar joefikase për të garantuar plotësisht zhvillimin e duhur të procedurave. Gjykata theksoi se paraburgimi i kujt do që shpreh pikëpamje kritike prodhon efekte të pafavorshme, si për vetë të paraburgosurit, ashtu edhe për shoqërinë si e tërë, si dhe në mënyrë të pashmangshme ka efekt frenues te liria e shprehjes duke frikësuar shoqërinë civile dhe duke i mbyllur gojën zërave kundërshtues (*Şahin Alpay k. Turqisë*, §§ 181-182).

537. Për më tepër, kur shqyrton proporcionalitetin e ndërhyrjes, Gjykata mund t'i referohet edhe kohëzgjatjes së procedimit penal që rezulton në dënimin e autorit të deklaratave përkatëse (*Gül dhe Të tjerë k. Turqisë*, § 43).

XII. Liria e shprehjes dhe mbrojtja e shëndetit ose moralit

538. Qëllimi i ligjshëm i mbrojtjes së shëndetit ose moralit evokohet shpesh nga Shtetet Kontraktuese njëkohësisht (*Mouvement raëlien suisse k. Zvicrës* [DhM], § 54; *Bayev dhe Të tjerë k. Ruisë*, § 45). Për më tepër, mbrojtja e moralit apo shëndetit evokohet bashkë me qëllime të tjera legjitime, sidomos me të drejtat e të tjerëve (*Müller dhe Të tjerë k. Zvicrës*, § 30; *Aydın Tatlav k. Turqisë*, § 20; *Sekmadienis Ltd. k. Lituanisë*, § 69), parandalimin e krimit (*Open Door dhe Dublin Well Woman k. Irlandës*, § 61; *Mouvement raëlien suisse k. Zvicrës* [DhM], § 54)st (*Akdaş k. Turqisë*, § 23).

539. Kjo pjesë e Udhëzimit do të analizojë disa çështje ku "mbrojtja e të drejtave të tjerëve" konsiderohet si qëllim legjitim eklipsues (*Vejdeland dhe Të tjerë k. Suedisë*, § 49; *Mamère k. Francës*, § 18; *Hertel k. Zvicrës*, § 42), për sa kohë që në procedurat gjyqësore vendase dhe/ose para Gjykatës, ky qëllim legjitim është plotësuar me konsiderata lidhur me mbrojtjen e shëndetit ose moralit.

540. Gjykata rezervon të drejtën për të vlerësuar legjitimitetin e qëllimeve që pretendon Shteti i paditur për të justifikuar një ndërhyrje. Kështu, në një çështje lidhur me një ligj që ndalon promovimin e homoseksualitetit midis të miturve, Gjykata vendosi se legjislacioni në fjalë, i cili përkeqëson stigmën dhe paragjykimin dhe inkurajon homofobinë, nuk mund të justifikohet nga ndonjë prej qëllimeve legjitime të garantuara nga neni 10 § 2 i Konventës (*Bayev dhe Të tjerë k. Ruisë*, § 83). Bllokimi i informacionit për marrëdhëniet e të njëjtës gjini, që sipas Shtetit të paditur nevojitej për të ruajtur objektivat demografikë, nuk mund të justifikohet nga qëllimi legjitim i mbrojtjes së shëndetit publik (po aty, § 73).

541. Dispozitat e legjislacionit të brendshëm që lejojnë ndërhyrjen për arritjen këtyre qëllimeve të ligjshme janë shumë të ndryshme. Interesat në fjalë mbrohen nga legjislacioni civil dhe penal, si ato që disjelojnë legjislacionin për përdhosjen e varreve (*Sinkova k. Ukrainës*, § 44), publikimet e turpshme *Perrin k. Mbretërisë së Bashkuar* (vend.); *Akdaş k. Turqisë*, § 19) apo administrimin e posterave në ambiente publike (*Mouvement raëlien suisse k. Zvicrës* [DhM], § 25).

A. Parime të përgjithshme

1. Mbrojtja e shëndetit

542. Qëllimi legjitim i mbrojtjes së shëndetit është evokuar në disa lloje çështjesh që kanë të bëjnë mes të tjerash me shëndetin publik (sidomos në *Société de conception de presse et d'édition dhe Ponson k. Francës*, § 53, lidhur me kufizimin e reklamave të produkteve të duhanit), biotike (*Mouvement raëlien suisse k. Zvicrës* [DhM], § 54, lidhur me diskursin në favor të klonimit njerëzor dhe transferimit të ndërgjegjes) dhe të drejtat e pacientëve që të mos ekspozohen ndaj informacioneve mjekësore të paverifikuara (*Vérités Santé Pratique SARL k. Francës* (vend.); si edhe diskursin që nxit përdorimin e barnave (*Palusinski k. Polonisë* (vend.)).

543. Gjykata i kushton nivel të lartë mbrojtjeje lirisë së shprehjes ku deklaratat e kontestuara synojnë të diskutojnë mbi problematikat e mbrojtjes së shëndetit. Në këto raste, Gjykata karakterizon deklaratat si pjesëmarrje në debatin publik që prek interesin e përgjithshëm (*Hertel k. Zvicrës*, § 47) dhe rrjedhimisht analizon me kujdes nëse masat kanë qenë proporcionale me qëllimin e synuar.

544. Gjykata çmon se deklaratat që kritikojnë faktin se publiku nuk është informuar mjaftueshëm prej autoriteteve për një fatkeqësi natyrore dhe pasojat e saj te shëndeti publik ishte pjesë e një debati publik jashtëzakonisht të rëndësishëm (*Mamère k. Francës*, § 20; shih edhe, lidhur me një punim shkencor për efektet shëndetësore të konsumimit të ushqimeve të përgatitura në mikrovalë, *Hertel k. Zvicrës*, § 47). Gjykata doli në

përfundimin se hapësira e vlerësimit që kanë autoritetet të cilat përcaktojnë "nevojën" për masën e kontestuar është veçanërisht i ngushtë.

545. Gjatë shqyrtimit të problematikave lidhur me një debat me interes të përgjithshëm, Gjykata çmon se edhe pse mendimi i shprehur është në pakicë dhe mund të duket se nuk ka merita, do të ishte tejet e paarsyeshme që liria e shprehjes të lejohej vetëm për ide të pranuar gjerësisht (*Hertel k. Zvicrës*, § 50). Sidoqoftë, Gjykata ka specifikuar që ndërsa asgjë nuk ndalon përhapjen e informacionit që ofendon, trondit ose shqetëson në një sferë në të cilën ka pak gjasa të ekzistojë ndonjë siguri, kjo mund të bëhet vetëm me ngjyrimë/nuanca (*Vérité Santé Pratique SARL k. Francës* (vend.)).

546. Kur vlerëson nëse një ndërhyrje lidhur me mbrojtjen e shëndetit publik është proporcionale, Gjykata i kushton rëndësi të konsiderueshme ekzistencës së konsensusit evropian. Vërtet që pasi njohu ekzistencën e konsensusit evropian për nevojën e një rregullimi të rreptë të reklamave të duhanit, Gjykata vendosi që konsideratat themelore të shëndetit publik mbi të cilat ishte miratuar legjislacioni në Francë dhe Bashkimin Evropian mund të prevalojnë mbi konsideratat ekonomike madje edhe mbi disa të drejta themelore siç është liria e shprehjes (*Société de conception de presse et d'édition dhe Ponson k. Francës*, § 56).

2. Mbrojtja e moralit

547. Në jurisprudencën e Gjykatës, mbrojtja e moralit është ngritur si qëllim legjitim që justifikon ndërhyrjen në këto lloje deklaratash:

- politike, përfshirë interpretimet artistike (*Sinkova k. Ukrainës*, § 107; *Mariya Alekhina dhe Të tjerë k. Rusisë*, § 203),
- letrare (*Akdaş k. Turqisë*, § 30), filozofike ose fetare (*İ.A. k. Turqisë*, § 20; *Aydm Tatlav k. Turqisë*, § 25),
- arsimore (*Handyside k. Mbretërisë së Bashkuar*),
- ose që i ngjajnë një regjistri tregtar (*Mouvement raëlien suisse k. Zvicrës* [DhM], § 62).

548. Në përgjithësi, në çështjet lidhur me kufizimin e lirisë së shprehjes për shkak të moralit, Gjykata ka gjykuar se autoritetet kombëtare gëzojnë hapësirë të gjerë vlerësimi (*Mouvement raëlien suisse k. Zvicrës* [DhM], § 76). Sidoqoftë, gjerësia e kësaj hapësire vlerësimi ndryshon në varësi të një sërë faktorësh, ku rëndësi parësore ka lloji i deklaratave (po aty, § 61). Edhe pse Gjykata e pranon se ka pak fushëveprim sipas Konventës për të kufizuar ligjërimin politik (*Ceylan k. Turqisë* [DhM], § 34), Shtetet Kontraktuale kanë hapësirë të gjerë vlerësimi lidhur me ligjërimin për çështjet tregtare reklammat (*Sekmadienis Ltd. k. Lituanisë*, § 73; *markt intern Verlag GmbH dhe Klaus Beermann k. Gjermanisë*, § 33), lidhur me çështje që mund të cenojnë bindjet personale intime në sferën e moralit, apo sidomos të fesë (*Sekmadienis Ltd. k. Lituanisë*, § 73; *Murphy k. Irlandës*, § 67). Kjo vlen edhe për "moralin seksual" për të cilin gjykatat vendase kanë hapësirë të gjerë vlerësimi (*Müller dhe Të tjerë k. Zvicrës*, § 36).

549. Gjykata është shprehur se nuk është e mundur të gjesh në legjislacionin e brendshëm të Shteteve të ndryshme Kontraktuese një konceptim uniform evropian të moralit. Pikëpamja e marrë nga ligjet e tyre përkatëse për kërkesat e moralit ndryshon nga koha në kohë dhe nga vendi në vend dhe shpesh kërkon që brenda një Shteti të merret parasysh ekzistenca e komuniteteve të ndryshme kulturore, fetare, civile apo filozofike (*Kaos GL k. Turqisë*, § 49). Si pasojë, Gjykata vlerëson se, për shkak të kontaktit të tyre të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshëm me forcat jetike të vendeve të tyre, autoritetet shtetërore janë në parim në një pozitë më të mirë se gjykatësi ndërkombëtar për të dhënë një mendim mbi përmbajtjen e saktë të këtyre kërkesave si dhe mbi "nevojën" e një "kufizimi" ose "ndëshkimi" me synim përmbushjen e tyre (*Handyside k. Mbretërisë së Bashkuar*, § 48, *Otto-Preminger-Institut k. Austrisë*, § 56).

550. Sidoqoftë, Gjykata ka specifikuar se nuk bie dakord që diskrecioni i Shtetit në fushën e mbrojtjes së moralit të jetë i pakufizuar dhe i paankimueshëm (*Open Door dhe Dublin Well Woman k. Irlandës*, § 68). Me fjalë të tjera, në lidhje me mbrojtjen e moralit, Gjykata vlerëson se Shtetet Kontraktuese gëzojnë një hapësirë vlerësimi të caktuar, por jo të pakufizuar (shih, për shembull, *Norris k. Irlandës*, § 45). Kështu, në vlerësimin e nevojës për ndërhyrje të Shtetit në një shoqëri demokratike, Gjykata u referohet parimeve tradicionale të zhvilluara në jurisprudencën e saj, të cilat i kërkojnë asaj të përcaktojë nëse ekziston nevoja shoqërore për ndërhyrjen, nëse është proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur dhe nëse arsyet e dhëna nga autoritetet kombëtare për ta justifikuar atë janë relevante dhe të mjaftueshme (*Open Door dhe Dublin Well Woman k. Irlandës*, § 70).

551. Mbrojtja e besimit fetar, në varësi të veçorive specifike të secilit Shtet Kontraktues, mund të lindë nga qëllimi legjitim i mbrojtjes së moralit (*Sekmadienis Ltd. k. Lituaniës*, § 69). Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se fakti që nuk ka një konceptim uniform evropian të kërkesave të mbrojtjes së të drejtave të tjerëve në lidhje me sulmet ndaj bindjeve të tyre fetare, do të thotë që Shtetet Kontraktuese kanë hapësirë më të gjerë vlerësimi kur rregullojnë lirinë të shprehjes në lidhje me çështje që mund të fyejnë bindjet personale intime brenda sferës së moralit apo fesë (*Aydm Tatlav k. Turqisë*, § 24).

552. Ndryshe nga më lart, sipas Gjykatës, hapësira e vlerësimi e pranuar në këtë mënyrë - me fjalë të tjera, njohja e veçorive kulturore, historike dhe fetare të Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës - nuk mund të shtrihet aq sa të pengojë aksesin e publikut në një vepër që i përket trashëgimisë letrare evropiane një gjuhë të caktuar (*Akdaş k. Turqisë*, § 30). Në këtë çështje që lidhet me dënimin e një botuesi dhe sekuestrimin dhe shkatërrimin e të gjitha kopjeve të një romani që përmbante përshkrime të imta të skenave të marrëdhënies seksuale, me praktika të tilla si sadomazokizmi, vampirizmi dhe pedofilia, Gjykata theksoi se edhe pse u pranonte Shteteve një hapësirë të caktuar vlerësimi në këtë fushë, në këtë rast specifik nuk mund të nënvlerësojë faktin se kishte kaluar më shumë se një shekull nga botimi fillestar i librit në Francë, nga botimi i tij në gjuhë të ndryshme në shumë shtete, apo vlerësimin e tij përmes botimit në prestigjiozen *La Pléiade* rreth dhjetë vjet para sekuestrimit të tij në Turqi (*Akdaş k. Turqisë*, §§ 28-29).

553. Së fundmi, Gjykata vlerëson se neni 10 nuk ndalon në vetvete çdo ndërhyrje paraprake në shprehjen e fjalës apo publikimin e deklaratave të shkruara, siç vjen qartë nga termat e Konventës: "kushte", "kufizime", "parandalim" (*Kaos GL k. Turqisë*, § 50). Sidoqoftë, lajmi është një mall në zhdukje dhe të vonosh publikimin e tij, qoftë edhe për një periudhë të shkurtër, mund ta zhveshë nga e gjithë vlera dhe interesi (*Ahmet Yıldırım k. Turqisë*, § 47), gjë që ka shtyrë Gjykatën të arrijë në përfundimin se rreziqet e qenësishme që mbart kufizimi paraprak janë të tilla që kërkojnë shqyrtim sa më të kujdesshëm (*Kaos GL k. Turqisë*, § 50).

B. Kriteret e vlerësimi lidhur me justifikimin e një ndërhyrjeje

1. Natyra, përmbajtja dhe ndikimi potencial i deklaratave

a. Natyra dhe përmbajtja e deklaratave

554. Kriteri i parë për të analizuar nëse një ndërhyrje në lirinë e shprehjes është proporcionale, pavarësisht qëllimit legjitim të ndjekur, është përcaktimi i shkallës në të cilën deklaratat e kontestuara mund të kontribuojnë në një debat me interes të përgjithshëm. Në përgjithësi, deklaratat që kontribuojnë në një debat me interes të përgjithshëm kanë efektin e zvogëlimit të hapësirës së vlerësimi të Shtetit. Sipas Gjykatës, thjesht fakti se deklaratat nuk pranohen nga shumica e publikut nuk i bën ato automatikisht me përmbajtje imorale (*Alekseyev k. Rusisë*, § 81).

555. Sa për deklaratat për fenë, Gjykata çmon se është e nevojshme të përcaktohet nëse komentet kanë ton fyes dhe u drejtohen drejtpërdrejt personit të besimtarëve, apo janë sulm ndaj simboleve të shenjta. Kështu, ata që

zgjedhin të ushtrojnë lirinë për të shfaqur fenë e tyre nuk mund të kenë pritshmërinë e arsyeshme që të jenë të përjashtuar nga çdo kritikë, dhe duhet të tolerojnë dhe të pranojnë mohimin nga të tjerët të besimit të tyre fetar, madje edhe përhapjen nga të tjerët të doktrinave armiqësore ndaj besimit të tyre (*Otto-Preminger-Institut k. Austrisë*, § 47).

556. Midis detyrimeve dhe përgjegjësive të përmendura në nenin 10 § 2 të Konventës, Gjykata, në kontekstin e besimeve fetare, i referohet kërkesës së përgjithshme për të siguruar gëzim paqësor të të drejtave të garantuara sipas nenit 9 për mbajtësit e besimeve të tilla, duke përfshirë detyrimin për të shmangur sa më shumë të jetë e mundur shprehjet që janë haptazi fyese ndaj të tjerëve dhe blasfemike për sa u përket objekteve të adhurimit (*Sekmadienis Ltd. k. Lituanisë*, § 74; *Giniewski k. Francës*, § 43; *Murphy k. Irlandës*, § 65). Gjykata është shprehur se në parim, autoritetet vendase mund ta konsiderojnë ligjërisht të nevojshme ndëshkimin e sulmeve të pahijshme ndaj objekteve të adhurimit fetar (*I.A. k. Turqisë*, § 24). Gjykata çmon se paraqitja e objekteve të adhurimit fetar në një mënyrë provokuese që arrin të cenojë ndjenjat e ndjekësve të asaj feje mund të konceptohet si shkelje keqdashëse e frymës së tolerancës, e cila është një nga bazat e një shoqërie demokratike (*E.S. k. Austrisë*, § 53). Për ilustrim, Gjykata ka vendosur se dënimi i një folësi që akuzonte Profetin e Islamit për pedofili, me arsyetimin se ato sulme abuzive arrinin të nxisnin paragjykime dhe të vinin në rrezik paqen fetare, nuk përbënte shkelje të nenit 10 të Konventës (po aty, §§ 57-58).

557. Ndryshe nga më lart, kur shqyrtoi deklaratat e bëra nga një kërkues në një libër ku shpaloste "perspektivën kritike të një jobesimtari në lidhje me fenë në sferën socio-politike", Gjykata nuk perceptoi një ton fyes për komentet drejtuar drejtpërdrejt besimtarëve, apo një sulm abuziv ndaj simboleve të shenjta, veçanërisht ndaj myslimanëve, edhe pse mund të ndiheshin të ofenduar gjatë leximit të librit për shkak të komenteve kaustike lidhur me fenë e tyre. Gjykata doli në përfundimin se ndërhyrja ishte joproporcionale (*Aydm Tatlav k. Turqisë*, §§ 26-31; për një shembull diskursi proselitizues, shih *Kutlular k. Turqisë*, § 48).

558. Në një çështje lidhur me një gjobë të vendosur ndaj një kompanie për reklama veshjesh që përshkruanin figura fetare, Gjykata konstatoi se reklamat nuk dukej se ishin domosdo fyese, profane apo nxisnin urrejtjen mbi bazat e besimit fetar, apo sulm i padrejtë i një feje në mënyrë të papërshtatshme apo abuzive (*Sekmadienis Ltd. k. Lituanisë*, § 77).

559. Gjykata shqyrton edhe format e ndryshme të shprehjes që zgjedh autori i deklaratave, duke pasur parasysh ndikimin e tyre te morali apo shëndeti publik. Ky parim është i zbatueshëm kur kërkuesi ka pasur mundësi të tjera që do të preknin më pak mbrojtjen e këtyre qëllimeve legjitime, veçanërisht kur, për shembull, një mënyrë e veçantë e shprehjes shkel ligjin penal dhe fyen kujtimin e ushtarëve të rënë në luftë (*Sinkova k. Ukrainës*, § 110).

560. Në fund, Gjykata vlerëson se, edhe gjatë një diskutimi të ndezur, nuk është në përputhje me nenin 10 të Konventës që deklaratat inkriminuese të 'paketohen' si shprehje e pranueshme opinionit dhe të deduktohet se kjo bën që deklaratat të jenë brenda kufijve të lirisë së shprehjes (*E.S. k. Austrisë*, § 55).

b. Ndikimi i deklaratave: mjetet e përhapjes dhe audienca e synuar

561. Për vlerësimin e justifikimit të ndërhyrjes që ndjek qëllimet legjitime të mbrojtjes së moralit ose shëndetit publik, cenueshmëria e pjesëtarëve të publikut që kanë akses në tekstin e kontestuar është një kriter i rëndësishëm për matjen e ndikimit potencial të materialit në shoqëri. Në çështjen *Handyside k. Mbretërisë së Bashkuar*, libri i kontestuar synohej posaçërisht për nxënësit e shkollave të moshës 12-18 vjeç. Gjykata vendosi që, pavarësisht larmisë dhe evoluimit të vazhdueshëm në Mbretërinë e Bashkuar të pikëpamjeve mbi etikën dhe arsimin, gjyqtarët kompetentë anglezë kishin të drejtë, gjatë ushtrimit të diskrecionit të tyre, që të gjykonin

në atë periudhë se libri shkollor do të kishte efekte të dëmshme në moralin e shumë prej fëmijëve dhe adoleshentëve që do ta lexonin (52 §).

562. Pothuaj në të njëjtën mënyrë, në një çështje ku kërkuesit u dënuan sepse kishin lënë fletushka homofobe në dollapët e nxënësve të arsimit dytësor, Gjykata çmoi se pavarësisht pranueshmërisë së qëllimit të kërkuesve - pra, që të fillonin një debat mbi mungesën e objektivitetit të arsimit në shkollat suedeze - i duhej kushtuar vëmendje formulimit të fletushkave. Fletushkat e përshkruanin homoseksualitetin si "prirje seksuale devijante" që kishte "efekt moralisht shkatërrues" te shoqëria dhe ishte përgjegjës për përhapjen e HIV dhe AIDS. Gjykata vuri në dukje sidomos se nxënësit ishin në një moshë të ndikueshme dhe të ndjeshme (*Vejdeland dhe Të tjerë k. Suedisë*, § 56).

563. Kjo vlen edhe kur deklaratat janë të disponueshme lirshëm, domethënë, nuk i drejtohen posaçërisht një grupi të cënueshëm, por që nuk janë të përshtatshme për të gjitha segmentet e publikut (*Kaos GL k. Turqisë*, §§ 61 dhe 63). Kështu, sipas Gjykatës, një revistë paraqiste një pikturë që tregon marrëdhëniet seksuale mes dy burrave nuk ishte e përshtatshme për të gjitha pjesët e publikut dhe mund të konsiderohet se shkel ndjeshmërinë e pjesëve të paspecializuara të publikut (po aty, §§ 59- 60). Gjykata pranoi që sekuestrimi i të gjitha kopjeve të pajtimtarëve të numrit të revistë përbën ndërhyrje joproporcionale, ndërsa specifikoi që një masë e tillë mund të kishte marrë, për shembull, formën e ndalimit të shitjes së saj personave nën 18 vjeç, ose të kishte paketim të veçantë me një paralajmërim për të miturit, apo edhe tërheqjen e botimit nga kioskat e gazetave (po aty, §§ 61 dhe 63; shih për një përjasje të ngjashme lidhur me një ekspozitë publike të veprave artistike që tregojnë marrëdhëniet seksuale, veçanërisht mes burrave dhe kafshëve, *Müller dhe Të tjerë k. Zvicrës*, § 36).

564. Ky arsyetim zbatohet edhe për mbrojtjen e shëndetit. Gjykata çmoi se, meqë lexuesit e revistës ishin kryesisht të rinjtë, të cilët janë më të cënueshëm, duhej pasur parasysh ndikimi i mesazheve të ky grup. Për pasojë, Gjykata vendosi në një çështje se fakti që publikimet fyese konsiderohen si të afta që të nxisin njerëzit dhe sidomos të rinjtë për të konsumuar produkte duhani, ishte arsye relevante dhe e mjaftueshme për të justifikuar ndërhyrjen (*Société de conception de presse et d'édition dhe Ponson k. Francës*, §§ 58-60).

565. Përkundrazi, fakti që mesazhet ishin të aksesueshme nga një publik veçanërisht i cënueshëm, siç janë fëmijët, nuk ishte i mjaftueshëm për të justifikuar ndërhyrjen e Shtetit, me kusht që mesazhet të mos jenë agresive, seksualisht të qarta apo të advokojnë një sjellje të caktuar seksuale, si dhe që të miturit të ekspozohen para ideve të diversitetit, barazisë dhe tolerancës (*Bayev dhe Të tjerë k. Rusisë*, § 82).

2. Ashpërsia e dënimit apo masës

566. Proporcionaliteti i ndërhyrjes duhet të vlerësohet në dritën e objektit të kufizimit apo ndalimit të deklaratave në fjalë. Gjykata ka theksuar se autoritetet, kur vendosin të kufizojnë të drejtat themelore, duhet të zgjedhin mjetet që shkaktojnë cenimin sa më të vogël të mundshëm të së drejtës në fjalë (*Women On Waves dhe Të tjerë k. Portugalisë*, § 41).

567. Gjykata vendosi që kufizimi i vazhdueshëm mbi sigurimin e informacionit grave shtatzëna në lidhje me klinikat e abortit jashtë vendit, pavarësisht nga mosha ose gjendja shëndetësore ose arsyet e tyre për të kërkuar këshillim për ndërprerje të shtatzënisë, ishte tejet e gjerë dhe joproporcionale me qëllimet e ndjekura (*Open Door dhe Dublin Well Woman k. Irlandës*, §§ 73-80).

568. Po kështu, Gjykata konstatoi se sekuestrimi nga autoritetet vendase të të gjitha kopjeve të një reviste ishte joproporcionale, sepse kishin në dorë alternativa të tjera adekuate (*Kaos GL k. Turqisë*, §§ 61 dhe 63; për një gjobë që u gjykua proporcionale, shih edhe, *E.S. k. Austrisë*, § 56).

569. Gjykata çmon se në parim, format e shprehjes që janë paqësore dhe jo të dhunshme nuk duhet të bëhen objekt i kërcënimit nga dënime me privim të lirisë (*Murat Vural k. Turqisë*, § 66). Për sa u përket deklaratave politike, edhe pse dënimi penal është në diskrecionin e gjykatave vendase, dënimi me burg për një shkelje në fushën e ligjërimit politik do të jetë në pajtim me lirinë e shprehjes siç garantohet nga neni 10 i Konventës vetëm në raste përjashtimore ku janë cenuar rëndë të drejta të tjera themelore, si për shembull në çështjen për gjuhë urretjeje (*Otegi Mondragon k. Spanjës*, § 59). Ky parim nuk vlen për rastet ku materiali i kontestuar ka tërësisht natyrë tregtare dhe nuk synon të kontribuojë në një debat mbi një çështje të interesit publik (*Perrin k. Mbretërisë së Bashkuar* (vend.)).

570. Në një çështje për dënimin pas një demonstrate lidhur me një përkujtimore lufte, Gjykata shqyrtoi se sa nga dënimi me burg ishte shlyer, duke vërejtur se dënimi ishte pezulluar (*Sinkova k. Ukrainës*, § 111).

571. Po kjo situatë ishte edhe në një çështje ku dënimi me dy vjet burg ishte zbutur në një gjobë "të papërfillshme" (*İ.A. k. Turqisë*, § 32).

572. Në një çështje lidhur me një dënim për publikimin e materialeve tejet të pahijshme në një faqe falas në internet, Gjykata vuri në dukje se megjithëse kërkuesi ishte dënuar me 30 muaj burgim, ai mund të kërkonte lirim me kusht pas 15 muajsh. Gjykata vendosi se ishte e arsyeshme për autoritetet vendase të gjykonin se një ndëshkim thjesht financiar nuk përbënte dënim të mjaftueshëm apo parandalues (*Perrin k. Mbretërisë së Bashkuar* (vend.)).

573. Në çështje të tjera, pavarësisht nëse sanksioni është i vogël, rëndësi ka thjesht fakti i dënimit të personit në fjalë, edhe kur dënimi është i natyrës civile (*Société de conception de presse et d'édition k. Francës*, § 49). Gjithashtu, në kontekstin e një profesioni të lirë dhe gamës së sanksioneve të ndryshme, Gjykata çmoi se vendosja e gjobës nuk ishte ndëshkim disiplinor i papërfillshëm (*Stambuk k. Gjermanisë*, § 51).

574. Për më tepër, gjatë vlerësimit të proporcionalitetit të një gjobe ose kompensimit të dëmit, është e nevojshme të merret parasysh situata individuale e personit përgjegjës për deklaratat e kontestuara dhe veçanërisht aftësia e tij për të paguar shumat në fjalë. Në një çështje ku botuesit e materialeve fyese ishin urdhëruar të paguanin shumat "të konsiderueshme" si gjobë dhe si dëmshpërblim, Gjykata vendosi që ashpërsia e dënimit duhet të baraspeshohet përkundër të ardhurave që nxjerr një revistë me tirazh të lartë (*Société de conception de presse et d'édition dhe Ponson k. Francës*, § 62).

575. Sipas Gjykatës, shqyrtimi nëse kufizimi apo sanksioni është i justifikuar, duhet të shihet edhe në dritën e ndikimit që ka te liria e shprehjes së autorit të materialit në fjalë. Kështu, Gjykata çmoi se ndërsa nxjerrja jashtë ligjit e shoqatës apo e faqes së saj të internetit mund të ishte joproporcionale, kufizimi thjesht në ekspozimin e posterave në ambiente publike ishte një mënyrë për të garantuar dëmtimin minimal të të drejtave të shoqatës kërkuese (*Mouvement raëlien suisse k. Zvicrës* [DhM], § 75).

XIII. Liria e shprehjes dhe Interneti

A. Veçoritë specifike të Internetit në kontekstin e lirisë së shprehjes

1. Natyra novatore e Internetit

576. Gjykata ka vërejtur në disa raste se interneti ofron një platformë të pashembullt për ushtrimin e lirisë së shprehjes, përmes komenteve të gjeneruara prej përdoruesve (*Delfi AS k. Estonisë* [DhM], § 110; *Cengiz dhe Të tjerë k. Turqisë*, § 52), duke çmuar se nisur nga aksesueshmëria dhe kapaciteti për të ruajtur dhe për të përcjellë sasi të mëdha informacioni, interneti luan rol të rëndësishëm në rritjen e aksesit të publikut te lajmet si dhe në lehtësimin e përhapjes së informacionit në përgjithësi (*Delfi AS k. Estonisë* [DhM], § 133; *Times Newspapers Ltd k. Mbretërisë së Bashkuar (nr. 1 dhe nr. 2)*, § 27).

577. Prandaj, Gjykata vlerëson se bllokimi i hyrjes në internet mund të jetë në kundërshtim të drejtpërdrejtë me formulimin aktual të paragrafit 1 të nenit 10 të Konventës, sipas të cilit të drejtat e përcaktuara në atë nen garantohen "pa marrë parasysh kufijtë" (*Ahmet Yıldırım k. Turqisë*, § 67).

578. Gjithashtu, Gjykata vëren se gjithnjë e më shumë shërbime dhe informacione ofrohen vetëm përmes internetit (*Jankovskis k. Lituanisë*, § 49; *Kalda k. Estonisë*, § 52) dhe se materialet politike që shpërfillen nga media tradicionale shpesh shpërndahen përmes internetit (në këtë rast, në YouTube), duke nxitur kështu shfaqjen e gazetarisë qytetare (*Cengiz dhe Të tjerë k. Turqisë*, § 52).

579. Në lidhje me qëllimin material të nenit 10 të Konventës, Gjykata ka theksuar që kjo dispozitë duhet të zbatohet për komunikimet në internet pavarësisht llojit të mesazhit që transmetohet, edhe kur qëllimi ka natyrë fitimprurëse (*Ashby Donald dhe Të tjerë k. Francës*, § 34).

580. Gjykata çmon se ushtrimi i të drejtës së lirisë së shprehjes gjen zbatim veçanërisht në sferat më poshtë:

- mirëmbajtja e arkivave të internetit, për sa kohë përbën një aspekt vendimtar të rolit që luajnë faqet e internetit (*Times Newspapers Ltd k. Mbretërisë së Bashkuar (nr. 1 dhe nr. 2)*, § 27; *M.L. dhe W.W. k. Gjermanisë; Węgrzynowski dhe Smolczewski k. Polonisë*);
- publikimi i fotove në faqe interneti të specializuara në modë dhe ofrimi i fotove dhe videove të shfaqjeve të modës falas ose me pagesë (*Ashby Donald dhe Të tjerë k. Francës*, § 34);
- fakti që një parti politike ofroi një aplikacion celulari që u mundësonte votuesve të tregonin foto anonime të fletës së pavlefshme të votimit dhe komente për arsyt pse e bëjnë votën e tyre të pavlefshme (*Magyar Kétfarkú Kutya Párt k. Hungarisë* [DhM], § 91);
- përdorimi i faqeve të caktuara të internetit që mundësojnë qarkullim të informacionit, sidomos YouTube, faqet e videohostimit ku përdoruesit mund të ngarkojnë, të shohin dhe të qarkullojnë video (*Cengiz dhe Të tjerë k. Turqisë*, § 52), dhe Google Sites, shërbim ky i Google i ideuar për të lehtësuar krijimin dhe qarkullimin e faqeve të internetit brenda një grupi (*Ahmet Yıldırım k. Turqisë*, § 49).

581. Gjykata ka theksuar se, nisur nga roli që interneti luan në kontekstin e aktiviteteve profesionale mediatike dhe rëndësia e tij për ushtrimin e të drejtës së lirisë së shprehjes në përgjithësi, mungesa e një kuadri ligjor adekuat në nivel kombëtar që lejon gazetarët të përdorin informacionin e marrë prej internetit pa frikën e sanksioneve, pengon rëndë ushtrimin e funksionit jetik të shtypit si "rojtari publik". Sipas Gjykatës, përjashtimi i plotë i një informacioni të tillë nga fushëveprimi i garancive normative për lirinë e gazetareve, mund të rezultojë në ndërhyrje të pajustificuar në lirinë e shtypit sipas nenit 10 të Konventës (*Redaksia e Pravoye Delo dhe Shtekel k. Ukrainës*, § 64; *Magyar Jeti Zrt k. Hungarisë*, § 60).

2. Interneti dhe mediat e tjera

582. Ndërsa njih përfitimet e internetit, Gjykata pranon edhe se ato shoqërohen me disa rreziqe, pasi deklarata qartësisht të paligjshme, përfshirë gjuhën e urrejtjes dhe gjuhën që nxit dhunë, mund të përhapen si kurrë më parë në të gjithë botën brenda pak sekondash dhe, nganjëherë, mbeten të disponueshme në internet (*Delfi AS k. Estonisë* [DhM], § 110; *Annen k. Gjermanisë*, § 67).

583. Konkretisht, Gjykata pranon që interneti është një mjet informacioni dhe komunikimi veçanërisht i ndryshëm nga media e shkruar, sidomos për aftësinë që ka për ruajtje dhe përcjelle informacioni. Gjykata ka pranuar se rrjeti elektronik, i cili u shërben miliarda përdoruesve në mbarë botën, nuk i nënshtrohet dhe ndoshta nuk do t'i nënshtrohet kurrë të njëjtit kontroll dhe rregullim, dhe se politikat që dispijlojnë riprodhimin e materialeve nga media e shkruar dhe interneti mund të ndryshojnë. Rregullat që dispijlojnë internetit duhet patjetër të përshtaten sipas veçorive specifike të teknologjisë, në mënyrë që të garantojnë mbrojtje dhe promovim të të drejtave dhe lirive në fjalë (*Redaksia e Pravoye Delo dhe Shtekel k. Ukrainës*, § 63).

584. Po kështu, Gjykata ka vërejtur se edhe pse interneti dhe media sociale mbeten mjete të fuqishme komunikimi, alternativat e qenësishme të internetit dhe medias sociale bëjnë që informacioni që përcjellin të mos ketë të njëjtin sinkronizim apo ndikim si informacioni i transmetuar (*Animal Defenders International k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], § 119) dhe se një intervistë me celular që transmetohet në një program në internet ka ndikim të drejtpërdrejtë më të vogël të shikuesit sesa një program televiziv (*Schweizerische Radio- und Fernsehgesellschaft SRG k. Zvicrës*, § 64).

B. Mbrojtja e të drejtave të tjerëve në kontekstin e Internetit

1. Komente të përgjithshme

585. Aspektet specifike të ushtrimit të lirisë së shprehjes në kontekstin e internetit kanë bërë që Gjykata të shqyrtojë baraspeshën e drejtë mes lirisë së shprehjes dhe të drejtave e kërkesave të tjera. Në këtë drejtim, Gjykata vlerëson se rreziku i dëmit që materialet dhe komunikimet në internet mund të shkaktojnë në ushtrimin dhe gëzimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, sidomos të drejtën e respektimit të jetës private, është sigurisht më i lartë sesa rreziku që paraqet shtypi. (*Delfi AS k. Estonisë* [DhM], § 133; *Redaksia e Pravoye Delo dhe Shtekel k. Ukrainës*, § 63; *Węgrzynowski dhe Smolczewski k. Polonisë*, § 98).

Kështu, teksa nga njëra anë njih përfitimet e rëndësishme për ushtrimin e lirisë së shprehjes që rrjedhin nga interneti, përgjegjësia për gjuhën shpifëse apo gjuhë të tjera të paligjshme duhet parimisht të ruhet dhe të përballet me mjete efektive për shkeljen e të drejtave të personalitetit (*Delfi AS k. Estonisë* [DhM], § 110).

586. Për të vlerësuar mbi ashpërsinë e një sulmi mbi reputacionin personal dhe nëse hyn në fushëveprimin e nenit 8, duhen pasur parasysh veçoritë specifike të internetit (*Arnarson k. Islandës*, § 37).

587. Ndikimi i efektit të forcuar të Internetit duket shumë qartë në çështjen e një individi që ishte objekt i akuzave për antisemitizëm; akuzat u botuan në faqen e internetit të një shoqate e cila ishte urdhëruar ta hiqte artikullin në fjalë. Gjykata nënvizoi sidomos se akuzat për antisemitizëm kanë ndikim potencial të konsiderueshëm dhe nuk kufizojnë vetëm te lexuesit besnikë të buletinit ku u publikua, sepse përshkrimi i tekstit si antisemit ishte i dukshëm për një numër të madh njerëzish. Mjaftonte të shkruhej emri i individit në një motor kërkimi dhe menjëherë shfaqej artikulli i kontestuar. Prandaj, publikimi në faqen e shoqatës së

kërkuesit pati ndikim të konsiderueshëm në reputacionin dhe të drejtat e individit në fjalë (*Cicad k. Zvicrës*, § 60).

588. Lidhur me hapësirën e vlerësimit që gëzojnë Shtetet Anëtare, Gjykata ka njohur ekzistencën e hapësirës më të gjerë në një çështje për një dënim për shpifje, duke nënvizuar se mosmarrëveshja ishte vetëm mes individëve privatë dhe faktin që deklaratat e pretenduara si shpifëse u bënë në një kontekst gjysmë-publik, konkretisht në një forum të sigurt interneti (*Wrona k. Polonisë* (vend.) [komiteti], § 21; shih edhe *Kucharczyk k. Polonisë* (vend.) [komiteti], lidhur me baraspeshimin e të drejtës së avokatit për respektimin e të drejtës private dhe të drejtën e lirisë së shprehjes së një individi që kishte postuar një koment kritik në një portal privat interneti).

589. Parimet përgjithshme që zbatohen për publikimet *offline*, vlejné edhe për ato *online*:

- Gjykata vlerëson se kur informacioni privat ose personal publikohet në internet, si emri apo përshkrimi i një personi, nevoja për të ruajtur konfidencialitetin nuk përbën kriter prevalues, pasi këto të dhëna kanë reshtur së qeni konfidenciale dhe janë në lëmin publik. Në raste të tilla, parësore është mbrojtja e jetës familjare dhe reputacionit dhe ato duhet të mbrohen (*Aleksey Ovchinnikov k. Rusisë*, §§ 49-50);
- Gjykata e vlerësoi të tepërt dënimin penal të një *webmasteri* për fyerje publike ndaj një kryetari bashkie lidhur me komentet në faqen e internetit të një shoqate të kryesuar prej tij, duke theksuar në veçanti se komentet ishin bërë nga organi përfaqësues i një shoqate, e cila po përcillte pretendimet e anëtarëve të vet për një temë me interes të përgjithshëm në kontekstin e kundërshtimit të një politike bashkiake (*Renaud k. Francës*, § 40);
- po kështu, Gjykata konstatoi shkelje të Konventës për dënimin e një OJF-ve sepse kishte etiketuar gjuhën e një politikani si "racizëm verbal" (*GRA Stiftung gegen Rassismus und Antisemitismus k. Zvicrës*);
- ndryshe nga më lart, edhe pse mbrojtja e kafshëve dhe mjedisit është padyshim në interesin publik, Gjykata e çmoi proporcional urdhri gjyqësor që e ndalonte një shoqatë për të drejtat e kafshëve që të publikonte në internet një poster fushate ku shfaqeshin foto të burgosurve në kampe përqendrimi përkrah fotove të kafshëve të rritura në kushte blegtorie intensive (*PETA Deutschland k. Gjermanisë*);
- gjithashtu, cilido qoftë mjeti i komunikimit të përdorur, deklaratat që nxisin urrejtjen dhe diskriminimin racial nuk gëzojnë mbrojtjen e akorduar nga neni 10 § 2; Gjykata ka vendosur se dënimi i pronarit të një faqe interneti - që ishte edhe politikan - për përhapjen e komente ksenofobe, korrespondonte me nevojën e ngushtë shoqërore për të mbrojtur të drejtat e komunitetit të emigrantëve (*Féret k. Belgjikës*, § 78; shih edhe *Willem k. Francës*, për dënimin e një përfaqësuesi të zgjedhur për komente që nxisnin diskriminimin, të cilat u përsëritën në faqen e internetit të bashkisë);
- po kështu, publikimi *online* i sulmeve personale që shkojnë përtej betejës legjitime të ideve, nuk mbrohet nga neni 10 § 2 (*Tierbefreier e.V. k. Gjermanisë*, § 56).

590. Në çështjen *Tamiz k. Mbretërisë së Bashkuar* (vend.), kërkuesi, një politikan, u ankua se i ishte dhunuar reputacioni për shkak të refuzimit të gjykatave vendase për të pranuar përgjegjësinë e *Google* për komente që ai i konsideroi si shpifëse, të publikuara në platformën *Google Blogger*. Gjykatat vendase kishin vendosur që nuk përmbushej kushti i shkeljes "reale dhe thelbësore", që kërkonte që gjyqi për shpifje të zhvillohej jashtë juridiksionit të Shtetit. Gjykata theksoi rëndësinë e këtij testi të juridiksionit dhe specifikoi që, në fakt, miliona përdorues të Internetit postojné çdo ditë komente *online* dhe shumë nga këta përdorues shprehen në mënyra që mund të cilësohen fyese ose madje shpifëse. Gjykata pranoi konkluzionet e gjykatave vendase për faktin se

shumica e komenteve për të cilat ankohej kërkuesi ishin padyshim fyese, por shumica ishin diçka më shumë se "abuzim vulgar" që është i zakonshëm në komunikim në plot portale Internet portale, të cilat pritet të tolerohen nga ankuesi si politikan që është. Për më tepër, shumë nga komentet ishin akuza më specifike në një kontest të shkruari që e bënte të kollajhtë për lexuesin të mendojë se janë sajesa që nuk duhen marrë seriozisht (§ 81).

2. Mbrojtja e personave të cenueshëm

591. Mbrojtja e personave të cenueshëm, sidomos për shkak të moshës së re, mund të ketë implikime të shumta për ushtrimin e lirisë së shprehjes në Internet.

592. Kështu, Gjykata gjeti të papranueshme një kërkesë lidhur me një dënim për botimin e dokumenteve të pahijshme në një faqe interneti falas, duke nënvizuar se materiali ishte pikërisht i atij lloji që kërkohet nga të rinjtë të cilët autoritetet vendase përpiqen t'i mbrojnë (*Perrin k. Mbretërisë së Bashkuar* (vend.)).

593. Gjithashtu, në një çështje me natyrë seksuale, Gjykata konstatoi se përmendja e vazhdueshme nga shtypi i identitetit të një të mituri të përfshirë në një incident të dhunshëm i kishte dëmtuar zhvillimin moral dhe psikologjik, si edhe jetën private. Për këtë arsye, Gjykata çmoi se përgjegjësia civile që i ishte ngarkuar gazetarit që shkroi artikullin ishte e justifikuar, edhe pse këto të dhëna personale ishin bërë pjesë e lëmit publik meqë gjendeshin tashmë në Internet (*Aleksey Ovchinnikov k. Ruisë*, §§ 51-52).

594. Sipas Gjykatës, përballë rrezikut të pedofilisë në Internet, nuk mund të justifikohet forcimi i mbrojtjes së konfidencialitetit duke penguar një hetim efektiv me qëllim marrjen nga një ofruer Interneti të identitetit të personit që kishte postuar një reklamë me natyrë seksuale drejtuar një të mituri. Kështu, Gjykata e gjeti të papajtueshme me nenin 8 të Konventës faktin që ofruesi i internetit nuk ishte detyruar të zbulonte identitetin e personit të kërkuar për postimin e reklamës së pahijshme rreth një të mituri në një faqe Interneti njohjesh, duke nënvizuar në këtë kontekst kërcënimin potencial ndaj mirëqenies fizike dhe mendore që i kanosej kërkuesit dhe cenueshmërisë që i krijohet për shkak të moshës së re (*K.U. k. Finlandës*, § 41), teksa theksoi se Interneti mund të përdoret për qëllime kriminale pikërisht sepse ka natyrë anonime (po aty, § 48).

3. "Detyrimet dhe përgjegjësitë" e portaleve të lajmeve

595. Për shkak të natyrës së veçantë të Internetit, "detyrimet dhe përgjegjësitë" që mund t'i ngarkohen një portali lajmesh lidhur me materialet e palëve të treta për qëllimet e nenit 10 mund të ndryshojnë në njëfarë mase nga ato për një botues tradicional (*Delfi AS k. Estonisë* [DhM], § 113; shih edhe *Orlovskaya Iskra k. Ruisë*, § 109), ofrimi i një forumi për ushtrimin e lirisë së shprehjes, duke i mundësuar publikut që të ndajë informacion dhe ide, duhet të vlerësohet në dritën e parimeve të zbatueshme për shtypin (*Magyar Tartalomszolgáltatók Egyesülete dhe Index.hu Zrt k. Hungarisë*, § 61).

596. Gjatë vlerësimit nëse një portal duhet të heqë komentet e postuara nga një palë e tretë, Gjykata ka evidentuar katër kritere për të gjetur baraspeshën e duhur mes të drejtës së lirisë së shprehjes dhe të drejtës së reputacionit të personit apo subjektit që është objekt i komenteve (*Magyar Tartalomszolgáltatók Egyesülete dhe Index.hu Zrt k. Hungarisë*, §§ 60 e vijues; *Delfi AS k. Estonisë* [DhM], §§ 142 e vijues), konkretisht:

1. konteksti dhe përmbajtja e komenteve;
2. përgjegjësia e autorëve të komenteve;
3. masat e marra nga kërkuesit dhe sjellja e palës së dëmtuar;
4. pasojat për palën e dëmtuar dhe për kërkuesit.

597. Mbi bazën e këtyre kritereve, Gjykata e gjeti të justifikuar sipas nenit 10 të Konventës faktin që një portal lajmesh u urdhërua të paguante dëmshpërblim për komente anonime fyese të postuara në faqen e saj, nisur nga natyra ekstreme e komenteve që arritën deri në gjuhë urrejtje apo nxitje të dhunës (*Delfi AS k. Estonisë* [DhM]).

598. Ndryshe nga më sipër, Gjykata konstatoi se komentet e përdoruesit nuk paraqisnin gjuhë urrejtjeje dhe as ndonjë kërcënim të drejtpërdrejtë ndaj integritetit fizik, prandaj e gjeti të papajtueshëm me nenin 10 të Konventës përgjegjësinë objektive që iu ngarkohet portaleve për komentet e palëve të treta, duke argumentuar se nuk ka arsye të pretendohet – kur ekzistojnë procedura efektive për përgjigje të shpejtë – se sistemi i njoftimit dhe heqjes së komenteve nuk kishte funksionuar si mjet adekuat për mbrojtjen e reputacionit tregtar të faqeve të administrimit të pasurive të paluajtshme që ishin përfshirë në çështje (*Magyar Tartalomszolgáltatók Egyesülete dhe Index.hu Zrt k. Hungarisë*, § 91; shih edhe, lidhur me rëndësinë e reagimit të shpejtë pas njoftimit për përmbajtje të paligjshme, *Pihl k. Suedisë*, § 32; *Tamiz k. Mbretërisë së Bashkuar* (vend.), § 84; *Høiness k. Norvegjisë*, §§ 73-74).

4. Përgjegjësia që lind nga publikimi i një hiperlinku

599. Në çështjen *Magyar Jeti Zrt k. Hungarisë*, shoqëria kërkuese u shpall fajtoresh për futjen e një hiperlinku gjatë një interviste në YouTube që më pas u konstatua se kishte përmbajtje shpifëse.

Duke pasur parasysh rolin e Internetit në rritjen e aksesit të publikut në lajme dhe informacion, Gjykata nënvizon se vetë qëllimi i hiperlinkeve është që, duke drejtuar përdoruesit në faqe dhe burime të tjera në internet, t'u mundësojë atyre lundrim drejt/nga materialeve në një rrjet që karakterizohet nga një sasi e jashtëzakonshme informacioni. Hiperlinket kontribuojnë në funksionimin normal të Internetit duke i bërë informacionin më të aksesueshëm përmes lidhjes me njëri-tjetrin (*Magyar Jeti Zrt k. Hungarisë*, § 73).

600. Hiperlinket, si teknikë raportimi, janë në thelb të ndryshëm nga aktet tradicionale të publikimit, sepse, si rregull i përgjithshëm, thjesht drejtojnë përdoruesit në materiale që gjenden gjetkë në Internet. Ato nuk paraqesin deklaratat e audienca dhe as nuk përcjellin përmbajtje, por thjesht shërbejnë për të tërhequr vëmendjen e lexuesve të prania e një materiali në një tjetër faqe interneti (*Magyar Jeti Zrt k. Hungarisë*, § 74).

601. Një tjetër karakteristikë dalluese e hiperlinkeve krahasuar me aktet e shpërndarjes së informacionit është se personi që përcjell hiperlinkun nuk ushtron kontroll mbi përmbajtjen/informacionin e faqes që hapet prej hiperlinkut, i cili edhe mund të jetë ndryshuar pas krijimit të linkut. Për më tepër, përmbajtja e dyshuar si e paligjshme që hapej përmes hiperlinkut ishte postuar tashmë nga botuesi fillestar në faqen e vet të Internetit, duke ofruar kështu akses të pakufizuar të publikut (*Magyar Jeti Zrt k. Hungarisë*, § 75).

602. Gjykata çmon se gjykimi nëse postimi i një hiperlinku përbën shpërndarje të deklaratave shpifëse kërkon që gjykatat vendase të shqyrtojnë rast pas rasti dhe të gjejnë krijuesin e hiperlinkut që duhet të japë llogari vetëm mbi baza relevante dhe të mjaftueshme.

Në këtë drejtim, në çështjen nën shqyrtim, Gjykata parashtroi disa pyetje relevante që gjykatat vendase nuk kishin shtuar kur shpallën fajtoresh kompaninë kërkuese: (i) a e kishte miratuar kompania kërkuese përmbajtjen e kontestuar; (ii) a e kishte përsëritur përmbajtjen e kontestuar (pa e miratuar); (iii) e kishte vënë thjesht një hiperlink në përmbajtjen e kontestuar (pa e miratuar apo përsëritur atë); (iv) a e dinte dhe a ishte e arsyeshme që ta dinte se përmbajtja e kontestuar ishte shpifëse ose e paligjshme në një tjetër mënyrë; (v) a

kishte vepruar në mirëbesim, duke respektuar etikën e gazetarisë dhe vigjilencën e duhur të pritshme gazetarinë e përgjegjshme? (*Magyar Jeti Zrt k. Hungarisë*, § 77).

603. Në rrethanat e çështjes *Magyar Jeti Zrt k. Hungarisë*, Gjykata vuri në dukje se, në të drejtën e brendshme, hiperlinket përbënin përhapje të informacionit dhe përgjegjësi objektive për personin që e fut, çka mund të ketë pasoja negative të rrjedha e informacionit në internet, duke frenuar autorët e artikujve dhe botuesit që të vendosin hiperlinke në materiale që mund të ndërronin përmbajtjen dhe mbi të cilët nuk kishin kontroll. Kjo mund të ketë drejtpërdrejtë ose tërthorazi efekt frenues të liria e shprehjes në Internet (§§ 83-84).

5. "Detyrimet, përgjegjësitë" dhe publikimet e shtypit në Internet

604. Në lidhje me ofrimin e informacionit të besueshëm dhe të saktë në përputhje me etikën e gazetarisë, Gjykata ka shprehur parimin se shtypi ka përgjegjësi të shtuar kur publikon në internet, duke nënvizuar se në një botë ku individit përballlet me sasi të mëdha informacioni që qarkullojnë përmes mediave tradicionale dhe elektronike dhe ku numri i aktorëve rritet vazhdimisht, monitorimi i pajtueshmërisë me etikën gazetareske merr rëndësi të shtuar (*Stoll k. Zvicrës* [DhM], § 104). Në shqyrtimin e "detyrimeve dhe përgjegjësisë" të një gazetari, ndikimi potencial i mediumit në fjalë është një faktor i rëndësishëm dhe metodat e raportimit objektiv dhe të baraspeshuar mund të ndryshojnë shumë, në varësi edhe të medias në fjalë (*Delfi AS k. Estonisë* [DhM], § 134).

605. Po kështu, detyrimi i shtypit që të veprojë në pajtim me parimet e gazetarisë së përgjegjshme duke garantuar saktësi të informacionit historik më shumë sesa të informacionit të zhdukshëm, informacioni i publikuar ka gjasa të jetë më e theksuar në rastet kur nuk ka ndonjë urgjencë në publikimin e materialit (*Times Newspapers Ltd k. Mbretërisë së Bashkuar* (nr. 1 dhe nr. 2), § 45).

606. Kështu, sipas Gjykatës, kur një gazetë merr dijeni se është depozituar padi ndaj të njëjtit artikull të publikuar në shtypin e shkruar, kërkesa për të publikuar një përgënjeshtim të përshtatshëm të artikullit që gjendet në arkivin e internetit nuk përbën ndërhyrje joproporcionale në të drejtën e lirisë së shprehjes (*Times Newspapers Ltd k. Mbretërisë së Bashkuar* (nr. 1 dhe nr. 2), § 47).

607. Ndryshe nga më lart, gazetaria e përgjegjshme nuk detyron shtypin të heqë nga arkiva e tyre e internetit të gjitha gjurmët e publikimeve që janë shpallur në të kaluarën si shpifëse sipas një vendimi gjyqësor të formës së prerë (*Węgrzynowski dhe Smolczewski k. Polonisë*, §§ 60-68, për pajtueshmërinë e ruajtjes në arkivin online të gazetës të një artikulli shtypi që është shpallur shpifës me vendim gjyqësor, sipas nenit 8; shih edhe, për nevojën e anonimizimit të materialit online lidhur me një gjyq dhe dënimin penal, *M.L. dhe W.W. k. Gjermanisë*).

608. Po kështu, redaktori i një faqe interneti nuk mund të konsiderohet përgjegjës për publikimin e akuzave për abuzim seksual të fëmijëve ndaj një kandidati në zgjedhje, meqë ishte siguruar që artikulli në fjalë ishte shkruar në përputhje me detyrimet gazetareske për verifikimin e akuzave (*Ólafsson k. Islandës*). Në fund, "detyrimet dhe përgjegjësitë" e gazetarëve nuk i detyrojnë aspak të njoftojnë paraprakisht subjektin e një raportimi për qëllimin e tyre për ta publikuar, në mënyrë që subjekti të ketë mundësinë të kërkojë vendim të ndërmjetëm me qëllim parandalimin e publikimit (*Mosley k. Mbretërisë së Bashkuar*, §§ 125-129).

609. Është e rëndësishme të theksohet se detyrimet dhe përgjegjësitë e gazetarëve në ushtrimin e lirisë së tyre të shprehjes zbatohen edhe kur publikojnë informacion në internet me emrin e tyre, duke përfshirë faqe të tjera nga ato të gazetës së tyre - specifikisht, në një forum interneti që aksesohet lirisht (shih, për këtë qëllim, *Fatullayev k. Azerbajxhanit*, §§ 94-95).

C. Bllokimi i aksesit në internet

610. Masat e autoriteteve kombëtare që bllokojnë hyrjen në faqet e caktuara të Internetit u gjetën nga Gjykata në mjaft raste në pajtim me nenin 10 të Konventës. Në thelb, kërkuesit u ankuan për efektet anësore të masës bllokuese.

611. Në lidhje me bllokimin e faqes së videohostimit YouTube, Gjykata vuri në dukje se kërkuesit, megjithëse ishin thjesht përdorues të cilët nuk prekeshin drejtpërdrejtë nga vendimi për të bllokuar hyrjen në YouTube, mund të ngrinin pretendimin legjitim se masa e kontestuar kishte prekur të drejtën e tyre për të marrë dhe për të dhënë informacion ose ide, sepse ishin përdorues aktivë të YouTube dhe se kjo platformë ishte unike për shkak të karakteristikave, aksesueshmërisë dhe, mbi të gjitha, ndikimit të saj potencial, aq më tepër që kërkuesit nuk kishin asnjë alternativë tjetër (*Cengiz dhe Të tjerë k. Turqisë*, §§ 52, 53, 55; shih edhe *Ahmet Yıldırım k. Turqisë*, §§ 49 dhe 55, për faktin se është e pamundur për një individ që të aksesojë faqen e vet të internetit që hostohet në *Google Sites*).

612. Ndryshe nga më lart, Gjykata çmoi se thjesht fakti që kërkuesi – ashtu si përdoruesit e tjerë turq të faqeve në internet - ishte prekur tërthorazi nga një masë bllokimi ndaj dy faqeve të internetit që përmbajnë muzikë, nuk mjafton që ai të konsiderohej si një "viktimë" (*Akdeniz k. Turqisë* (vend.), § 24).

613. Në lidhje me faktin nëse masa e bllokimit ishte e justifikuar, Gjykata vendosi që edhe kufizime të tilla paraprake nuk ishin parimisht të papajtueshme me Konventën, ato duhet të jenë pjesë të një kuadri ligjor veçanërisht të rreptë që siguron jo vetëm kontroll të fortë mbi objektin e ndalimit, por edhe shqyrtim gjyqësor efektiv për të parandaluar abuzimet. Rishikimi gjyqësor i një mase të tillë, bazuar në peshimin e interesave konkurruese me qëllim që të gjendet një baraspeshë mes tyre, është i pakonceptueshëm pa një kuadër me rregulla të sakta dhe specifike për zbatimin e kufizimeve parandaluese ndaj lirisë së shprehjes (*Ahmet Yıldırım k. Turqisë*, § 64; *Cengiz dhe Të tjerë k. Turqisë*, § 62, lidhur me lirinë për të marrë dhe për të dhënë informacion dhe ide).

614. Gjykata ka theksuar, në veçanti, nevojën për të peshuar interesat e ndryshëm në fjalë, duke vlerësuar sidomos nevojën për të bllokuar të gjithë aksesin në faqe interneti të caktuara (*Ahmet Yıldırım k. Turqisë*, § 66) dhe nënvizoi se autoritetet duhet të kishin marrë parasysh, mes të tjerash, faktin se një masë e tillë që bën të paarrtshme një masë të madhe informacioni patjetër që kufizon ndjeshëm të drejtat e përdoruesve të internetit dhe ka efekte anësore të konsiderueshme (po aty; *Cengiz dhe Të tjerë k. Turqisë*, § 64).

615. Në çështjen *Kablis k. Rusisë*, Gjykata vlerësoi nëse kufizimi mbi postimet *online* që nxisnin pjesëmarrjen në një event publik të paautorizuar ishin në pajtim me nenin 10 të Konventës. Ajo vendosi që para se të zhvillohej eventi, duhej të mundësohej shqyrtim gjyqësor i masës bllokuese. Informacioni në postime zhvishej nga çdo vlerë dhe interes pas asaj date, dhe anulimi i masës bllokuese nga gjykata do të ishte i pakuptimtë (§ 96). Po kështu, edhe në çështjen *Elvira Dmitriyeva k. Rusisë*, Gjykata vendosi se thjesht fakti që kërkuesit kishin shkelur një ndalim ligjor duke publikuar një thirrje online për pjesëmarrje në një event publik të mbajtur në shkelje të procedurës, nuk mjafton në vetvete për të justifikuar ndërhyrjen në lirinë e tyre të shprehjes (përkatësisht §§ 103 dhe 84).

D. Aksesi në Internet dhe personat e privuar nga liria

616. Gjykata ka pasur rast të vendosë mbi moslejimin e aksesit në internet për të burgosurit që të shihnin informacionet e publikuara në faqe të ndryshme që ishin lirisht të arritshme në lëmin publik. Ky refuzim bazohej në mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve dhe në parandalimit e prishjes së rendit dhe krimit.

617. Ndërsa theksonte se neni 10 nuk vendos detyrim të përgjithshëm për të ofruar akses në internet ose në faqe të veçanta të internetit për të burgosurit (*Jankovskis k. Lituanië*, § 55; *Kalda k. Estonisë*, § 45), Gjykata disponoi se kishte pasur ndërhyrje të ushtrimin e të drejtës së kërkuesve për të marrë informacion dhe konstatoi shkelje të nenit 10. Me këtë vendimmarrje, Gjykata e bazoi këtë përfundim sidomos te natyra dhe origjina e informacionit përkatës dhe te dështimi i autoriteteve kombëtare për të kryejë një analizë mjaftueshëm të thelluar mbi situatën individuale të të burgosurve, duke nënvizuar se kërkuesit i duhej aksesi në internet për të mbrojtur të drejtat e veta në kontekstin e procedurave gjyqësore vendase (*Kalda k. Estonisë*, § 50) dhe se nuk ishte e paarsyeshme të thuhet se informacioni në fjalë ishte drejtpërdrejt i rëndësishëm për interesin e kërkuesit për edukim, i cili, nga ana tjetër, është i rëndësishëm për rehabilitimin dhe riintegrimin e tij në shoqëri pas lirimit (*Jankovskis k. Lituanië*, § 59).

XIV. Pluralizmi dhe liria e shprehjes

618. Gjykata çmon se nuk mund të ketë demokraci pa pluralizëm (*Centro Europa 7 S.r.l. dhe Di Stefano k. Italisë* [DhM], § 129). Një nga karakteristikat kryesore të demokracisë është mundësi që ofron për zgjidhjen e problemeve të një shteti përmes dialogut, pa përdorur dhunë (*Manole dhe Të tjerë k. Moldavisë*, § 95). Sipas Gjykatës, edhe në një gjendje të jashtëzakonshme e cila është një regjim juridik që synon të rikthejë regjimin normal duke garantuar të drejtat themelore, Shtetet Kontraktuese duhet të mbajnë parasysh se çdo masë e marrë duhet të synojë mbrojtjen e rendit publik nga kërcënimet dhe se duhet bërë çdo përpjekje për të mbrojtur vlerat e shoqërisë demokratike, si pluralizmi, toleranca dhe mendjehapësia (*Şahin Alpay k. Turqisë*, § 180).

619. Demokracia lulëzon nga liria e shprehjes. Është thelbësore për demokracinë që të lejohen propozimet dhe debatet për programe politike të larmishme, edhe për ato që vënë në diskutim mënyrën se si është organizuar Shteti, me kusht që të mos dëmtojnë demokracinë në vetvete (*Centro Europa 7 S.r.l. dhe Di Stefano k. Italisë* [DhM], § 129; *Manole dhe Të tjerë k. Moldavisë*, § 95; *Partia Socialiste dhe Të tjerë k. Turqisë*, §§ 41, 45 dhe 47).

620. Për shkak të rëndësisë së vlerave sipas nenit 10, Shteti është garanti parësor i pluralizmit (*Animal Defenders International k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], § 101; *Manole dhe Të tjerë k. Moldavisë*, § 99; *Informationsverein Lentia dhe Të tjerë k. Austrisë*, § 38).

621. Gjykata vlerëson se në fushën e transmetimeve audiovizive, parimet e mësipërme i vendosin si detyrim Shtetit të garantojë, së pari, që publiku të ketë akses me anë të televizionit dhe radios në informacion të paanshëm dhe të saktë si dhe në një sërë opinionesh dhe komentesh që reflektojnë, ndër të tjera, diversitetin e pikëpamjeve politike brenda vendit dhe, së dyti, që gazetarët dhe profesionistët e tjerë që punojnë në mediat audiovizive të mos pengohen në dhënien e këtyre informacioneve dhe komenteve (*Manole dhe Të tjerë k. Moldavisë*, § 100).

622. Pluralizmi si vlerë e qenësishme e demokracisë theksohet në jurisprudencën e Gjykatës për nenin 10 të Konventës në disa fusha, veçanërisht në ato të paraqitura më poshtë.

A. Parimet e përgjithshme për pluralizmin në median audiovizive

623. Liria e shprehjes e mishëruar në pikën 1 të nenit 10 përbën një nga themelet e shoqërisë demokratike dhe një nga kushtet bazë për progresin e saj (*Lingens k. Austrisë*, § 41). Liria e shtypit dhe mediave të lajmeve i japin publikut një nga mjetet më të mira për zbulimin dhe formimin e opinionit mbi idetë dhe sjelljet e udhëheqësve politikë. Është detyrë e shtypit që të japë informacione dhe ide mbi çështjet politike dhe tema të tjera në interes të publikut. Jo vetëm që shtypi ka detyrën të japë informacion dhe ide të tilla, por edhe publiku ka të drejtën t'i marrë ato (shih, për shembull, *Handyside k. Mbretërisë së Bashkuar*, § 49, dhe *Lingens k. Austrisë*, §§ 41-42).

624. Media audiovizive si radio dhe televizioni, kanë një rol veçanërisht të rëndësishëm në këtë aspekt. Për shkak të kompetencave të tyre për të përcjellë mesazhe përmes zërit dhe imazheve, këto media kanë efekt më të menjëhershëm dhe më të fuqishëm sesa shtypi (*Animal Defenders International k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM]; § 119; *Pedersen dhe Baadsgaard k. Danimarkës* [DhM], § 79; *Jersild k. Danimarkës*, § 31). Funkcioni i televizionit dhe radios si burime të njohura argëtimi në intimitetin familjar të dëgjuesit ose shikuesit e përforcon më tej ndikimin e tyre (*Manole dhe Të tjerë k. Moldavisë*, § 97; *Murphy k. Irlandës*, § 74). Për më tepër, sidomos në rajone të veçuara, televizioni dhe radio janë të aksesueshëm më lehtë se mediat e tjera (*Manole dhe Të tjerë k. Moldavisë*, § 97).

625. Gjykata çmon se respektimi i parimit të pluralizmit në fushën e transmetimeve audiovizive nënkupton edhe detyrimin e Shtetit që të garantojë, së pari, aksesin e publikut në informacion të paanshëm dhe të saktë

me anë të televizionit dhe radios, si dhe në një sërë opinionesh dhe komentesh që pasqyrojnë edhe diversitetin e pikëpamjeve politike brenda vendit (*Manole dhe Të tjerë k. Moldavisë*, § 20). Mjetet që zgjidhen për arritjen e këtyre qëllimeve duhet të ndryshojnë sipas kushteve vendore, prandaj ato bëjnë pjesë në hapësirën e vlerësimit të Shtetit.

626. Kur një Shtet vendos të krijojë një sistem transmetimi publik, nga parimet e përshkruara më sipër rezultojnë se ligji dhe praktika e brendshme duhet të garantojnë që ky sistem të ofrojë shërbim pluralist. Për funksionimin e duhur të demokracisë, veçanërisht kur stacionet private janë ende shumë të dobëta për të ofruar alternativë të mirëfilltë dhe ku struktura publike ose shtetërore është transmetuesi i vetëm ose mbizotërues në vend ose rajon, është e domosdoshme që ai të transmetojë lajme, informacion dhe komente të paanshme, të pavarura dhe të balancuara dhe, krahas kësaj, të ofrojë një forum për diskutim publik në të cilin të shprehet një spektër sa më i gjerë pikëpamjesh dhe mendimesh (*Manole dhe Të tjerë k. Moldavisë*, § 101).

627. Në çështjen *Manole dhe Të tjerë k. Moldavisë*, kërkuesit kishin qenë të gjithë gazetarë, redaktorë ose producentë; ata u ankuan për kufizime në lirinë e shprehjes dhe për garanci të pamjaftueshme ligjore në lidhje me pavarësinë e shërbimit të transmetimit publik, i cili gëzonte pothuaj monopolin në vend. Gjykata përsëriti në këtë çështje se, në varësi të kushteve të përcaktuara në nenin 10 § 2, gazetarët kanë të drejtën e dhënies së informacionit. Mbrojtja e nenit 10 shtrihet te gazetarë të punësuar dhe punonjës të tjerë të medias. Një gazetar i punësuar mund të pretendojë se preket drejtpërdrejtë nga një rregull ose politikë e përgjithshme e zbatuar nga punëdhënësi i vet, që i kufizon lirinë gazetareske. Një sanksion ose masë tjetër marrë nga punëdhënësi ndaj një gazetari të punësuar mund të përbëjë ndërhyrje në lirinë e shprehjes (§§ 103 dhe 111; shih edhe *Fuentes Bobo k. Spanjës*, § 38).

628. Në një çështje lidhur me shkarkimin disiplinor të një gazetareje nga një radio publike, Gjykata pati parasysh parimet e përgjithshme lidhur me pluralizmin në mediat audiovizive dhe të drejtën e transmetuesve publikë për të vendosur politikën e tyre editoriale në përputhje me interesin publik, si dhe me përgjegjësinë e tyre për deklaratat e bëra në transmetim. Gjykata konstatoi se tagri i kërkueses si gazetare nuk i jep automatikisht të drejtën të ndjekë, pa kontroll - një politikë që bie ndesh me politikën e hartuar nga punëmarrësi i saj, gjë që përbënte shpërfillje të vendimeve legjitime editoriale të marra nga drejtuesit (*Nejkova-Lalova k. Bullgarisë*, §§ 59-60).

B. Pluralizmi i medias dhe zgjedhjet

629. Zgjedhjet e lira dhe liria e shprehjes, dhe sidomos liria e debatit politik, formojnë themelet e çdo demokracie. Të dy të drejtat janë të ndërlidhura dhe veprojnë në përfundim të njëra-tjetrës. Është veçanërisht e rëndësishme që, gjatë periudhës parazgjedhore, opinionet dhe informacionet e të gjitha llojeve të lejohen të qarkullojnë lirisht (*Orlovskaya Iskra k. Rusisë*, § 110; *Cheltsova k. Rusisë*, § 96; *Długotłęcki k. Polonisë*, § 40; *Bowman k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], § 42). Ky parim zbatohet si për zgjedhjet e përgjithshme, ashtu edhe për ato vendore (*Cheltsova k. Rusisë*, § 96; *Kwieceń k. Polonisë*, § 48).

630. Si pasojë, roli i rojtarit të shtypit nuk është më pak i rëndësishëm në periudhën zgjedhore. Sipas Gjykatës, ky rol përfshin ushtrimin e pavarur të lirisë së shtypit bazuar në zgjedhjen e lirë editoriale që synon dhënien e informacioneve dhe ideve mbi tema me interes publik. Në veçanti, debatet e kandidatëve dhe programeve të tyre kontribuojnë në të drejtën e publikut për të marrë informacione dhe forcon aftësinë e votuesve për të bërë zgjedhje të informuara midis kandidatëve garues (*Orlovskaya Iskra k. Rusisë*, § 130).

631. Gjykata ka përsëritur se një debat politik për çështje me interes të përgjithshëm është fushë në të cilën kufizimet e lirisë së shprehjes duhet të interpretohen ngushtë (*Lopes Gomes da Silva k. Portugalisë*, § 33).

632. Në kontekstin e debateve zgjedhore, Gjykata i ka atribuuar rëndësi të veçantë ushtrimit të papenguar të lirisë së fjalës së kandidatëve (*Kudeshkina k. Ruisë*, § 87).

633. Referuar *travaux préparatoires* për nenin 3 të Protokollit nr.1, Gjykata thekson se fraza "kushtet të cilat garantojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit në zgjedhjen e organit ligjvënës" nënkupton në thelb, krahas lirisë së shprehjes (mbrojtur tashmë me nenin 10 të Konventës), parimin e barazisë në trajtimin e të gjithë shtetasve në ushtrimin e të drejtës së tyre për të votuar si dhe të drejtën për të kandiduar në zgjedhje (*Mathieu-Mohin dhe Clerfayt k. Belgjikës*, § 54).

634. Në rrethana të caktuara, të dy të drejtat mund të kundërshtojnë njëra-tjetrën dhe mund të vlerësohet e nevojshme që, në periudhën para ose pas zgjedhjeve, për lirinë e shprehjes të vendosen kufizime të caktuara të një lloji që zakonisht nuk do të ishin të pranueshme, në mënyrë që të garantohet "shprehja e lirë e mendimit të popullit në zgjedhjen e organit ligjvënës". Gjykata pranon se, për arritjen e baraspeshës midis këtyre dy të drejtave, Shtetet Kontraktuese kanë hapësirë vlerësimi njësoj si në organizimin e sistemeve të tyre zgjedhore (*Animal Defenders International k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], § 123; *Oran k. Turqisë*, § 52; *Bowman k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], § 43).

C. Aktet normative për reklamat me pagesë

635. Gjykata pranon se grupe të fuqishme financiare mund të kenë avantazhe konkurruese në fushën e reklamave tregtare dhe mund të ushtrojnë presion dhe rrjedhimisht të kufizojnë lirinë e stacioneve radiotelevizive që transmetojnë reklama. Ajo vlerëson se situata të tilla minojnë rolin themelor të lirisë së shprehjes në një shoqëri demokratike sikurse mishëron nga neni 10 i Konventës (*VgT Verein gegen Tierfabriken k. Zvicrës*, § 73).

636. Gjykata çmon se blerja e kohës së transmetimit për reklama priret të ketë objektiv dukshëm të anshëm, që anon në favor të përdorimit të pabalancuar nga grupe me burime më të mëdha se të tjerët (*Murphy k. Irlandës*, § 74). Pluralizmi mediatik rrezikohet sidomos në fushën e reklamave, ku reklamat e kontestuara janë të natyrës politike (*Animal Defenders International k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM]) ose fetare (*Murphy k. Irlandës*).

637. Gjykata thekson mungesën e konsensusit evropian për mënyrën si rregullohet transmetimi i reklamave politike me pagesë (*Animal Defenders International k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], § 123). Kjo zgjeron hapësirën e vlerësimit që i akordohet Shtetit, e cila është zakonisht e ngushtë, lidhur me kufizimet në shprehjen e interesit publik (po aty, § 123; *TV Vest AS & Rogaland Pensjonistparti k. Norvegjisë*, § 67; *Société de conception de presse et d'édition dhe Ponson k. Francës*, §§ 57 dhe 63). Në çështjen *Animal Defenders International k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], Gjykata vuri në dukje se interesat që duhen peshuar në lidhje me reklamat politike janë, nga njëra anë, e drejta e OJF-së kërkuese për të dhënë informacion dhe ide me interes të përgjithshëm të cilat publiku ka të drejtë t'i marrë dhe, nga ana tjetër, dëshira e autoriteteve për të mbrojtur debatin dhe procesin demokratik nga shtrembërimi që mund t'i bëjnë grupe të fuqishme financiare që kanë akse më të madh te mediat me influencë. Ajo pranon që grupe të tilla mund të përftojnë avantazhe konkurruese në fushën e reklamave me pagesë dhe rrjedhimisht të kufizojnë debatin e lirë dhe pluralist për të cilin Shteti është garanti kryesor (§ 112).

638. Mbrojtja e pluralizmit mediatik në fushën e reklamave politike është veçanërisht e fortë në rastet ku partive të mëdha u jepet kohë e konsiderueshme transmetimi, ndëkohë që partitë e vogla mezi përmenden. Në situata të tilla, Gjykata ka disponuar se reklamat me pagesë në televizion janë e vetmja mënyrë për një parti të vogël që të përcjellë mesazhin te publiku përmes atij mjete komunikimi, megjithëse kjo ndalohej me ligj (*TV Vest AS & Rogaland Pensjonistparti k. Norvegjisë*, § 73). Aksesin në mediat alternative është faktor kyç gjatë vlerësimit të proporcionalitetit të një kufizimi në aksesin në media të tjera potencialisht të dobishme siç janë

debatet në radio ose televizion, median e shkruar dhe median sociale (*Animal Defenders International k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], § 124).

639. Gjykata gjithashtu mbron pluralizmin mediatik në kontekstin e reklamave fetare, për arsye të ruajtjes së objektivit për promovimin e neutralitetit në transmetim dhe për garantimin e një fushë veprimi të barabartë për të gjitha fetë (*Murphy k. Irlandës*, § 78). Në lidhje me këtë, ajo pranon se një dispozitë që lejon një fe dhe jo një tjetër të reklamojë do të ishte e vështirë të justifikohet dhe se një dispozitë që lejon që Shteti apo ndonjë organ i caktuar nga ai të filtrojë në rast pas rasti reklamave fetare të papranueshme ose të tepruara do të ishte e vështirë të zbatohet në mënyrë të drejtë, objektive dhe koherente (po aty, § 77). Gjithsesi, ishte logjike që një Shtet të konsideronte të mundur se edhe liria e kufizuar në reklamim do të kishte përfitime më shumë për një fe dominuese sesa ato fe me shumë më pak besimtarë dhe burime (po aty, § 78).

D. Shpërndarja e burimeve audiovizive

640. Në përputhje me fjalinë e tretë të nenit 10 § 1, Shtetet mund ta rregullojnë mënyrën e organizimit të transmetimit në territoret e tyre, veçanërisht në aspekte teknike, me anë të një sistemi licencimi (*Centro Europa 7 S.r.l. dhe Di Stefano k. Italisë* [DhM], § 139). Pajisja me licencë mund të kushtëzohet nga aspekte si natyra dhe objektivat e kanalit të propozuar, audienca e tij e mundshme në nivelin kombëtar, rajonal ose vendor, të drejtat dhe nevojat e audiencës specifike dhe detyrimet që rrjedhin nga instrumentet ligjore ndërkombëtare (*Demuth k. Zvicrës*, § 33; *Centro Europa 7 S.r.l. dhe Di Stefano k. Italisë* [DhM], § 139).

641. Teksa kjo mund të çojë në ndërhyrje me qëllime legjitime në përputhje me fjalinë e tretë të nenit 10 § 1, edhe pse nuk korrespondojnë me asnjë nga qëllimet e përcaktuara në paragrafin 2, pajtueshmëria e tyre me Konventën duhet të vlerësohet nga pikëpamja e kërkesave të tjera të paragrafit 2 (*Demuth k. Zvicrës*, § 33; *Tele 1 Privatfernsehgesellschaft mbH k. Austrisë*, § 25; *Informationsverein Lentia dhe Të tjerë k. Austrisë*, § 32).

642. Gjykata ka disponuar në mjaft çështje se mosdhënia e licencës së transmetimit (shih, ndër shumë shembuj të tjerë, *Informationsverein Lentia dhe Të tjerë k. Austrisë*, § 27; *Radio ABC k. Austrisë*, § 27; *United Christian Broadcasters Ltd k. Mbretërisë së Bashkuar* (vend.); *Glas Nadezhda EOOD dhe Elenkov k. Bullgarisë*, § 42) apo e autorizimit të transmetimit të një programi televiziv (*Leveque k. Francës* (vend.); *Demuth k. Zvicrës*, § 30), përbën ndërhyrje me ushtrimin e të drejtave të garantuara nga neni 10 § 1 i Konventës.

643. Gjykata vlerëson se, si rezultat i progresit teknik gjatë dekadave të fundit, këto kufizime nuk mund të justifikohen më sot me numrin e frekuencave dhe kanaleve në dispozicion; mbi të gjitha, nuk mund të argumentohet se nuk ka alternativa më pak kufizuese me të njëjtin efekt (*Informationsverein Lentia dhe Të tjerë k. Austrisë*, § 39).

644. Sa i takon hapësirës së vlerësimit akorduar Shteteve, Gjykata e konsideron thelbësore në një fushë aq dinamike sa transmetimet tregtare ku, për pasojë, standardet e shqyrtimit mund të jenë më pak rigorozet (*Demuth k. Zvicrës*, § 42; *Markt intern Verlag GmbH dhe Klaus Beermann k. Gjermanisë*, § 33).

645. Në përcaktimin e shtrirjes së hapësirës së vlerësimit në dispozicion të autoriteteve kombëtare, është e nevojshme të merret parasysh edhe struktura politike e një Shteti anëtar dhe pluralizmi i tij kulturor dhe gjuhësor, kryesisht kur këta faktorë - që nxisin në veçanti pluralizmin në transmetim - i nënshtrohen vlerësimit legjitimit gjatë autorizimit të transmetimeve radiotelevizive (*Demuth k. Zvicrës*, § 44).

646. Për më tepër, parimi i paanshmërisë dhe garancive procedurale zbatohet edhe në rastin e refuzimit të dhënies së licencës së transmetimit bazuar në shkaqe të sigurisë kombëtare, ku duhet të jepen edhe arsyet e këtij refuzimi (*Aydoğan dhe Dara Radyo Televizyon Yayınçılık Anonim Şirketi k. Turqisë*, § 43).

E. Transparenca lidhur me pronësinë e medias

647. Gjykata është shprehur se për garantimin e pluralizmit të vërtetë në sektorin audioviziv të një shoqërie demokratike, nuk mjafton të sigurohet ekzistenca e disa kanaleve ose mundësia teorike që operatorë potencialë të futen në tregun audioviziv. Duhet të ketë akses efektiv në treg për ofruesit, në mënyrë që të garantohet diversiteti i përmbajtjes së përgjithshme programatike, duke pasqyruar sa më shumë opinionet e ndryshme në shoqëri (*Centro Europa 7 S.r.l. dhe Di Stefano k. Italisë* [DhM], § 130).

648. Situata ku një grup i fuqishëm ekonomik ose politik në shoqëri lejohet të përftojë pozitë dominuese në mediat audiovizive dhe në këtë mënyrë të ushtrojë presion mbi transmetuesit, çka kufizon lirinë e tyre editoriale, minon rolin themelor të lirisë së shprehjes në një shoqëri demokratike siç mishërohet në nenin 10 të Konventës, veçanërisht kur pengon dhënien e informacioneve dhe ideve me interesat të përgjithshëm të cilat publiku ka të drejtë t'i marrë (*Manole dhe Të tjerë k. Moldavisë*, § 98).

649. Gjykata ka vërejtur se në një sektor kaq të ndjeshëm sa media audiovizive, Shteti, krahas detyrimit negative për mosndërrhyrje, ka edhe detyrimin pozitiv që të miratojë një kuadër të përshtatshëm normativ dhe administrativ që të garantojë pluralizëm efektiv (*Centro Europa 7 S.r.l. dhe Di Stefano k. Italisë* [DhM], § 134).

650. Gjykata është shprehur se detyrimi pozitiv për të miratuar një kuadër të përshtatshëm normativ dhe administrativ për garantimin e pluralizmit efektiv është veçanërisht i dëshirueshëm kur sistemi kombëtar audioviziv karakterizohet nga një duopol (*Centro Europa 7 S.r.l. dhe Di Stefano k. Italisë* [DhM], § 134) dhe, aq më tepër, nga një monopol. Për këtë situatë të fundit, Gjykata ka çmuar se, për shkak të natyrës kufizuese, një regjim licencimi që i lejon transmetuesit publik monopolin mbi frekuencat e disponueshme nuk mund të justifikohet, përveç se kur demonstron se ekziston një nevojë e ngutshme për të (*Manole dhe Të tjerë k. Moldavisë*, § 98; *Informationsverein Lentia dhe Të tjerë k. Austrisë*, § 39).

651. Në jurisprudencën e saj për Rekomandimin KM/REC(2007)2 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, Gjykata i referohet pluralizmit mediatik dhe diversitetit të përmbajtjes mediatike (*Centro Europa 7 S.r.l. dhe Di Stefano k. Italisë* [DhM], § 134). Në lidhje me mediat e shërbimit publik, ajo i referohet gjithashtu standardeve për shërbimet e transmetimeve publike të pranuar nga Shtetet Kontraktuese përmes Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, që ofrojnë udhëzime edhe në përjasjen që duhet ndjekur për interpretimin e nenit 10 të kësaj fushe (*Manole dhe Të tjerë k. Moldavisë*, §§ 102 and 51-54).

F. Pluralizmi dhe liria e shprehjes e pakicave

652. Gjykata vlerëson se do është e papajtueshme me vlerat themelore të Konventës nëse ushtrimi i të drejtave të Konventës nga një grup pakice kushtëzohet nga fakti nëse shumica e pranon (*Alekseyev k. Ruisisë*, § 81). Po të ishte kështu, të drejtat e një grupi pakice për lirinë e fesë, shprehjes dhe organizimit do të ngeleshin thjesht teorike sesa praktike dhe efektive, siç kërkohet nga Konventa (po aty, § 81; *Barankevich k. Ruisisë*, § 31).

653. Gjykata bën një dallim të rëndësishëm ndërmjet lejimit të mbështetjes popullore në favor të zgjerimit të fushëveprimit të garancive të Konventës dhe situatës ku kjo mbështetje popullore shfrytëzohet për të ngushtuar fushëveprimin e mbrojtjes thelbësore (*Bayev dhe Të tjerë k. Ruisisë*, §§ 70-71).

654. In çështjen *Sekmadienis Ltd. k. Lituanisë*, ku kompania kërkuese ishte gjobitur për paraqitjen e reklamave të veshjeve që përshkruanin figura fetare, Gjykata vërejtë se i vetmi grupi fetar që ishte konsultuar në gjyqe ishte Kisha Katolike Romake, edhe pse ekzistonin shumë komunitete të tjera fetare të krishtera ose jo (§ 80). Gjykata disponoi se, edhe nëse supozohet i drejtë pretendimi i Qeverisë se reklamat ishin fyese për shumicën

Udhëzuesi për nenin 10 të Konventës - Liria e shprehjes

e popullsisë lituaneze të besimit të krishterë, prapëseprapë është e papajtueshme me vlerat themelore të Konventës, sepse ushtrimi i të drejtave të Konventës nga një grup pakice kushtëzohet nga fakti nëse shumica e pranon (§ 82).

XV. Neni 10 dhe marrëdhënia e tij me dispozitat e tjera të Konventës dhe Protokolleve të saj: pavarësia, mbivendosja

655. Në disa raste, e njëjta ngjarje mund të jetë objekt i dispozitave të nenit 10 dhe dispozitave të tjera të Konventës njëkohësisht. Kjo situatë ka shtyrë Gjykatën ta shqyrtojë çështjen vetëm sipas dispozitës që e cilëson më relevante në dritën e rrethanave të veçanta të çështjes dhe që është ekuivalente me *lex specialis*, ose ta shqyrtojë ankesën sipas një dispozite dhe "në dritën" e dispozitës tjetër, ose shqyrtojë mosmarrëveshjen sipas të dyja neneve.

1. Neni 8 i Konventës

656. Në një çështje lidhur me survejimin e gazetarëve dhe një urdhër për dorëzimin e dokumenteve prej të cilave mund të identifikoheshin burimet e informacionit, Gjykata u shpreh se ligji nuk parashikonte garanci të përshtatshme ndaj kompetencës së survejimit të ushtruar ndaj kërkuesve me qëllim zbulimin e burimeve të tyre gazetareske dhe kishte konstatuar shkelje të neneve 8 dhe 10 mbi bazën e të njëjtave fakte (*Telegraaf Media Nederland Landelijke Media B.K. dhe Të tjerë k. Vendeve të Ulëta*, § 102; shih edhe vlerësimin e Gjykatës në një kontekst të krahasueshëm: *Saint-Paul Luxembourg S.A. k. Luksemburgut*, § 44; *Ernst dhe Të tjerë k. Belgjikës*, § 116; *Nagla k. Letonisë*, § 101).

2. Neni 9 i Konventës

